



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Menaxhim Agrobiznesi”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Klodiana Gorica

2. PhD. Ani Mbrica

Shtator/2019

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

UBT, universiteti më i vjetër në Shqipëri, themeluar më 1 Nëntor, 1951, fillimisht ka funksionuar si Instituti i Lartë Bujqësor dhe më tej gjatë historisë së tij, me Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 166, datë 28.05.1991, i është akorduar statusi i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e drejtimit të agrobiznesit duke synuar të pajisë studentët me njohuritë themelore në këte fushe nëpërmjet integritit të mësimin me kërkimin. Programi synon të zhvillojë aftësitë, shprehjet dhe kompetencat e studentëve për tu bërë ekspertë të denjë të fushës së menaxhimit të bizneseve të fushës së Agrobiznesit. Ky është një program unik në treg dhe merr gjithnjë e më shumë rëndësi si rrjedhojë e rëndësisë që agrobiznesi ka marrë në ekonominë shqiptare.

Për të gjitha ciklet dhe për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit janë bërë ndryshime dhe përshtatje të kurrikulave të studimit ndër vite,. Këto ndryshime janë diktuar nga nevoja e tregut të punës por edhe nga kushtet e vendosura nga udhëzimi i Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë për raportet e lëndëve të detyrueshme dhe me zgjedhje. Këto përshtatje në kurrikulën e studimit kanë qënë të nevojshme edhe për të përshtatur studentin në terma të kompetencave, aftësive dhe njohurive të marra gjatë studimeve me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri por edhe jashtë saj. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” ofrohet nga departamenti “Drejtimit Agrobiznesi” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Miratimi i këtij programi studimi është bërë me VKM Nr.560, datë 12.08.2005.

Unikaliteti dhe rëndësia e këtij programi përmbledhen në pikat e mëposhtme:

- Rëndësia e këtij programi është e madhe për shkak të testimit në treg për një kohë të gjatë, reflektimit në kurrikula të asaj cka ka kërkuar dhe nevojitur tregu, apo sepse studentët e këtij programi jo vetëm që priten të jenë një burim i rëndësishëm ekspertësh/specialistesh, por do të plotësojnë qartë nevojat që kanë tregu shqiptar kundrejt rritjes së këtij trendi.
- Rëndësia e këtij programi është gjithashtu **ndërkombëtare**, sepse përputhet qartë edhe me politikat e komunitetit europian për zhvillimin e komuniteteve dhe zonave rurale.

Studentet e këtij programi fitojnë njohuri të menaxhimit të AGB ndaj pershtaten me se miri me kërkesat e tregut në këte fushe, po duke qene se marrin edhe njohuri të menaxhimit në teresi ata mund të pershtaten lehtësisht në çfaredo lloj biznesi në tregun e punës. Ky program studimi jo vetëm për koherencën, rëndësinë dhe jetegjatesinë në tregun e arsimit të lartë publik shqiptar, por edhe për rëndësinë dhe qasjen ekonomike që ka në kuadrin dhe rëndësinë kombëtare, paraqitet me **rendesi strategjike** për vendin, ekonominë dhe tregun e punës dhe nevojat e biznesit.

Unikaliteti i këtij programi i referohet miresherbimit të nevojave të tregut dhe biznesit ndër dekada, ruajtjes së traditës cilësore dhe përcjelljes së kujdeshme të saj ndër breza dhe vite përditesimin të kurrikulave me nevojat e tregut, qasjes dhe afersisë me biznesin vendas, përafrimit drejt zhvillimeve ndërkombëtare përmes marrëveshjeve të ndryshme, përpjekjeve të shumta intensive dhe cilësore për t'u rritur, përmirësuar si në nivele fakulteti, departamenti por edhe vecanerisht stafi.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” filloi me prezantimin dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Universitetin Bujqësor të Tiranës u realizua gjatë datave 22-23/05/2019, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga ekspertet e ASCAL, të caktuara për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Përgjegjësën e Departamentit dhe Dekanin e FEA, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e FEA. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon raportin tek Kordinatori Teknik i ASCAL. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako.

Më datë 18.07.2019 me anë të sistemit AMS dhe me shkresë Nr.44/45 prot. dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 24.07.2019, Institucioni kthen përgjigje me anë të sistemit AMS, në lidhje me Draft Raportin, ku shprehet se **nuk ka komente**.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IPAL) që financohet nga shteti dhe burime të tjera të ligjshme (Aneks 2 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 1 pika 1).</p> <p>Ai është institucion i arsimit të lartë (IAL) që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale dhe të transferimit të dijeve të tretët (Aneks 2 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 2, pika 1).</p> <p>Synimi kryesor i UBT, Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe i Programit të Studimit të MA që bën pjesë në këto struktura, është të ofrojnë arsimin të lartë, zhvillim të dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe të profesioneve të ligjshme (Aneks 2 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 2 pika 3).</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>UBT ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat: prodhim bimor, prodhim shtazor; hortikulturë; mbrojtje bimësh; akuakulturë dhe peshkimi; agromjedis & mbrojtjen e tij; ekonomi agrare; politikat bujqësore; zhvillimi i interguar rural; menaxhimi i ndërmarrjeve; marketing; financë & kontabiliteti; agroturizëm, bioteknologji dhe ushqim; industrinë e pijeve; mbarështimin e pyjeve; industrinë drurit; mjekësinë veterinarë & shëndetin publik etj., (Aneks 2 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 2, Pika 1).</p> <p>Gjithashtu, veprimtaria kërkimore-shkencore në UBT, zhvillohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Ajo synon t'u paraprijë dhe t'u japë përgjigjet sfidave të zhvillimit dhe të integritit të vendit në strukturat evropiane, shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, rritjes së prodhimit vendas dhe njëkohësisht zgjerimit të llojshmërisë dhe të vëllimit së eksporteve të produkteve bujqësore dhe blegtorale, rritjes së konkurrencës, etj., (Aneks 2 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 59, pika 4).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit në të gjitha dokumentat bashkangjitur, por edhe nga vizita në institucion reflekton praninë e të gjitha objektivave të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Sipas dokumentacionit, ai synon pajisjen me njohuritë bazë mbi menaxhimin e agrobiznesit dhe ka një përmbajtje</p>

të tillë që t'u ofrojnë studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit.

(Aneksi 6: Rregullore e FEA-s, Kreu IV, neni 19)

Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Agrobiznesi" plotëson kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, organizimit dhe administrimit të tij nga një staf i kualifikuar, nga kompetencat që ai përcjell, si dhe sa i takon mësimdhënies, mësimnxënies, si dhe plotësimi të burimeve të nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit. Studentet e këtij programi fitojnë njohuri të menaxhimit të AGB ndaj pershtaten me se miri me kerkesat e tregut në këto fushe, po duke qene se marrin edhe njohuri të menaxhimit në teresi ata mund të pershtaten lehtësisht në çfarëdo lloj biznesi në tregun e punës. Ata mund të punësohen si:

- menaxherë në ndërmarrjet që ofrojnë inpute për fermerat bujqësorë;
- menaxherë në fermerat bujqësorë dhe blektorale të orientuara nga tregu;
- menaxherë në ndërmarrjet që përpunojnë produktet bujqësore dhe blektorale;
- në agjenci të ndryshme shtetërore;
- në institucionet e sistemit bankar dhe ato të mikrofinancës;
- në institucione politikbërëse në nivel qendror dhe atë lokal;
- në institucione apo agjenci të tjera publike ose private që kanë në fokus zhvillimin rural;
- në sektorin privat, banka, institucione të administratës qendrore dhe vendore etj.

Sa i përket objektivave, rregullorja e FEA, Neni 19 përcakton qartë misionin dhe Objektivat e Programeve Bachelor në FEA ku thuhet:

1. Programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e FEA_s, dhe Departamenteve brenda tij, në përputhje me strategjinë për zhvillim të FEA_s.
2. Programet e studimit janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë.
3. Programet e studimit të FEA_s kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ato synojnë pajisjen me njohuritë bazë mbi shkencat e ekonomisë bujqësore, sipas profileve përkatëse.
4. Programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" të FEA_s kanë përmbajtje të tillë që tu ofrojnë studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit. / Kjo reflektohet edhe në rregulloren e DDA Kreu 3, neni 9, pikat e, f, g si dhe në rregulloren e programit të studimit Kreu II, Neni 3

	Plotësimi i këtij kriteri sigurohet gjithashtu edhe nga respektimi i Legjislacionit në fuqi, në mënyrë specifike i ligjit Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloreve të tjera të brendshme.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi jo vetëm për koherencën, rëndësinë dhe jetegjatesinë në tregun e arsimit të lartë publik shqiptar, por edhe për rëndësinë dhe qasjen ekonomike që ka në kuadrin dhe rëndësinë kombëtare, paraqitet me rëndësi strategjike për vendin, ekonominë dhe tregun e punës dhe nevojat e biznesit. Unikaliteti i këtij programi i referohet miresherbimit të nevojave të tregut dhe biznesit ndër dekada, ruajtjes së traditës cilësore dhe përcjelljes së kujdeshme të saj ndër breza dhe vite përditesimit të kurrikulave me nevojat e tregut, qasjes dhe afersisë me biznesin vendas, përafrimit drejt zhvillimeve ndërkombëtare përmes marrëveshjeve të ndryshme, përpjekjeve të shumta intensive dhe cilësore për t’u rritur, përmirësuar si në nivele fakulteti, departamenti por edhe vecanerisht stafi. Kërkimi shkencor në UBT realizohet në përputhje me parimet universale të kodit etik të shkencëtarit. UBT-ja nxit debatin aktiv për ndërgjegjësimin e shkencëtarëve për impaktet dhe implikimet e gjera që mund të kenë studimet e tyre si dhe mundëson komunikimin konstruktiv midis shkencëtarëve dhe publikut për sfida të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit (Aneks 3 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 62 Pika 1 dhe 2).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Përcjellja e një filozofie shkencore, funksionale midis njësive baze dhe atyre mbështetëse, e mbështetur përmes dokumentacionit të bollshëm dhe cilësor, departamentit të perkushtuar dhe në kërkim të standarteve dhe qasjeve të reja ndërkombëtare, vëmendjes ndaj studenteve dhe mbështetjes për biznesin dhe nevojën e pasjes së tij në krahasim, përbejnë disa ndër treguesit e identifikuar në të gjithë procesin e vlerësimit të këtij programi. Institucioni ka të përcaktuar përmes dokumentacionit si strategjitë, statusin, rregulloret e përgjithshme dhe ato të brendshme si njësi operative që lidhen dhe ndërvaren me njëra tjetrën në funksion të miresherbimit të objektivave kryesore në funksion të të cilave funksion edhe ky program studimi.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit	E analizuar nga dokumentacioni i venë në dispozicion, por edhe nga vizita dhe takimet me grupet e interesit, rezultoi se ka një përputhshmëri midis asaj cka rregullorja dhe dokumentacioni tjetër i

<p>përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>vene ne dispozicion nga UBT me ate cka percillet apo identifikohet ne terren. Keshtu, në planin strategjik për zhvillimin e UBT-së vendosen disa prioritete midis të cilave janë studentët, kërkimi dhe mësimdhënia. Plani strategjik përbën një plan konkret për të ndërtuar realitetin e UBT dhe përbën një pikë të fortë orientuese për të ardhmen. Keshtu, në Planin Strategjik, në Statutin dhe Rregulloren e studimeve universitare të UBT si dhe në rregulloren e FEA, janë përcaktuar qartë të gjitha drejtimet prioritare akademike e si i tillë është dhe programi “Menaxhim Agrobiznesi”, i cili në këtë frymë ndër të tjera synon të sigurojë nivel njohurish në shkencat ekonomike për menaxhimin e agrobizneseve, te permiresoje cilesine, rrise aftesise praktike, te forcoje orientimin me tregun, kompetencat akademike, profesionale, apo etike te komunikimit.</p> <p>(Aneks 2 Statuti UBT_Miraturar_2017, Datë 28.03.2017, Neni 2), (Aneks 3 Plani Strategjik UBT_Miraturar, Qershor 2016) dhe (Aneks 5 Rregullore e FEA2017, miraturar më datë 29.09.2017, Neni 6, Pika 1, Neni 16, Neni 19, Pika 4 dhe Nenet 20 dhe 21).</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Ne vijueshmeri te zbatimit dhe perputhshmerise me ate cka vendos institucioni ne dokumentat themelore, si Statuti, Plani strategjik apo rregullorja vijojne natyrshem edhe dokumentacioni qe njesia baze e ketij programi, pra departamenti ndjek per te realizuar kete perputhshmeri.</p> <p>Në përputhje me Strategjinë e UBT, dhe Rregulloren e FEA, DDA u ofron studentëve programin e studimit në fushën e agrobiznesit, në ciklin e parë Bachelor, profili “Menaxhim Agrobiznesi”. Studimet në DDA organizohen në fushën e diplomimit “Ekonomi dhe Agrobiznes”. Veçori e këtij programi studimi është përgatitja e menaxherëve të biznesit me njohuritë e përgjithshme të menaxhimit, profilizuar në agrobiznes por që janë të aftë të integrohen lehtësisht në tregun e punës edhe në profile të tjera biznesi.</p> <p>Bazuar ne Aneksi 6a: Rregullore e FEA-s, Neni 19, pika 1, 3 dhe 4 dhe neni 21, dhe Aneksi 7: Rregullore e DDA, Kreu III, Neni 11; Kreu V: Neni 15-26, rezulton se me përfundimin e studimeve në nivelin e parë në DDA studenti pajiset me diplomë Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
	<p>Departamenti si njesia baze qe ofron kete program studimi krahas objektivave per t'i sherbyer tregut dhe biznesit shqiptar, rritjes se</p>

<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>cilesise dhe permiresimit te standarteve te mesimdhencies, forcimit te marredhenieve me studentet, qenderzon dhe vlereson ne menyre te vazhduar formimin e studenteve te ketij programi me ato aftesi, dije e kompetenca qe i sherbejne tregut, objektivave te programit dhe institucionit, dhe qellimeve te tjera.</p> <p>Keto studime synojne formimin dhe kualifikimin shkencor te studenteve ne fushen e drejtimit te agrobiznesit. Studimet ne keten program synojne te sigurojne njohurite themelore ne keto fusha nepermjet integritit te mesimit me kerkimin. Po ashtu programi i studimit synon te siguroje nivel njohurish ne shkencat e menaxhimit dhe marketingut qe te jene te krahasueshme me diplomat qe leshojne strukturat analoge universitare jashte vendit.</p> <p>Po ashtu ka permbajtje te tillë qe u ofron studentëve njohurite baze te nevojshme per ndjekur ciklet e tjera te njepasnjeshme te studimit.</p> <p>(Aneksi 6b: Rregullore e brendshme e DDA, Kreu III, Neni 9)</p> <p>(Aneksi 7: Rregullore e Programit të Studimit “MA”, Bachelor, Kreu II, Neni 3, 7)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>FEA ka një përvojë të gjatë akademike duke filluar që me krijimin e tij në vitin 1971 si Fakulteti i Ekonomisë Agrare e më tej pas ristrukturimeve të mëvonshme mbështetur nga projekte dhe programe të huaja (SARA, GTZ). Në vitin 2007 rezulton me strukturën me të cilën paraqitet sot si Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit (DDA) është një nga 5 departamentet kryesore të tij, më i vjetri dhe me eksperiencë të gjatë në arsimim.</p> <p>UBT ka patur në fokus rritjen e partneritetit me institucione homolege në vend dhe sidomos jashtë vendit. Institucionalisht UBT ka një numër të madh marrëveshjesh më këto institucione ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience te ndersjellte. Njesia baze e ofrimit te ketij programi perben nje department te konsoliduar ku qasja ndaj tregut, studentit, cilesise dhe orientimit nderkombetar kane qene dhe mbeten ende jo vetem objektiva dhe synime te qarta, por te realizuara dhe testuara ne menyre te sukseshme dhe qendrueshme ne tregun shqiptar. Ne menyre te vazhduar kjo njesi ka kryer studime te ndryshme cilesore e sasiore per te testuar tregun, perputhshmerine e programeve, afersine me biznesin pavaresisht sfidave dhe veshtiresive.</p> <p>Qendra e Karrierës dhe Alumni si një njësi që luan rolin e ndërmjetësit midis njësive bazë e kryesore dhe tregut të punës funksionon jo vetëm për të lehtësuar procesin e kalimit të studentëve në tregun e punës por edhe për të mbledhur informacion në lidhje me ecurinë e tyre. Një nga funksionet e Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA) në nivel institucional, është të gjurmojë ecurinë e studentëve të UBT-së në tregun e punës, mbasi ata përfundojnë studimet dhe diplomohen.</p>

	<p>Procesi i gjurmimit ka kaluar në tre faza; së pari, është përpiluar një pyetësor, i cili përbëhet nga tri seksione: profili i studentit, vlefshmëria e diplomës së UBT-së për tregun e punës, dhe punësimi i tyre.</p> <p>Në këtë kuadër UBT në bashkëpunim me partner të tjerë është lider në implementimin e nje projekti inovativ ERASMUS+ KA2, "GRADUA". Ky projekt synon të krijojë në Shqipëri një platformë inovative të bazuar në teknologjine e informacionit për ndjekjen e të diplomuarve në lidhje me punësimin e tyre. Kjo platformë vjen në mbështetje të hartimit të politikave dhe reformës së arsimit të lartë. Platforma është inovative krahasuar me përvojat ekzistuese (bazat e të dhënave / ndërmjetësit e punës): pasi është një model i integruar dhe i certifikuar i përputhjes së kërkesës / ofertës bazuar në përdorimin e teknologjisë online të gjurmimit të të diplomuarve shqiptarë në universitetet më të mëdha në vend.</p> <p>Rezulton nga vizitat ne terren, diskutimet me Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise dhe me grupin e pergatitjes se raportit te vleresimit te brendshem, por edhe nga dokumentacioni bashkangjitur (Aneksi 17b: Performanca e QKA, fq 10-13), se: është realizuar studimi për këtë qëllim, ku targeti i studimit janë studentët e UBT-së, nga ana tjetër pjese aktive kane qene edhe ditët e panairit të karrierës të zhvilluara pranë UBT te cilat shfrytëzohen edhe për diskutim ndërmjet komunitetit të biznesit dhe institucioneve që mund të jenë ofrues të vendeve të punës dhe studentëve dhe stafit akademik, me qëllim shkëmbimin e ideve dhe ballafaqimin midis kërkesave të tregut të punës dhe mundësive reale që ofrojnë programet e studimit. Qëllimi final i këtyre takimeve është jo vetëm venia në kontakt e studentëve me punëdhënësit potencialë, por edhe përshtatjen e kurrikulave dhe programeve në përputhje me tregun e punës. Ky aktivitet është shndërruar tashmë në një traditë të suksesshme, pasi ai organizohet për të pestin vit radhazi.</p> <p>(Aneksi 17b: Performanca e QKA, fq 14-16)</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Kjo realizohet kryesisht mbi bazen e kurrikules dhe metodologjise se perdorur ne mesimdhene. Kurrikula mesimore eshte e strukturuar ne kategorite e lendeve sipas kritereve te arsimit te larte por edhe te pershtatur mbi bazen e gjetjeve te kerkimit te tregut ne lidhje me kompetencat e kerkuar ne punesim si edhe mbi bazen e eksperiencave te fituara ne projektet e universitetit dhe bashkepunimet me universitete te tjera kombetare dhe nderkombetare.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Njesia baze e ofrimit të këtij programi përben një departament të konsoliduar ku krahas qasjes ndaj tregut dhe rrjedhimisht dhe studentit, punohet për përmirësimin e cilesive, mesimdhënies dhe mesimnxënies, përmirësimit dhe diversifikimit të metodave inovative të mesimit dhe vlerësimit të dijes. E gjitha kjo ka demonstruar dukshëm një përvojë, kapacitet dhe burime cilesore dhe sasiore për ofrimin e këtij programi studim, duke bërë që kjo njësi baze e këtij institucioni të ndikojë direkt jo vetëm në rritjen dhe imazhin e vetë UBT, por edhe një vlerë të shtuar në arsimin e lartë publik shqiptar.</p> <p>UBT, është një nga IAL-të më të vjetra dhe me eksperiencë në Republikën e Shqipërisë. Kjo i ka dhënë mundësinë që në vite të krijojë një përvojë dhe një kapacitet burimesh njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të këtij institucioni, përcjelljen e dijes tek studentët.</p> <p>UBT ka 288 anetare të stafi akademik, 26 kërkues shkencorë, 102 ndihmes akademike, 8 punonjës bibliotekë</p> <p>FEA ka 113 staf nga të cilët 93 staf akademik, 20 staf ndihmes DDA ka 20 staf akademik dhe 2 staf ndihmes, nga të cilët 4 Profesore, 8 Prof.As., 6 Dr. dhe 2 Master.</p> <p>Kualifikimi i stafit akademik brenda njësisë bazë është:</p> <p>Profesor- 4</p> <p>Profesor i Asociuar-8</p> <p>Doktor-6</p> <p>Master Shkencor-2</p> <p>Vlen të theksohet se edhe politika e vazhdimësisë së stafit në UBT/FEA, ka inkurajuar krijimin e një stafi të specializuar dhe orientuar në profilin e bizneseve në sektorin e agropërpunimit dhe jo vetëm. Ky staf si rezultat i bashkëpunimeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare është kualifikuar në vijimësi. Në vite vihet re një rekrutim i vazhdueshëm i stafit të ri të dalë nga vetë kjo IAL si dhe të ardhur nga IAL të tjera.</p> <p>(Aneksi 4: Guida e DDA, 2006).</p> <p>(Aneksi 2: Statuti i UBT: Kreu V, Neni 25)</p> <p>(Aneksi 23a: Numri total i punonjësve UBT)</p> <p>(Aneksi 23b: Numri i personelit akademik FEA dhe DDA)</p> <p>(Aneksi 25: Ngarkesa e plote mësimore e stafit akademik të anagazhuar në programin e studimit)</p> <p>(Aneksi 18: Lista e pedagogëve të angazhuar në programin e studimit)</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, por edhe nga verifikimet e kryera gjatë vizitës në institucion,</p>

<p>studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>konkludohet se ka një përputhshmeri të plotë dhe cilësore midis fushes së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit. Bazuar në dokumentacionin konkludohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” është program i ciklit të parë të studimit, organizohet në 180 kredite (ECTS), përkatësisht 60 ECTS në çdo vit akademik dhe kohëzgjatja normale e këtij programi studimi është tre vite akademike, • Programi është në linjë me synimet dhe misionin e UBT • Edhe emërtimi i programit të studimit, Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi është i njëjtë me emërtimin e vetë Departamentit: Drejtim Agrobiznesi. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi I.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës pavarësisht faktit se është universiteti publik më i vjetër, përbën një IAL të mirëorganizuar midis njësive bazë dhe brenda saj. Këtë organizim e reflekton:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. ndarja midis fakulteteve dhe marrëdhëniet brenda tyre; 2. delegimi dhe përcjellja e procedurave, analizave vjetore nga poshtë-lart-poshtë ka rezultuar mjaft eficiente për departamentet si njësi bazë dhe mjaft të rëndësishme për vetë këtë IAL. <p>Mbarëvajtja dhe mbikëqyrja e programit të studimit bëhet në formë të koordinuar nga të gjitha instancat drejtuese të UBT. Janë një sërë zyrash dhe njësish përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor, si: ZSS; Sekretaritet e Departamenteve, Zyra e Kurrikulave në Rektorat, Zv.Rektori për mësimin, etj. Një koordinim i punës së këtyre njësive ka sjellë një mbështetje të studimeve në këtë cikël.</p> <p>Integriteti, cilësia dhe vlera që produkti i prodhuar nga DDA si ofruese baze e këtij programi studimi është gershetim jo vetëm i perkushtimit të stafit, përgjegjës të departamentit, oritimeve të</p>

	<p>qarta te vete IAL, por edhe te suportit se tyre permes njesive te tjera mbeshtese. Ndergjegjesimi dhe orientimi drejt mesimdhenies dhe kerkimit shkencor behet paralel me perpjekjet per te nderkombetarizuar programin te suportuara nga njesite e tjera brenda fakultetit. Këto njësi bashkëpunojnë në funksion të ushtrimit të aktivitetit të UBT_s dhe realizimit me cilësi të programeve mësimore. Shërbimet Universitare të UBT_s janë parashikuar të jenë në funksion të plotësimit të nevojave të njësive mësimore-shkencore dhe detyrimeve të tjera për një mirë funksionim të institucionit. Një koordinim i punës së këtyre njësive ka sjellë nje mbeshtetje të studimeve në këtë cikël.</p> <p>FEA ka një përvojë të gjatë akademike duke filluar që me krijimin e tij në vitin 1971 si Fakulteti i Ekonomisë Agrare e më tej pas ristrukturimeve të mëvonshme mbështetur nga projekte dhe programe të huaja (SARA, GTZ). Në vitin 2007 rezulton me strukturën me të cilën paraqitet sot si Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit (DDA) është një nga 5 departamentet kryesore të tij, më i vjetri dhe me eksperiencë të gjatë në arsimim.</p> <p>Raportet me institucionet ndërkombëtare jo vetëm kanë rritur dhe përmirësuar imazhin dhe rëndësinë e këtij departamenti, por kanë ndikim direkt në promovimin, rritjen dhe ndërkombëtarizimin e të gjithë UBT.</p> <p>Ndërsa raportet me institucionet dhe bizneset kombëtare mbeten prioritet, janë të shumta përpjekjet që bën i gjithë stafi i këtij departamenti i cili shfrytëzon lidhjet e veta edhe personale duke synuar të ofrojë vazhdimisht guest speaker të huaj apo vendas sipas fushave dhe moduleve përkatese, t'u ofrojë studentëve përmes praktikave apo vizitave në biznese shqiptare rurale si laboratore kërkimi në terren, etj. Nga ana tjetër nga takimi me studentët rezulton se këto takime me biznese vendase apo të ftuar të huaj e vendas kanë qënë mjaft eficiente dhe të kërkuara nga ato.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve,</p>	<p>Nje nder sfidat kryesore te ketij departamenti eshte rritja e procesit te nderkombetarizimit e cila do t'i sherbeje rritjes se standarteve dhe permiresimit te cilesise. Kjo sfide ka ardhur me rritjen e kesaj njesie baze, me testimin dhe vleresimin pozitiv te outputit qe ky department nxjerr per tregun shqiptar, te vleresimeve dhe mbeshtetjes nga bizneset shqiptare si dhe rritjes se nevojës se tregut per student cilesore te ketij programi.</p> <p>Outputi i rezultuar nga analizat e perfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve ka prodhuar nje perceptim dhe gjykim cilesor per te gjithë punen masive te bere deri tani dhe me sigurine e perputhjes me tregun. Raportet me institucionet nderkombetare jo vetem kane rritur dhe permiresuar imazhin dhe rendesine e ketij departamenti, por kane</p>

<p>institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>ndikim direkt ne promovimin, rritjen dhe nderkombetarizimin e te gjithë UBT.</p> <p>Një bashkëpunim të gjerë UBT ka edhe me aktorë biznesi brenda vendit, ku marrëveshjet e nënshkruara ju japin përgjegjësi palëve për tu dhënë mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale në këto biznese.</p> <p>Panairi i karrierës që zhvillohet çdo vit në UBT është një HUB që sjell së bashku akademinë dhe biznesin dhe ku krijohen premiset për zgjerimin e bizneseve partnere me universitetin.</p> <p>Nga vlerësimet e bëra nga departamenti në analizat mësimore-kërkimore dhe nga opinionet e studentëve të programit, ky program ka rezultuar i suksesshëm dhe është vlerësuar: si në tregun e punës ashtu edhe në atë të studimeve të niveleve më të larta siç është ai i studimeve të nivelit të dytë të masterit. Studentë të këtij departamenti kanë rezultuar të suksesshëm edhe në universitetet e huaja ku ata kanë shkuar në kuadrin e shkëmbimeve bilaterale</p> <p>Stafi eshte mjaft i perkushtuar dhe i orientuar drejt ketij qellimi, po keshtu qasja e UBT me mbeshtetjen dhe perkushtimin e drejtuesit te departamentit, profesoratit dhe deri tek stafi me i ri. Nje gjykim i tille eshte bazuar jo vetem mbi dokumentacionin e plote dhe te larmisem ne lidhje me marreveshjet ekzistuese nderkombetare, me sfidat e aferta me universitete te huaja tashme te permbyllura apo ne proces, por edhe nga vleresimet e studenteve te ketij programi.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucionalisht UBT ka një numër të madh marrëveshjesh më këto institucione ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience dhe ekspertize në funksion të përmirësimit të procesit mësimor dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit, përmes identifikimit të kërkesave të tregut dhe mundësisë që studentët të prezantohen direkt me biznesin.</p> <p>Vleresimet dhe rezultatet qe vijne nga marreveshjet me institucione kombetare dhe nderkombetare, bazuar ne diskutimet me stafin dhe drejtuesit e ketij departamenti jane bere pjese e punes se perditshme, dhe nuk perfshihen vetem ne analizat vjetore. Gjykohet se keto perfitime jane pjese e shqetesimeve te perditshme te stafit te cilet jane perfshire intensivisht ne rritjen e kapaciteteve, perpjekjeve per te integruar kete program studimi ne nivele nderkombetare teksta u sherbehet maksimalisht nevojave te bisnesit vendas.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit</p>	<p>Programi i studimit Bacelor ne Menaxhim Agrobiznesi synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e drejtimit te agrobiznesit duke synuar te pajise studentet me njohuritë themelore në këte fushe nëpërmjet integritit të mësimit me kërkimin. Programi synon te zhvilloje aftësite, shprehite dhe kompetencat e studenteve për t'u bërë ekspertë të denjë të fushës së menaxhimit të bizneseve të fushës së Agrobiznesit. Ky eshte nje program unik ne treg dhe merr gjithnje e me shume rendesi si rrjedhoje e rendesise qe agrobiznesi ka marre ne ekonomine shqiptare. Ne kete kuptim institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e</p>

<p>për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. Per kete, ekzistojnë shumë marrëveshje të tjera të realizuara nga UBT dhe QKA me institucione dhe biznese kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentëve të programeve të ofruara në UBT, në FEA dhe të programit në veçanti. Nga DDA është konsideruar, sikurse edhe nga vete IAL se zhvillimi i praktikës mësimore është një fazë e rëndësishme që lidhet me formimin praktik të studentëve si dhe me mundësi më të mira të tyre për sistemim në punë. Kjo veprimtari është përmirësuar dukshëm vitet e fundit si pasojë edhe e përpjekjeve të vazhdueshme të DDA por edhe të rritjes së interesit të studentëve për të. Kjo është vënë re gjatë mbrojtjes së praktikave profesionale ku del në pah puna cilësisht e dallueshme nga studentët, pjekuria e tyre si dhe fakti që mjaft studentë janë punësuar në vendet ku kanë realizuar praktikën profesionale.</p> <p>Orientimi i qarte drejt praktikës, aftësive në punë dhe rritjes në karriere është shoqëruar edhe me ndryshime dhe reflektime në kurrikulen e këtij programi. Për shembull, në vitin e fundit akademik janë bërë përmirësime në kurrikulën e studimeve, duke i dhënë një hapësirë më të madhe këtij komponenti: në vitet në vazhdim ajo do të zhvillohet në semestrin e gjashtë të sistemit Bachelor, i cili është lënë i lirë (pa mësim) që tu jepet mundësi studentëve të angazhohen më seriozisht në kohë dhe hapësirë për kryerjen e praktikës profesionale.ose jane shtuar lende si manaxhimi i karrieres qe synojne te orientojne sa me shume studentet drejt aftesive praktike, menyres se kerkimit te punesimit me te mire qe u pershtatet atyre sipas programit, etj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Ne funksion te këtij qellimi, por jo vetem, institucioni angazhon edhe zyrtar mbeshtetese si p.sh. zyra e karrieres e cila permes organizimit te alumni, mbajtjes se marredhenieve me studentet permes perdorimit te gjurmimit te tyre si instrument vleresues dhe mates sasior, mundohet nga njera ane te vleresoje dhe te sigurohet per cilesine e transmetuar te dijeve dhe perputhjes se tyre me ate cka kerkon tregu, por edhe te perdore si aset studentet e diplomuar por te pozicionuar ne drejtime te rendesishme dhe strategjike. Pavaresisht sfidave qe kjo zyre perballtet, qenesia e saj, mbeshtetja qe i jepet studenteve aktuale apo atyre te diplomuar, si dhe marredheniet brenda vete IAL i i kane pozicionuar tashme si mjaft jetike dhe strategjike per te gjithë IAL. Krahas mareveshjeve qe vendos institucioni permes se cilave mundeson, mbeshtet dhe ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit, ky institucion permes lidhjeve dhe maredhenieve qe mbart dhe regjistron edhe pas perfundimit te studimeve te studenteve, mundohet te mbeshtete studentet sipas profileve te studimit perkates. Duke ndërthurur edukimin me kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive te të tretët, në nivel të lartë, UBT kërkon të përgatisë jo vetëm specialistë të kualifikuar të fushës së bujqësisë, të ushqimit</p>

	dhe mjedisit, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë (Aneks Plani Strategjik UBT_Miratuar, Qershor 2016, Misioni dhe Vizioni i UBT-s, Paragrafi 2, Fq 5).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (L. 80/2015 & VKM Nr. 41 datë 24.01.2018). DDA ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e këtij programi studimi Bachelor (Aneksi no. 7) dhe bazuar në të ka përgatitur dosjen e plotë të këtij programi. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit (Aneksi no.14.2) programi është organizuar në 31 module ku secili modul vlerësohet me një total të caktuar kreditesh (4 ECTS, 5 ECTS, 6 ECTS dhe 7 ECTS), ndërsa Praktika profesionale dhe Mikroteza vlerësohen përkatësisht me 16 dhe 9 kredite. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik në këtë program studimi është 60 kredite (Aneksi no.14.2). Në fund të këtij programi studimi, studenti i ciklit të parë të studimeve duhet të ketë grumbulluar 180 kredite formimi. (Aneksi 6b-Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 20, Pika 4& Aneksi no.7- Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA - Neni 11, Pika 4)
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (Aneksi no.7), Neni 3, Pika c, studimet e ciklit të parë në Menaxhim Agrobiznesi synojnë arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e drejtimit të agrobiznesit. Ato synojnë sigurimin e njohurive të nevojshme në këtë fushë duke integruar mësimin me kërkimin. Programi i studimit Bachelor në MA përfshin module ekonomike dhe joekonomike të cilat iu sigurojnë studentëve një përgatitje të gjerë, një gamë të gjerë të profileve në studimet e mëtejshme, si dhe mundësi që të përshtaten në tregun e punës. Programi i studimit adreson siç duhet nevojat specifike aktuale të tregut të punës duke i krijuar në këtë mënyrë studentëve mundësi

	<p>punësimi jo vetëm në fushën e menaxhimit të agrobiznesit, por edhe në fusha të tjera.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe analitike (Aneksi 6b- Rregullore e Brendshme e DDA-s-Neni 15, pika 3 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA – Neni 7, Pika 2) në fushën e agrobiznesit, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë. Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit (Doc. no.7- Studim tregu, Aneksi 6b 5- Rregullore e Brendshme e DDA-s-Neni 15, pika 2 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA – Neni 7, Pika 1). Gjithashtu, ky program kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit (Aneksi 6b - Rregullore e Brendshme e DDA-s-Neni 15, pika 4 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA – Neni 7, Pika 2).</p> <p>Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi si dhe duke u bazuar në konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi synon që të zhvillojë studentët me njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e studimit të Menaxhimit të Agrobiznesit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Duke u bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi përmban elementet e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij (Aneksi 14.2 – Kurrikula Bachelor MA 2017-2020, Aneksi 14.3 – Plani mësimor Bachelor MA 2018-2019, - Aneksi 14.4- Klasifikimi i lëndëve sipas veprimtarive formuese 2017-2020, Aneksi 14.5 - Syllabuset e programit të studimit, Aneksi 63 -Pasqyra e vlerësimit të studentit gjatë vitit, Aneksi 6b - Rregullore e Brendshme e DDA & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA) konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi (VKM no.41 (Dt.24/01/2018, pika 2).</p> <p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, hartohet nga departamenti dhe më pas miratohet nga Dekani i FEA-s si dhe nga Senati i UBT-së. Në fillim të çdo viti akademik, DDA, bazuar në kurrikulën përkatëse, harton planin mësimor, i cili miratohet nga dekani i FEA-s dhe Rektori i UBT (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA - Neni 19, Pika 2&3). Në planin mësimor pasqyrohen elementet si: emërtimi i moduleve, kurset e ndara në semestra, numri i krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve, detyrimet për secilin modul, periudha dhe mënyra e kontrollimit të dijeve për secilin modul, si dhe mënyra e zhvillimit të provimit final për secilin modul (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA - Neni 20).</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Duke u bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi përmban elementet e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij (Aneksi 14.2 – Kurrikula Bachelor MA 2017-2020, Aneksi 14.3 – Plani mësimor Bachelor MA 2018-2019, - Aneksi 14.4- Klasifikimi i lëndëve sipas veprimtarive formuese 2017-2020, Aneksi 14.5 - Syllabuset e programit të studimit, Aneksi 63 -Pasqyra e vlerësimit të studentit gjatë vitit, Aneksi 6b - Rregullore e Brendshme e DDA & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA) konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi (VKM no.41 (Dt.24/01/2018, pika 2).</p> <p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, hartohet nga departamenti dhe më pas miratohet nga Dekani i FEA-s si dhe nga Senati i UBT-së. Në fillim të çdo viti akademik, DDA, bazuar në kurrikulën përkatëse, harton planin mësimor, i cili miratohet nga dekani i FEA-s dhe Rektori i UBT (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA - Neni 19, Pika 2&3). Në planin mësimor pasqyrohen elementet si: emërtimi i moduleve, kurset e ndara në semestra, numri i krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve, detyrimet për secilin modul, periudha dhe mënyra e kontrollimit të dijeve për secilin modul, si dhe mënyra e zhvillimit të provimit final për secilin modul (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA - Neni 20).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar</p>	<p>Ky program studimi ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar modulet në përputhje me kategoritë e përcaktuara në VKM</p>

<p>qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.5) dhe ka përcaktuar gjithashtu edhe ngarkesën përkatëse në kredite për secilën kategori të veprimtarive formuese brenda këtij programi studimit duke respektuar peshën e përcaktuar në VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (shtojcën nr. 1, tabela 1). Më poshtë paraqitet situata e klasifikimit të lëndëve në këtë program studimi (Aneksi 14.4- Klasifikimi i lëndëve sipas veprimtarive formuese 2017-2020):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndë bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) - 30 kredite (16.7%) • Lëndë karakterizuese, (formim specifik) - 93 kredite (51.7%) • Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) – 22 kredite (12.2%) • Lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale) – 26 kredite (14.4%) • Detyrime përmbyllëse (përgatitja e tezës së diplomës) – 9 kredite(5%) <p>Ky programi i jep një peshë të rëndësishme praktikës profesionale dhe punimit të diplomës, pra punës kërkimore të realizuar nga studenti, duke i vlerësuar përkatësisht me 16 kredite dhe 9 kredite. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” përmban 31 lëndë (155 kredite ECTS) dhe organizohet 6 semestra. Ai është i organizuar me 180 kredite formimi dhe ka një kohëzgjatje 3 vite akademike (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 11, Pika 1 & 4).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Sipas ligjit në fuqi (L. 80/2015, Neni 22, pika 1) IAL-të duhet të përbëhen nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera të përcaktuara në statutin e tyre. Në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015, Neni 22, pika 2), njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimeve Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, është Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA). Kjo njësi kryesore përbëhet nga 6 Departamente në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi. Përbërja e FEA-s jepet si më poshtë: (Aneksi 6a- Rregullores se FEA-s-Neni 5, pika 1; Neni 6 pika 1)</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit; 2. Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural; 3. Departamenti i Financë - Kontabilitet; 4. Departamenti i Matematikës dhe Informatikës; 5. Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural;




	<p>6. Departamenti i Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Pjesë e këtij fakulteti është dhe Instituti për Studime Ekonomike dhe Transferim të Njohurive (ISETNJ).</p> <p>Në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 22, pika 3, Neni 25, pika 1) njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, është Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit (DDA). Departamenti është organizuar në grupe mësimore me karakter kërkimor (L. 80/2015 - Neni 25, pika 5), përkatësisht 2 grupe mësimore kërkimore (GMK) në fushën e marketingut dhe drejtimit (Aneksi 6b- Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 3 pika).</p> <p>Personeli i DDA-s përbëhet nga personeli akademik, dhe personeli ndihmës akademik ((L. 80/2015 - Neni 57, pika 1). Departamenti ka në përbërjen e tij 20 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 1 anëtarë si personel ndihmës akademik (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEA dhe DDA 2018), në përputhje me detyrimet në fuqi (L. 80/2015 - Neni 25, pika 4).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Njësia kryesore e këtij programi, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta dhe të ndërthurura njëra me tjetrën (L. 80/2015, Neni 23, pika 1). Ai ofron programe studimore të nivele të ndryshme, ku në përfundimin e të cilave i pajisë studentët me diplomë (Aneksi 6a- Rregullores së FEA-s-Neni 5 pika 1.a,b). FEA ofron programe studimi në 3 cikle studimi: cikli i parë (Bachelor), cikli i dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional) dhe cikli i tretë (master ekzekutiv dhe doktoraturë) (Aneksi 6a- Rregullores së FEA-s-Neni 16).</p> <p>Siç përmendet edhe më sipër në kriterin no.1, ky fakultet është i organizuar në 6 njësi bazë për zhvillimin e mësimin dhe punës kërkimore-shkencor (Aneksi 6a- Rregullores së FEA-s-Neni 6, pika 2). Organizimi dhe funksionimi i këtyre njësive bazë parashikohet në statutin e UBT-së.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, DDA, ka në përbërjen e saj 20 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 1 anëtarë si personel ndihmës akademik (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018).</p> <p>Personeli akademik i DDA i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e këtij programi studimi në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 59, pika 6). Bazuar në të dhënat përkatëse (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018), rezulton se personeli akademik i DDA-së ka kualifikimet e mëposhtme :</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, DDA, ka në përbërjen e saj 20 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 1 anëtarë si personel ndihmës akademik (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018).</p> <p>Personeli akademik i DDA i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e këtij programi studimi në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 59, pika 6). Bazuar në të dhënat përkatëse (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018), rezulton se personeli akademik i DDA-së ka kualifikimet e mëposhtme :</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, DDA, ka në përbërjen e saj 20 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 1 anëtarë si personel ndihmës akademik (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018).</p> <p>Personeli akademik i DDA i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e këtij programi studimi në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 59, pika 6). Bazuar në të dhënat përkatëse (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018), rezulton se personeli akademik i DDA-së ka kualifikimet e mëposhtme :</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, DDA, ka në përbërjen e saj 20 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 1 anëtarë si personel ndihmës akademik (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018).</p> <p>Personeli akademik i DDA i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e këtij programi studimi në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 59, pika 6). Bazuar në të dhënat përkatëse (Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018), rezulton se personeli akademik i DDA-së ka kualifikimet e mëposhtme :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Profesor – 4 • Profesor të asocuar – 8 • Doktor – 6 • Master – 2 <p>Në këtë program studimi janë angazhuar 43 pedagogë, nga të cilët 36 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 janë personel akademik me kontratë (PAK), me kohë të pjeshme (Aneksi 25- Ngarkesa e</p>

	<p>plotë mësimore e stafit akademik angazhuar në program). Bazuar në listen e personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi (Aneksi 25), si nga DDA dhe departamente të tjera të FEA-s, rezulton se ky personel mban kualifikimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Profesor – 6 • Profesor i Asociuar – 15 • Doktor – 12 • MSc - 10 <p>Personeli akademik për 2 GMK përkatëse të këtij departamenti paraqitet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • GMK- Marketing - 5 anëtarë të personelit akademik • GMK- Drejtim - 14 anëtarë të personelit akademik <p>(Aneksi 43c1- Analiza e Punës Shkencore DDA 2018)</p> <p>Në bazë të nevojave vjetore, DDA, përveç personelit akademik të brendshëm, angazhon edhe personel të jashtëm akademik. Planifikimi për stafin akademik të ftuar (PAK) bëhet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga Dekanati dhe nga Rektorati (Aneksi 23- Statuti i UBT– Neni 34).</p> <p>Bazuar në dokumentin që pasqyron ngarkesën mësimore të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor në MA, konkludojmë se ngarkesa mësimore për 2 vitet e fundit është mbuluar pothuajse plotësisht nga personeli akademik i brendshëm i departamentit (Aneksi 25- Ngarkesa e plotë mësimore e stafit akademik angazhuar në program).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi, disponon dokumentacionin e plotë për këtë program studimi ku përfshihen: Kurrikulat e programit të studimit për periudhën 2016-2019 dhe 2017-2020 (Aneksi 14.1& 14.2); Plani mësimor (Aneksi 14.3); Klasifikimi i lëndëve sipas përcaktimeve ligjore në fuqi (Aneksi 14.4) si dhe Syllabuset e lëndëve (Aneksi 14.5).
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. (VKM nr.41 dt. 24/01/2018) Në të pasqyrohen objektiva formues dhe kompetenca profesionale përcaktuese dhe specifike që duhet të ofrojë një program studimi Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi (Aneksi 6a- Rregullore e DDA- Neni 16 &Aneksi 7- Rregullore e programit të studimit-
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit	

<p>vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Neni 8).</p> <p>Kurrikula përmban 31 module të shpërndara në 6 semestra. Në tre semestrat e pare studentët zhvillojnë nga 6 module të detyrueshme për semester. Në semestrin e katërt dhe të pestë studentët zhvillojnë 5 module të detyrueshme dhe module me zgjedhje, përkatësisht 1 modul në semestrin e katërt dhe 2 në semestrin e pestë. Secili modul vlerësohet me numrin e krediteve përkatëse (3, 4, 5, 6 dhe 7 ECTS). Për llogaritjen e krediteve është marrë parasysh ngarkesa e çdo moduli ku një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.1.b).</p> <p>Objektivat formues dhe kompetencat profesionale përcaktuese i gjejmë të pasqyruara në modulet e semestrit të parë dhe të dytë, ndërsa kompetencat profesionale specifike i gjejmë të pasqyruara në modulet që zhvillohen në semestrat në vazhdim. Semestri i gjashtë përfshin praktikën profesionale dhe zhvillimin e temës së diplomës që finalizon këtë cikël studimi. Totali i krediteve për çdo vit akademik është 60 ECTS. Duke plotësuar në këtë mënyrë numrin total të krediteve, 180 ECTS formimi, përcaktuar për finalizimin e ciklit të parë të studimeve me një kohëzgjatje prej tre vite akademike (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 11, Pika 1 & 4).</p> <p>- Aneksi 14.2 - Kurrikula Bachelor MA 2017-2020</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, plani mësimor buron nga kurrikula e këtij program studimi dhe pasqyron periudhën kohore përgjatë së cilës zhvillohet secili modul i këtij programit (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 20, Pika 1).</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ. Ai hartohet nga Përgjegjësi i Departamentit (Njësia Bazë) dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UBT (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA - Neni 20, Pika 2&3).</p> <p>Siç shpjegohet edhe në rregulloren e këtij programi studimi (Neni 20, pika 2), plani mësimor përfshin elementet e mëposhtëm në përputhje me VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.6):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emërtimin për secilin modul të këtij programi studimi për çdo kurs, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës; 2. Numrin e krediteve për çdo modul (siç është permendur edhe më sipër, kreditet për modul variojnë nga 3 - 7 ECTS) 3. Orët në total për secilin modul (në varësi të llojit të lëndës, variojnë nga 30-75 orë) dhe raporti i orëve - leksion/seminar (në varësi të llojit të lëndës, varion në
--	---

	<p>0:2, 1:2, 2:1, 2:2 dhe 3:2, kryeson raporti 2:1 dhe 2:2);</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. Detyrimet për secilin modul (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli); 5. Raporti i vlerësimit të studentit (në varësi të llojit të lëndës, varion nga 20- 40% gjatë vitit në 60-80 % provimi përfundimtar; kryeson raporti 40%:60% sidomos për modulet e vitit të II-të dhe të III-të) 6. Periudha (në varësi të semestrit që zhvillohet 1,2,3,4,5 &6) dhe mënyra e kontrollit të dijeve për çdo modul (provim ose kolokium – rezulton provim për të gjitha lëndët); 7. Mënyra e zhvillimit të provimit final për çdo modul (provim me goje, me shkrim, me goje & me shkrim-rezulton provim me shkrim pothuajse për të gjitha lëndët, përveç “Gjuhë e huaj” dhe “Bazat e së drejtës” përkatësisht me shkrim dhe me gojë, dhe me gojë). <p>(Aneksi 14.3 - Plani mësimor)</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në Rregulloren e DDA dhe të programit të studimit pasqyrohen qartë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015, Neni 76, 89, VKM, 2.7 kuotat e pranimit).</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë të studimeve në DDA-së përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të DDA, FEA-s dhe UBT-s (Aneksi 6b- Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 18, Pika 1&2; Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 9,Pika 1&2).</p> <p>Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional si dhe kandidatët që disponojnë diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit (pasi realizohet ekuivalentimi i diplomës së fituar në vendin e huaj nga komisioni përkatës në MAS); të cilët plotësojnë kriteret si më poshtë (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 9,Pika 3&4) :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kriterin e meritës (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. • Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në DDA). • Nota mesatare e lëndës me zgjedhje në fushën e ekonomisë. • Kuota të paracaktuara
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e</p>	<p>Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e syllabuseve, në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim</p>

<p>nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Agrobiznesi”, është modeli i përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2). Në përgjithësi syllabuset e lëndëve të këtij program studimi respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Shtojca no.2). Vlen të përmendet se syllabuset e lëndëve si: “Mikroekonomia I, “Bazat e Marketingut”, “Sipërmarrja dhe Drejtimi Biznesit të Vogël”, “Statistikë Biznesi”, “Kontabilitet Drejtimi” respektojnë plotësisht elementët përbërës të modelit. Megjithatë, vlen të përmendet se ka ende vend për përmirësime për elemente të caktuara si: literatura përkatëse për çdo temë, shpjegimi i temave, mungesë e literaturës rekomanduese si dhe problematika me paraqitjen e referencave (mungesa e një stili të caktuar), konstatuar në syllabuset e lëndëve si: “Bazat e së Drejtës”, “Drejtimi i Burimeve Njerëzore”, “Integrim Europian”, “Kontabilitet”, “Menaxhim Karriere” “Prodhim bimor” si dhe “Marketing Agroushqimor” . (Aneksi 14.5 - Syllabuset e programit të studimit)</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nëse i referohemi kurrikulës së programit, vëmë re se ky program studimi ka pësuar ndryshime pas vitit 2017. Këto ndryshime janë kryer duke patur si qëllim përmirësimin e programit në përputhje me kërkesat e tregut dhe duke marrë parasysh zhvillimet e fundit. (Aneksi 14.1 - Kurrikula Bachelor MA 2016-2019) (Aneksi 14.2 - Kurrikula Bachelor MA 2017-2020) Nga takimi i realizuar me personelin akademik që japin mësim në këtë program studimi u informuam se çdo fillim viti, por edhe gjatë vitit, diskutohet dhe bëhen përditësime apo rifreskime në programet e lëndëve duke përfshirë në to informacione mbi zhvillimet më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit, vlen të përmendim ketu vendosjen në dispozicion të studentëve të rasteve të studimit më të fundit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto ndryshime, sidomos referuar pjesës praktike të realizuar gjatë seminarit, duhet të pasqyrohen edhe në syllabus.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore</p>	<p>Ngarkesa mësimore javore në auditor për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” është në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi (VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, Pika</p>

e nënligjore në fuqi.	2.1.d). Ngarkesa mësimore javore në auditor në lidhje me leksione, seminare, ushtrime, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe praktika të zhvilluara në auditor, është 24 orë mësimore 50-minutëshe (Aneksi 53a – Orari Bachelor, semestri I-rë 2018-2019; Aneksi 53b – Orari Bachelor, semestri II-të 2018-2019).
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të këtij programi studimi mundësojnë thellimin dhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit të agrobiznesit duke i dhënë atyre mundësi të mira punësimi në këtë fushë. Në takimin e realizuar me studentët e këtij programi, mësuam se orët e mësimit në auditor (leksione, seminare, ushtrime apo praktika në laboratorë) zhvillohen në formë interaktive ndërmjet pedagogut dhe studentit, ku pedagogët paraqesin shembuj të ndryshëm për të mbështetur pjesën teorike dhe raste studimi të ndryshme për të stimuluar mendimit krijues dhe kritik të studentit.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Në planin mësimor të këtij programi studimi (Aneksi 14.3), për secilën lëndë, gjejmë të pasqyruara shpërndarjen e orëve për leksione dhe seminare në auditor. Siç përmendet edhe në Standardin II.3.4, në këtë program studimi, raporti ndërmjet orëve teorike dhe atyre praktike, për pjesën më të madhe të lëndëve, është 2:1 dhe 2:2 (2 orë leksione në auditor dhe 2/1 orë seminare). Modulet e kurrikulës në këtë program studimi kanë një shpërndarje të barabartë në lidhje me ngarkesën mësimore dhe kreditet përgjatë 6 semestrave. Ngarkesa totale në kredite për 4 semestrat e parë është 30 ECTS, ndërsa në semestrin e pestë dhe të gjashtë përkatësisht 35 ECTS dhe 25 ECTS (Aneksi 14.2 - Kurrikula Bachelor MA 2017-2020). Kjo shpërndarje e ngarkesës i mundëson studentëve të arrijnë objektivat formues të programit si dhe rezultate të pritshme në mësimnxënie dhe kërkim shkencor. Në takimin e realizuar me studentët mësuam se ata nuk ndiejnë se ka ngarkesë apo pamundësi për tu përgatitur siç duhet gjatë një semestri. Koha është e mjaftueshme për përgatitjen e çdo lënde dhe për rrjedhojë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Në disa lëndë të caktuara, gjatë seminarit mund të aplikohen raste studimi, detyra apo projekte kursi për të zhvilluar aftësitë komunikuese të studentëve si dhe për t'i nxitur ata të përvetësojnë procesin e kërkimit. (psh. lëndë si “Bazat e Marketingut”, “Sipërmarrja dhe Drejtimi i Biznesit të Vogël”, “Drejtim Agrobiznesi”, etj.) ndërsa në lëndë të tjera, orët e seminareve realizohen në laboratore për të përmirësuar aftësitë e studentëve në lidhje me menaxhimin e informacionit apo përpunimin dhe analizimin e të dhënave (psh. lëndë si “Statistikë biznesi”, “Informatikë”, “Njohuri mbi informacionin”, etj.). Ndarja e lëndëve me karakter formues ndaj atyre aplikative krijon mundësinë për të fituar njohuritë teorike gjatë dy semestrave të parë dhe mundëson aftësimin gradual praktik në semestrat që vijojnë. Studenti, në 15 javë mësimore në auditor, gjatë leksioneve (2 orë në javë) merr njohuritë e duhura rreth çështjeve apo

	<p>tematikave të caktuara për secilin modul. Gjatë seminareve (2 orë në javë), studentët analizojë çështjet e leksionit, si dhe punojnë në mënyrë të pavarur apo në grup raste studimore në funksion të temave të lëndëve. Nga takimi i realizuar me studentët kuptuam se rastet e studimit që analizoheshin në klasë janë në përputhje me temat e mësimit dhe prekin çështje që kanë interes të veçantë në ditët e sotme. Ndërsa nga takimi i realizuar me pedagogët mësuam se realizimi i detyrës së kursit i aftëson studentët për të punuar në grup, për të ndarë punën, për të komunikuar në mënyrë elokuate, gjithashtu i mëson sesi duhet të mbledhin dhe të analizojnë informacion për çështje të caktuara. Edhe nga takimi i realizuar me studentët vërtetuam këtë aspekt të rëndësishëm të detyrave të kursit.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e këtij programi studimi, duke përfshirë natyrën e moduleve të ofruara, ngarkesën e tyre në ECTS, raportin e aspekteve teorike dhe aplikimeve të mundshme praktike, është në përputhje me profilin e këtij programi bachelor, karakteristikë që e veçon nga profile të tjera Bachelor që ofrohen nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. Gjithashtu, për specifikën që paraqet, tenton të mbulojë nevojat në tregun e punës në fushën e agrobiznesit.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Siç doli në pah edhe nga diskutimi i realizuar me grupin e vlerësimit të brendshëm, për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare janë shfrytëzuar eksperiencat ndërkombëtare (projekti SARA,GTZ etj.) nga vende të zhvilluara duke rritur kështu: (a) mundësinë e transferimit të studimeve, pasi përmbajtja është e krahasueshme me dijet që studenti mund të marrë në institucione të tjera brenda apo jashtë vendit; (b) mobilitetin e studentëve në kuadër të programeve Erasmus+; si dhe mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve.</p> <p>(Aneksi 14.1- Kurrikula Bachelor MA 2016-2019; Aneksi 14.2 - Kurrikula Bachelor MA 2017-2020 & Aneksi 35b- Mobiliteti i studentëve 2015-2019)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga bisedat e realizuara me grupin e vlerësimit të brendshëm dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, del në pah se DDA analizon ecurinë e çdo programi studimi duke përfshirë në to mendimin dhe opinionin e të gjithë personelit akademik. Pedagogët pohuan se çdo fillim viti, por edhe gjatë vitit, diskutohet dhe bëhet përditësimi apo rifreskim i syllabuseve duke u kujdesur për të përfshirë në to informacione mbi zhvillimet më të fundit të shkencës. Gjithashtu, ata pranuan se shkëmbimi i eksperiencave të tyre në kuadër të programeve Erasmus ka ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve (eksperiencat në Poloni - Prof. Asoc. Dr. L. Thoma).</p>

	<p>Në kuadër të përmirësimit të programeve të moduleve, një feedback vjen edhe nga rezultatet e anketës që realizohen me studentët, ku ata japin mendimin e tyre si për pedagogët dhe për lëndët përkatëse të tyre. Një iniciativë e rëndësishme në kuadër të përmirësimit apo pasurimit të programit të studimeve do të ishte edhe feedback-u nga studentët e diplomuar, të cilët janë më në brendësi dhe njohin mundësitë dhe problematikat e tregut të punës. Bazuar në opinionet dhe mendimet e marra, DDA ndërmerr masa për të pasqyruar ndryshime të mundshme të syllabuseve sipas moduleve. Përmirësimet e realizuara në syllabuse miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore (GMK). Të gjitha syllabuset arkivohen në departament në kopje dixhitale dhe në hardcopy.</p> <p>Në përgjithësi, syllabuset e lëndëve të këtij program studimi respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve të VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Shtojca no.2). Në çdo syllabus literatura ndahet në literaturë bazë e detyrueshme dhe literaturë ndihmëse.</p> <p>Nëse i referohemi shqyrtimit të syllabuseve të këtij programi studimi, për një pjesë të mirë të tyre (Aneksi 14.5 - Syllabuset e programit të studimit) rezulton se literatura, qoftë bazë apo ndihmëse, është relativisht e mjaftueshme dhe e përditësuar. Megjithatë vlen të përmendet se ka ende vend për përmirësim dhe përfshirje të elementeve që lejojnë evidentimin e literaturës së përditësuar në module të caktuara. Ka module që kanë nevojë të përditësojnë literaturën bazë dhe rekomanduese duke qënë se shkon përtej harkut kohor të 10 viteve të fundit. (“Marketingu Agroushqimor” dhe “Komunik Biznesi”). Mungesa e përdorimit të një stili të caktuar të paraqitjes së literaturës në syllabus, i cili do të lejonte evidentimin e disa elementeve të rëndësishëm duke përfshirë këtu vitin e botimit të librit apo artikullit përkatës, e bën të vështirë përcaktimin e literaturës së përditësuar për disa lëndë (“Bazat e së Drejtës”, “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” “Menaxhim Karriere”, “Taksimi”).</p> <p>Në disa lëndë, pedagogët përdorin cikël leksionesh dhe është e vështirë të identifikohet nga është marrë materiali për temat e përfshira në syllabus.</p> <p>Duke qënë se pedagogët e këtij programi deklaruan, fakt që vërtetohet në dokumentacionin e paraqitur për vlerësim, se kanë eksperiencë jashtëzakonisht të mira në përfshirje e tyre në projekte të ndryshme, në bashkëpunime për realizimin e artikujve apo librave me pedagogë të institucioneve të tjera jashtë vendit apo pjesëmarrje në konferenca dhe botime të artikujve në revista të njohura, dhe sidomos referuar viteve të fundit, dokumentimi i punës së tyre kërkimore-shkencore në syllabus do të sillte vlerë të shtuar për të.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi, si dhe kompetenca profesionale dhe</p>

<p>programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>analitike (Aneksi 6b- Rregullores e Brendshme e DDA-s-Neni 15, pika 3 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA – Neni 7, Pika 2) në fushën e agrobiznesit, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë. Fokusi i studimit të programit Bachelor në MA është marrja e njohurive bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme, por dhe për formimin e shprehive të veçanta në fushën e menaxhimit të agrobiznesit, marketingut të produkteve bujqësore si dhe në atë të menaxhimit të burimeve të prodhimit. Studentët fitojnë: njohuri dhe kompetenca në menaxhimin dhe zhvillimin e sistemit të Agrobiznesit; njohurive mbi funksionet e marketingut bujqësor, strukturat e tregut dhe institucionet e marketingut të produkteve agro-ushqimore; njohuri në menaxhimin e burimeve njerëzore, zotërimin e njohurive mbi modelet e organizimit të fermave bujqësore, dhe njohjes së rolit të menaxhimit në suksesin e një biznesi bujqësor; etj.</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të parë, Bachelor në MA kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të studimit si Master Profesional apo Master Shkencor (Aneksi 6b - Rregullores e Brendshme e DDA-s-Neni 15, pika 4 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA – Neni 7, Pika 2).</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Kurrikulat e tre programeve të DDA janë zhvilluar dhe ristrukturuar duke u bazuar kryesisht në eksperiencën e universiteteve amerikane dhe europiane (projektet si SARA, GIZ, TEMPUS). Megjithatë, zhvillimet e reja në tregje kanë bërë të nevojshme përshtatjen e këtyre kurrikulave. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë, DDA kryen një studim tregu për të identifikuar nevojat që ka biznesi dhe agrobiznesi për ekspertët në fushën e menaxhimit të biznesit/agrobiznesit. Kjo procedurë realizohet nga DDA çdo 2-3 vjet dhe duke qënë se studimi i fundit i tregut daton në 2016, nga biseda e realizuar me Përgjegjësin e Departamentit, mësuam se ky studim mendohet të përsëritet së shpejti. Metodologjia e këtij studimi konsiston në përdorimin e pyetësorit në mbledhjen e të dhënave, ku kampioni i marrë në analizë përbëhet nga menaxherë të nivelit të lartë e të mesëm si dhe nga pronarë të bizneseve kryesisht përfaqësues të sektorit të ushqimit dhe industrisë e agrobiznesit në Shqipëri. Ky studim ka patur si qëllim të identifikojë se cilat janë njohuritë, aftësitë apo kompetencat që kërkojnë bizneset nga ekspertët e rinj apo nga studentët e diplomuar, si punonjës potencial në tregun e punës. Rezultatet e këtij studimi janë reflektuar në ndryshimet e mundshme në kurrikul apo në syllabuset e lëndëve, për të përgatitur studentët në përputhje me kërkesat e tregut të punës. (Aneksi 17a - Studimi i tregut)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				✓

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi” me kohë të plotë dhe më kohë të pjesshme përbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. i gjithë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi mban gradën professor, doctor dhe MSc, një grade më lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim (L. 80/2015 - Neni 59, pika 6). Siç permendet edhe në Standardin II.2.4, personeli i DDA-s përbëhet nga 20 anëtarë të personeli akademik dhe 1 anëtar i personelit ndihmës akademik.</p> <p>Bazuar në listen e personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi (Aneksi 25), si nga DDA-së dhe departamente të tjera të FEA-s, rezultojn se ky personel mban kualifikimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Profesor – 6 (3 prej tyre janë anëtarë të DDA-së) • Profesor i Asociuar – 15 (6 prej tyre janë anëtarë të DDA-së) • Doktor – 12 (3 prej tyre janë anëtarë të DDA-së) • MSc – 10 (2 prej tyre janë anëtarë të DDA-së) <p>Personeli akademik me kohë të plotë (PAE) i angazhuar në këtë program studimi rezultojn në masën 84%, ku 39% i përket DDA dhe 61% i përket departamenteve të tjera. Përfshirja e personelit akademik me kohë të pjesshme (PAK) rezultojn në masën 16 %.</p> <p>(Aneksi 25- Ngarkesa e plotë mësimore e stafit akademik angazhuar në program & Aneksi 23b -Numri i personelit akademik FEAdhe DDA 2018)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë (PAE) kanë të gjitha kualifikimet dhe kompetencën për të zhvilluar me cilësi të lartë programin e lëndës. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik të këtij programi del në pah se orientimi i studimeve master, doktoraturë, apo kërkimor i stafit përkon me ekspertizën në fushat që ata mbulojnë në kurrikulën e programit të studimit dhe me natyrën e moduleve që mbulojnë në këtë program studimi.</p> <p>(Aneksi 20 - Curriculum Vitae e stafit akademik të programit)</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit rezultojn se studentët gjatë semestrit të 6-të zhvillojnë praktikën profesionale dhe paralelisht përgatisin temën e diplomës. (Aneksi 14.2). Në</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit rezultojn se studentët gjatë semestrit të 6-të zhvillojnë praktikën profesionale dhe paralelisht përgatisin temën e diplomës. (Aneksi 14.2). Në</p>

<p>të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>kurrikulën e programit të studimit për vitin 2019-2020 (Aneksi 14.2) vihet re rritja e ngarkesës së praktikës (zhvillohet përgjatë një semestri dhe jo më paralel me zhvillimin e moduleve të programit dhe vlerësohet me 16 ECTS, 4 kredite me teper se vitet e kaluara) krahasuar me kurrikulën 2016-2019 (Aneksi 14.1) nga viti 2019-2020.</p> <p>Natyra e këtij programi studimi kërkon kryerjen e praktikës profesionale pranë kompanive të ndryshme, kryesisht të fushës së agrobiznesit. Për realizimin e praktikës profesionale Institucioni ka përcaktuar në rregullore udhëzimet përkatëse (Aneksi 6a – Rregullore e DDA –Neni 23 & Aneksi 7- Rregullore e programit të studimit -Neni 14). Për t'i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktikën profesionale, Qendra e Karrierës dhe Alumni, përgjatë panairëve të karrierës që ka organizuar në UBT, ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF).</p> <p>(Aneksi 32 - Institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale)</p> <p>Pavarësisht vështirësive që mbart procesi i praktikave profesionale, Institucioni mundohet të ketë një bashkëpunim sa më të mirë me aktorët e tregut të punës. Megjithatë, duke iu referuar edhe diskutimit me studentët e këtij programi ende ka vend për përmirësime në kuadër të praktikave profesionale.</p> <p>Gjatë periudhës së praktikës profesionale, studentët punojnë paralelisht për të zhvilluar punimin e diplomës. Bazuar në Rregulloren e FEAs dhe DDA, ka një kriter që lejon realizimin e punimit të diplomës vetëm studentëve me mesatare 6.5 e lart (Aneksi 6b- Rregullores e Brendshme e DDA-s-Neni 24, Pika 5; Aneksi 6a- Rregullores se FEA-s-Neni 28, Pika 5 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA – Neni 15,Pika 4).</p> <p>Gjatë kësaj peirudhe kohore studenti supervizohet nga pedagogu udhëheqës në procesin e mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe analizës së tyre si dhe në shkrimin e finalizimin e materialit të diplomës. Nga diskutimi i realizuar me studentët e këtij programi rezultoi se aktiviteti i tyre kërkimor është plotësisht i mbështetur nga ndihma e pedagogut dhe departamenti i DDA. Ata gjithashtu pohuan se janë në komunikim të vazhdueshëm, duke përdorur si formën elektronike edhe komunikimin ballë për ballë, me pedagogun udhëheqës për çdo problematikë që mund të hasin gjatë këtij procesi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi kryejnë praktikala laboratorike përkatësisht në lëndët: “Informatikë”, “Kontabilitet”, “Njohuri mbi informacionin” dhe “Statistikë biznesi”. Gjatë këtyre orëve, krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe staf i ndihmës akademik që janë përgjegjës për këto laboratorë duke dhënë ndihmën e tyre në realizimin dhe mbështetjen e orës laboratorike. (Aneksi 22- Curriculum Vitae e stafit ndihmës akademik).</p>

të programit të studimit.	Nga vizita e realizuar në ambjentet e FEA, rezulton se janë në funksion të studentëve 6 laboratorë informatike, të cilët përdoren për kryerjen e praktikave laboratorike në lëndë të caktuara. Këta laboratorë janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e këtyre praktikave. Personeli ndihmës akademik në FEA përbëhet nga 3 anëtarë ku secili është përgjegjës për dy salla laboratorit. Ata kujdesen për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe mjeteve përkatëse në to. (Aneksi 42 - Tabelë përmbledhëse mbi kapacitetet infrastrukurore të FEA & UBT-së).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Në cdo fillim viti akademik, të gjitha njësitë kyesore në UBT zbatojnë një plan masash, ndër të cilat edhe masa lidhur me kujdesin për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Zyra e Rektoratit, Dekanatet dhe Departamentet përkatëse, angazhohen dhe ngarkohen për zbatimin e planit të masave. Është bërë si traditë tashmë procesimi që fillon në fillim viti akademik e përfundon në fund përmes një plani masazh, e gjitha kjo synon të kontrollojë dhe të përmirësojë procesin e mësimdhënies dhe të gjenerojë metoda të shumta e të larmishme. Institucioni ka institucionalizuar këtë proces edhe në dokumentat përkatëse strategjike, rregulloret tashmë të zbatuara nga të gjitha njësitë brenda tij, si dhe përmes zyrave përkatëse që kontrollojnë, monitorojnë dhe raportojnë procesin në fund të vitit. Krahas këtij instrumenti, UBT përdor edhe një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, pasi Universiteti Bujqësor i Tiranës ka adaptuar prej kohësh metodat inovative të mësimdhënies. Faktikisht ekziston një "Udhëzues për metodat inovative"-Aneksi 39. Në plotësim të këtij udhëzuesi vjen plani i masave i cili hartohet në fillim të vitit akademik.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në	

<p>mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Plani i mesiperm i masave dhe udhezuesi institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies janë konsideruar si instrumenta mjaft të konsoliduara tashme nga UBT dhe kanë rezultuar mjaft eficiente. Nga ana tjetër, për të vijuar këto procese por edhe për të konsoliduar kontrollin dhe vlerësimin e mesimdhënies nga stafi akademik dhe ndihmes akademik, strukturat përgjegjëse zhvillojnë me tej mekanizma monitorimi.</p> <p>Realizimi i monitorimit dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike nga UBT/FEA edhe nga departamenti që ofron këto programe studimi. Këtu përfshihen momente të tilla si: vlerësimi nga ana e studentëve: Dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, zhvillohet pyetësori me studentët. Rezultatet përpunohen nga një grup pune me përfaqësues nga dekanati e departamenti dhe më tej analizohen e shpërndahen në departamente; Instrumenti i dytë është Dokumenti i Normimit të Proçesit të Mësimdhënies. Ky dokument plotësohet në përfundim të çdo viti akademik nga vetë stafi akademik efektiv (PAE) në bashkëpunim me titullarët e grupeve Kërkimore Shkencore dhe Drejtuesin e Departamentit; Instrumenti tjetër që përdoret nga FEA, është Dokumenti i Performancës, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore, performancën në kërkimin shkencor e botime si dhe shërbimet ndaj të tretëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në referencë të informacionit të adresuar edhe në Kriterin me sipër, FEA por edhe departamenti që ofron këto programe studimi i ka dhënë shumë rëndësi në vitet e fundit realizimit të anketimit me trupën studentore. Autoritetet drejtuese të FEA-s në funksion të vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies, kanë konsideruar pyetje dhe rubrika në pyetësor, të cilat vjelin informacionin e mjaftueshëm dhe të nevojshëm duke adresuar edhe ankime komplekse të studentëve. Kjo praktikë tashmë është kthyer në traditë si një instrument i rëndësishëm që ndihmon në përmirësimin e punës së departamentit dhe fakultetit në përgjithësi.</p> <p>Për të shmangur ndikimin dhe deformimin e informacionit, kjo anketë realizohet 2 herë në vit në përfundim të çdo semestri, përpara zhvillimit të provimit final, pas përpunimit të të dhënave dhe nxjerrjes së rezultatit nga grup pune të përbërë nga anëtarë të departamentit dhe Dekanatit të FEA_s. Konkluzionet analizohen në mbledhje departamenti duke u përdorur si element të punës Mësimore – Kërkimore. Rezultatet e tij janë pjesë e analizës vjetore të departamentit. Duhet theksuar se ky departamenti i kushton vëmendje këtij procesi, duke rankuar shpesh edhe stafin sipas performancës, duke bërë publike rezultatet.</p>
	<p>Në vijim të institucionalizimit të kontrollit dhe vlerësimit të metodave të mësimdhënies, të inovacionit brenda UBT në</p>

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>mësimdhënie por jo vetëm, strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në bashkëpunim me departamentet bëjnë publike në mënyrë të përsëritur, çdo vit, rezultatet e vlerësimit. Kjo ndodh pasi janë diskutuar brenda departamentit, mes anëtarëve dhe përgjegjës të departamentit, janë ndarë mendimet, opinionet për përmirësimet e mundshme, dhe më tej, pas reflektimeve përcillen në organizmat më lart, në dekanat.</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Autoritetet drejtuese të FEAs si dhe Përgjegjësi i departamentit, bëjnë publike rezultatet e anketave nëpërmjet mbledhjeve të hapura periodike. Pasi diskutohet në Departamenti, duke nxjerrë konkluzionet dhe reflektimet e ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.</p> <p>UBT në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies ka një specifikë në organigramën e saj, që është Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional. Misioni i saj përveç funksioneve të tjera është kordinimi dhe monitorimi i gjithë procesit mësimor.</p> <p>Gjate takimit në institucion vihet re një qasje mjaft pozitive dhe mbështetese si nga ana e përgjegjës të departamentit ashtu edhe e stafit për të realizuar vlerësime të tilla në mënyrë sa më të hapur, transparente dhe me efikasitet të lartë.</p> <p>(Aneksi 38 - Analiza e punës mësimore DDA 2018)</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1041 742 1108">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="750 1041 965 1108">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="973 1041 1197 1108">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1204 1041 1356 1108">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						


<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies përbën një ndër prioritetet kryesore të kësaj njesie (departamenti), dhe është e reflektuar edhe në takimet me stafin dhe përgjegjësin e departamentit shqetësimi për të përmirësuar në mënyrë të vazhduar.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe</p>	<p>Eshtë e pranuar dhe vlerësuar edhe nga studentet, gjatë takimit që u bë me të që ka patur rastet kur student apo grupe të ndryshme studentesh kanë patur vështirësi në perceptim të literaturës, apo mos kuptim të nocioneve, dhe ka rezultuar gadishmeri dhe përkushtim i stafit për të rishpjeguar koncepte në orë të tjera ekstra. Një qendër i tillë i reflektuar vecanerisht edhe nga përgjegjësi i departamentit ka rezultuar i mbështetur edhe nga dokumentacioni i venë në dispozicion.</p>

<p>t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Sipas rregullores së studimeve të DDA:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve, dhe rregulloren mësimore të programit të studimit. • Format e mësimit teorik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. Në përfundim të secilit modul është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës. Modulet klasifikohen në dy grupe kryesore: module të detyruara dhe module me zgjedhje. • Format e kontrollit të dijeve: testimet ndërmjetëse, mbrojtja e punëve laboratorike, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtja e temave të diplomave.
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UBT në politikën e vet të Burimeve Njerëzore ka një perspektivë të qartë për kualifikimin e mëtejshëm akademik dhe shkencor të stafit. UBT inkurajon, asiston personelin akademik për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme shkencore, si dhe në ndërmarrjen e iniciativave të ndryshme, të cilat synojnë kualifikimin e mëtejshëm të tyre.</p> <p>Ne kuader të respektimit dhe vlerësimit të lirise akademike stafi i këtij departamenti motivohet të sjellë risi në mesimdhënie, të propozojë module interaktive apo forma të tjera që rrisin interesin e studenteve, integrojnë elementin e praktikës, nxisin debatin dhe zhvillojnë kreativitetin, për të rritur mësimnxënien dhe aftësitë praktike të studenteve. Në diskutimet që u realizuan me stafin e këtij departamenti, kjo çështje ishte mjaft intensive dhe interaktive duke përfshirë që nga stafi me i ri deri tek profesorët, duke integruar dijen dhe maturinë e këtyre të fundit me energjinë dhe dëshirën e të rinjve të motivuar dhe drejtuar nga përgjegjësi përkatës i departamentit.</p> <p>Sigurimi nga ana e fakultetit të një numri të konsiderueshëm të këtyre pajisjeve audio-vizive (projektorë) ka zgjidhur përfundimisht problemin e disponueshmërisë së tyre. Ky element ka stimuluar në emancipimin dhe në preferencën nga ana e studentëve për të realizuar edhe detyrimet e tyre si projekte apo detyra kurse, në mënyrë audio-vizive (projektorë), duke treguar një anagazhim serioz nga ana e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e</p>	<p>E tërë infrastruktura mësimore, që është detyrë dhe përgjegjësi direkte e stafit akademik, paraqitet mjaft mirë. Për të gjitha modulet që stafi i DDA_s zhvillon në program, por edhe modulet e tjera që sigurohen nga stafi akademik i departamenteve të tjera jashtë DDA, ekzistojnë tekste, literature e gjere baze dhe plotesuese, skripte apo</p>

<p>njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>dhe materiale të tjera ndihmëse.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm dhe aplikimit të formave më të reja të mësimdhënies, UBT/FEA ka investuar në teknologji të reja. Kështu p.sh., Salla 201, Godina B është e pajisur me "Smart board", e përdorur gjërësisht nga pedagogë të ndryshëm.</p> <p>Stafi akademik është i kualifikuar dhe kompetent për të zhvilluar modulet perkatese. 76% e këtij stafi është me tituj e grada "Doktor" e sipër. Stafi me "Master Shkencor" është kryesisht i jashtëm dhe i angazhuar për dhenie seminaresh. i gjithë stafi është i angazhuar në mesimdhënie dhe në kërkim shkencor. Përsa i përket kompetencave në mesimdhënie merret parasysh edhe feedback i siguruar nga anketimi i studentëve në përfundim të çdo semestri dhe për çdo lende. Nga një total prej 7-pyetjesh të kësaj ankete, 4-5 pyetje i referohen mesimdhënies.</p> <p>Në funksion të moduleve aplikative në këtë program studimi janë vënë në dispozicion salla të pajisura me kompjutera dhe programe kompjuterike (6 Laboratorë në Godinat A dhe B).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përsa i përket kompetencave në mësimdhënie merret parasysh edhe feedback i siguruar nga anketimi i studentëve në përfundim të çdo semestri dhe për çdo lëndë. Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike stafi i këtij departamenti motivohet të sjellë risi në mësimdhënie, të propozojë module interaktive apo forma të tjera që rrisin interesin e studentëve, integrojnë elementin e praktikës, nxisin debatin dhe zhvillojnë kreativitetin, për të rritur mësimnxënien dhe aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Për këtë, përdor strategji të ndryshme, filluar që me leksionet e hapura dhe interaktive që raportohen mjaft eficient nga stafi dhe studentët, përfaqësues të biznesit sipas fushave të studimit, etj. Grupi i punës për çdo vit akademik organizohet në nivel departamenti, vlerëson arritjet dhe problemet që duhen përmirësuar në të ardhmen.</p> <p>Perfshirja e studentëve, marrja e opinionëve të tyre jo vetëm në analizat vjetore apo testimet periodike, është bërë një rutinë e përditshme e cila reflektohet në diskutimet e stafit, përgjegjësinë e departamentit dhe vëmendjen e treguar nga i gjithë departamenti.</p> <p>Departamenti ka qenë mjaft aktiv në rakordimin midis inovacionit në mesimdhënie, përdorim të literaturës së huaj me përfshirjen e personalitetëve nga fusha e biznesit vendas, për të korporuar dhe integruar njohuritë, praktikën dhe eksperiencat, si dhe për të rritur integrimin dhe përfshirjen e studentëve në këto procese.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik</p>	<p>Gjithashtu, metoda inovative që rrisin performancën e mesimdhënies janë (Aneks 64 Udhezues Metoda Inovative Mesimdhënie)</p> <p>1. e-learning është një mënyrë elektronike e të mësuarit, që nënkupton dhënien e njohurive, mësimdhënies ose studimit, duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike si kompjuter, pajisje mobile</p>

<p>përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p> <p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>etj;</p> <p>2. google site është një aplikacion online që ndihmon në krijimin e një projekti në web ose të një faqe web-i, Lista e websiteve personale të pedagoqeve të UBT:</p> <p>https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home;</p> <p>3. Moduli online “Njohuri për informacionin” është rezultat i Projektit TEMPUS 517117-1-2011-1-IETEMPUS-JPHES, “Zhvillimi i njohurisë për informacionin për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe një ekonomi të bazuar mbi dijen në vendet e Ballkanit Perëndimor”;</p> <p>4. MOODLE, i njohur edhe si Mjedisi Virtual i të Mësuarit (Virtual Learning Environment), i cili është një mjet për krijimin nga ana e pedagogut të faqeve web dinamike për studentët e tyre;</p> <p>5. TEEAL është një bibliotekë online e aplikuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës;</p> <p>6. Esse3 është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimit dhe shërbimeve drejtuar studentëve, nga aplikimi në Universitet, jetës universitare deri në mbrojtjen e diplomës.</p> <p>Në bazë të të gjitha formave dhe metodave të mësimit qëndron sensin e autonomisë së studentit, duke u përpjekur për ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. UBT ka mekanizma të monitorimit e zbatimit të metodologjive të mësimit, që marrin parasysh aftësitë, nevojat dhe interesat e studentëve. Universiteti ka procedurë dhe i zbaton ato për funksionimin e organeve udhëheqëse dhe profesionale brenda universitetit, siç janë: Senati, Dekanati, Departamentet, Grupet Mësimore Kërkimore. Studentët përkrahen në mënyra të ndryshme nga pedagogët për të siguruar resurset e mësimit dhe për prezantimin e punës së studentëve. Në përputhje me misionin e institucionit dhe synimin për të arritur ekselencën në arsimin që ofrojmë, cilësia e mësimit është objektivi kryesor që kërkon përpjekjet dhe përkushtimin e të gjithë institucionit, përfshirë jo vetëm personelin akademik, por edhe atë administrativ.</p> <p>Me gjerësisht, kjo autonomi konsiston në: zhvillimin e seminareve në mënyra interaktive, formimi në mënyra të pavarur nga ana e studentëve e grupeve të punës për projektet dhe detyrat e kursit, bashkëpunimi lidhur me zgjedhjen e temave të këtyre punimeve dhe të temave të diplomave dhe asistimi i vazhdueshëm qysh prej hartimit të strukturës deri në mbrojtjen përfundimtare të tyre.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1825 742 1904">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="750 1825 973 1904">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="981 1825 1204 1904">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1212 1825 1372 1904">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Mjediset e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit janë në dispozicion si për zhvillimin e të gjitha programeve të studimit edhe për zhvillimin e procesit mësimor të programit të studimit</p> <p>Godina A është e organizuar në 2 kate dhe ka në përbërje të saj: 7 Salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh, 6 laboratorë për zhvillimin e lëndëve të ndryshme si: Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, etj.</p> <p>Godina B është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj: 8 Salla leksionesh dhe 23 salla seminaresh, 2 laboratorë për zhvillimin e lëndëve të ndryshme si: Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, etj. Gjithashtu, në Godinën B është vendosur edhe Dekanati i FEAs. Të dy godinat mirëmbahen dhe pastrohen nga stafi ndihmës i fakultetit.</p> <p>Cilësia në procesin mësimor është përveçse funksion i aspektit human, edhe e varur nga aspekti infrastrukturor dhe mjediset e zhvillimit të mësimin. në FEA dhe konkretisht lidhur me programin e studimit që po analizohet</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Projektet e reja të UBT përfshijnë përmirësimin dhe modifikimin e strukturës, infrastrukturës së nevojshme për të realizuar procesin mësimor. Jo vetëm në dokumentat strategjike, por edhe në diskutimet me stafin, drejtuesit e institucionit, drejtuesin e departamentit, dhe njesite e tjera, del në pah shqetësimi dhe preokupimi i vazhduar për të përmirësuar infrastrukturën krahas dhe në mënyrë paralele me përmirësimet e metodave të mësimdhënies, raporteve dhe marëdhënieve me studentët, etj. Sallat e reja, përmirësimi i vazhduar i infrastrukturës ekzistuese, etj, janë tregues që synojnë shfrytëzimin maksimal nga ana e stafit dhe studentëve të të gjithë infrastrukturës së vënë në dispozicion.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e</p>	<p>Dijet dhe njohuritë në programin e studimit, të shpërndara në orët në auditor kërkohen dhe gjejnë mbështetjen përmes literaturës së përshatshme për punën e studentit jashtë auditorit. Modulet e ofruara në këtë program studimi kanë literaturën bazë në gjuhën shqipe, të ofruar për studentët në forma të ndryshme si tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, materiale në web, etj. Aktualisht, institucioni ju ofron studentëve tekste të përkthyer nga titullarët e lëndëve që janë të aksesueshme në hard copy në trajtën e cikleve të leksioneve ose tekste me ISBN. Baza mësimore që u ofrohet studentëve është në varësi të modulit në forma të ndryshme si, tekste</p>




studimit.	<p>mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, material në website, etj. Materialet e vena ne dispozicion te studenteve jane ne forma te ndryshme. Ato variojne:</p> <ul style="list-style-type: none"> • materialeve fizike, të cilat ofrohen në librarinë e UBT_s apo dhe ne Bibliotekën e FEA_s, • librari elektronike me akses në disa prej revistave më të mira.
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Duhet thënë se materialet shpërndahen gjerësisht përmes siëstemit në google site në Web dhe kjo lehtëson aksesin tek materialet e leksioneve, detyrave, porojekteve. Studentët mund të përdorin përmes bibliotekës jo vetëm materialet fizike, por edhe ato në formë elektronike, si artikuj dhe libra në Librarinë elektronike TEEAL me akses në disa prej revistave më të mira, e cila u mundësua fillimisht nga projekti AHEED që UBT ka patur me Universitetin e Hawai-it, SHBA. Ndërkohë, përditësimi i kësaj biblioteke duhet të bëhet në vazhdimësi nga IAL.</p> <p>Një librari tjetër elektronike është mundësuar në kuadër të Projektit Erasmus+ “Library Network Support Services” (LNSS), pjesë e platformës Springshare, referuar linkut (https://lnss-albania.libguides.com/?b=p)</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë librarinë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>E reflektuar edhe në diskutimet me studentët dhe stafin, ka nje qasje drejt përdorimit të librarive on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. Fondi i bibliotekës është në përmirësim të titujve si vendas edhe të huaj, dhe punon në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e vet.</p> <p>Stafi i departamentit shprehte gadishmërinë e departamentit për t'i mbështetur me rifreskime të titujve të fundit per modulet që ata japin mësim.</p> <p>Sugjerohen zyrat mbeshtetese prane UBT te nxisin me shume studentet drejt perdorimit te bibliotekave online dhe te gjetjes se mekanizmave qe i shtyjne ata drejt ketij burimi informacioni. Gjate vizites ne biblioteken qendrore, u vu re se nje pjese e studenteve nuk ishin ne dijeni te ekzistences se librarise online dhe e perdornin infrastrukturen brenda bibliotekes per berjen e detyrave te kursit ose per te mesuar ne sezon. Per kete iu sugjerua stafit te bibliotekes qe te vendose njoftime ne vende te dukshme brenda bibliotekes per perdorimin e kesaj librarie online. Gjithashtu biblioteka e fakultetit ishte ne process hedhejeje te titujve dhe viteve perkatese dhe nuk kishte nje dokument final te tyre.</p>
	<p>Nga takimet me studentet dhe stafin por edhe me personelin mbeshtetes rezultojne perpjekje te vazhduara per te orintuar studentet drejt perdorimit te bibliotekave dhe njesive te tjera mbeshtetese pergjate</p>

<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>te gjithë vitit akademik. Studentët e FEA_skanë në dispozicion 5 (pesë) salla të pajisura me kompjutera (rreth 25 kompjutera secila sallë), si dhe 2 (dy) salla të reja laboratorike me kompjutera të realizuara në muajin Shtator 2017. Në këto kompjutera janë instaluar paraprakisht të gjitha programet (software) të nevojshëm për realizimin me sukses të punës së pavarur nga studenti. Këto salla janë produkt i projekteve të ndryshme ndërkombëtare, që kanë koordinuar anëtarët e stafit të FEA_s, ndërsa dy sallat e reja janë investim i universitetit me fondet e veta. Përmë shumë informacion mbi infrastrukturën e FEA_s (Aneks: Të Dhëna për Infrastrukturën e FEA_s)</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Perdorimi nga ky departament për këtë program studimi i një moduli i cili lidhet me informacioni online e shoqëruar me nxitjen dhe mbështetjen që i bëhet jo vetëm stafit por edhe studenteve përbën një nismë për t'u vlerësuar. Ka një qasje drejt përdorimit të librarive online të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. Fondi i bibliotekës është në përmirësim të titujve si vendas edhe të huaj, dhe punon në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e vet. Pedagoget përdorin sistemin online me platformat perkatese për hedhjen e sistemit të pikeve dhe vlerësimin të vazhduar të studenteve, dhe nga ana tjetër, studentet në kohë reale, në mënyrë të personalizuar dhe individualizuar, marrin vlerësimet e tyre në sistemet elektronike. Kjo është konsideruar moment i rëndësishëm dhe mjaft me vlerë për studentet dhe stafin mesimdhënës. Mjete të tjera elektronike që lidhen me literaturat, si pjesë shumë e rëndësishme e programit mësimor janë libraritë online, siç u përmend edhe në pikën III.3 kriteri 4, më lart. Projekte të ndryshme mundësojnë libraritë online, siç janë aktualisht Research4life me 5 (pesë) programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI)</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Vendosja në platformën online të të gjithë informacionit dhe mundësia e aksesimit të tyre nga studentet përbën një mundësi efektive të përdorimit të kohës nga studentet dhe rritje të efektivitetit të tyre. Stafit i departamentit paraqet në site-t personale në portalin e UBT-së leksione të moduleve përkatëse, raste studimore, detyrat e kursit si dhe materialeve të tjera. Secili staf i departamentit që është i angazhuar në mësimdhënie në programin Bachelor ka site-in e vet ku komunikon me studentët e kursit. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Ka një procedurë që është e percaktuar edhe me rregullore dhe e shpërndarë tek studentet në mjediset publike dhe elektronike të komunikimit. Pavaresisht procedurës normative, e cila përmirësohet sa herë që ka propozime nga stafi dhe studentet, pedagoget dhe i gjithë stafi është në mbështetje dhe ndihmë të studenteve që në fillim të vitit akademik për t'i mbështetur dhe suportuar ata jo vetëm në përzgjedhjen e temës së diplomës por asistimin pranë tyre për të patur të gjithë literaturën</p>

	bashekekohore, te huaj por edhe studimet me te mira vendase.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UBT ka institucionalizuar organizimin e njesive qe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. UBT ka hartuar një draft strategji të re, ku ndër të tjera theksi kryesor vendoset në fuqizimin e punës shkencore, për të realizuar një kërkim të integruar, ndërkombëtarizimin e kërkimit, krijimin e një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm, kontributin dhe në krijimin e bazës kombëtare të të dhënave në kërkimin shkencor, duke ju referuar kështu Planit Strategjik të UBT-së për periudhën 2016-2025, ku reflektohen qartë ambicjet në këtë drejtim.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p> <p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik i ketij institucioni eshte relativisht me histori pozitive dhe domethenese per te gjithë universitetin, eshte i shumte ne numer, dhe ka qene gjithnje i pranishem prane bizneseve shqiptare. Departamenti ka nje pergjegjesi dhe ndjeshmeri te madhe per te permiresuar cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p> <p>UBT ka hartuar një draft strategji të re, ku ndër të tjera theksi kryesor vendoset në fuqizimin e punës shkencore. Konkretisht, për të realizuar një kërkim të integruar, ndërkombëtarizimin e kërkimit, krijimin e një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm, si të kontribuojë dhe në krijimin e bazës kombëtare të të dhënave në kërkimin shkencor, duke definuar kështu planin e kërkimit për periudhën 2016-2025. UBT ka kapacitete humane dhe infrastrukturore të nivelit të lartë. Prioritetet e kërkimit janë të qarta dhe të përcaktuara sipas të gjitha njesive përbërëse. Departamentet janë bërthamat, të cilat përcaktojnë objektivat e kërkimit, në përputhje me prioritetet kombëtare, si dhe me ofertat europiane. Gjithashtu, departamentet janë ato që kryejnë aktivitetet kërkimore - shkencore.</p> <p>Studentët organizohen në takime dhe orë të hapura për implementimin në praktikë të të rejave të fundit të teknologjisë, aplikimin dhe nxitjen e projekteve inovative.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për</p>	<p>Duhet theksuar se nder shqetesimet, prioritetet dhe objektivat themelore ne drejtim te permiresimit te mesimdhënies nga DDA eshte pikerisht kualifikimi i stafit në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Duhet theksuar se në kontekstin e</p>

<p>të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>kërkimit stafi i DDA ka arritje të qënësishme. Numri i kënaqshëm i artikujve shkencorë të botuar në revista të huaja prestigjioze si edhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare të organizuara brenda dhe jashtë vendit janë tregues sinjifikativë në këtë drejtim. Kualifikimi i stafit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Bazuar ne dokumentacionin e vene ne dispozicioni, rezulton se DDA ka këtë kompozim nga pikëpamja e gradave dhe titujve:</p> <p>Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit për vitin akademik 2018-2019 ka një staf akademik të përbërë prej 20 pedagogësh, nga të cilët, 4 profesorë, 8 profesorë të asociuar, 6 doktorë dhe 2 MSc (Aneksi 23b).</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> <p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>UBT për realizimin e kërkimit shkencor, ka ofruar të gjithë mbështetjen institucionale, duke vënë në dispozicion të tërë infrastrukturën e UBT_s, për të krijuar dhe për të vendosur në dispozicion të stafeve efektive të departamenteve një infrastukturë bashkëkohore. UBT ka vijuar inkurajimin, zhvillimin dhe rritjen e dinamikës së kërkimit shkencor, duke gërshetuar punën e departamenteve me infrastrukturën mbështetëse si laboratorët, ambientet, resurset elektronike dhe bibliotekat.</p> <p>Këto metoda të reja janë transmetuar tek studentët dhe këto njohuri kanë rezultuar të jenë me vlerë dhe metodat të jenë të suksesshme. Nga ana tjetër, nxitja e këtyre bashkëpunimeve dhe partneriteteve ndikon, jo vetëm në rritjen cilësore të performancës së stafit, por edhe në ngritjen në një nivel më të lartë të transmetimit të dijeve tek studentët (metoda të reja mësimdhënie, mjete të reja mësimdhënie, metoda të reja të përfshirjes së studentëve në diskutim interaktiv).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. Keshtu rezulton sipas dokumentacionit se format e kontrollit të dijeve përcaktohen në mënyrë shumë të qartë në nenin 57 të Rregullores së studimeve të UBT. Sipas ketyre dokumentave format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: aktivizimet në orët e seminareve, testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, projektet apo detyrat e kursit, esetë dhe provimi final. Nga ana</p>

Sojani

AS

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>tjetër: provimi final mund të organizohet me shkrim, me gojë ose në një formë të kombinuar (me shkrim e me gojë). Por, mënyrat e kontrollit të dijeve, sipas pikës (a) të këtij neni, përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</p> <p>Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Në vlerësimin e vazhduar studenti në mesin e semestrit në javën e 7-8, që nga fillimi i semestrit i zhvillohet në orë të seminareve një provim i ndermjetëm, ku vlerësimi është në masën 20% të lëndës totale. Më pas, pjesë e vlerësimit të vazhduar janë dhe vlerësimi nga projekt kursi ose detyrë kursi në masën 10-15% dhe pjesa tjetër është vlerësimi nga pjesëmarrja aktive e studentëve në seminare laboratorë, që ata zhvillojnë. Praktikë e FEA_s, është që studentit të jetë gjatë gjithë kohës interaktiv, duke ju lehtësuar atyre kohën dhe mundin që do t'ju nevojitet në sezonin e rregullt, ku ju ngelet thjeshtë të përsërisin atë çfarë kanë përgatitur gjatë semestrit për modulet, që zhvillojnë. Dy herë në vit realizohen pyetësor, ku në to ju kërkohet studentëve të shprehin mendimin dhe vlerësimin e tyre për pedagogët në mënyrën se si ata zhvillojnë lëndët që mbulojnë dhe se sa praktike apo i sukseshëm ka qënë metodologjia dhe praktika e realizuar nga ta.</p> <p>Departamenti aplikon rigorozisht kriteret e vlerësimit të sanksionuara në Nenin 57 të Rregullores së Studimeve të UBT. Sistemi ESS3, Formati i Vlerësimit të Vazhduar (depozitohet për çdo modul në fund të Semestrit në departament) dhe Regjistri i Pedagogut janë objekt kontrolli nga ana e të gjitha instancave në UBT. Studenteve ju garantohet me rregullore çdo e drejtë në këtë drejtim dhe çdo ankese e tyre adresohet në mënyrë adekuate nga ana e strukturave përgjegjëse.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi i vazhduar përben një mënyrë të kujdeshme, të shprehur dhe të shprehur në kohë të vlerësimit të studentëve. Kjo është konsideruar nga stafi dhe departamenti si metode eficientë dhe të shprehur është institucionalizuar si mënyrë vlerësimi e testimit të njohurive dijeve dhe aftësive. Vlerësimi është i vazhduar dhe jepet në të gjithë procesin mësimor e finalizohet në fund të vitit. Pavarësisht se para fillimit të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit bëhet dhe reflektohet në dokumentacionin përkatës</p>

	<p>përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar që bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit i cili miratohet, në vijueshmeri të procesit. Ka një marrëdhënie të kujdesshme dhe mbështetje të stafit ndaj studenteve për reflektim të njohurive përmes pikeve, për të mbështetur studentet në përfundimin e pikeve, për t'i orintuar sa më mirë dijet dhe përpjekjet e tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Një ndër pikat e forta të këtij programi, të vlerësuar nga diskutimet me studentet por edhe stafin, por edhe të institucionit në përgjithësi është transparencja dhe mënyra e vlerësimit në kohë të studenteve. Konsiderohet si transparencja dhe mungesa e abuzimit nga studentet përdorimi i kësaj metode, ku askush nuk mund të shohë vlerësimet e tjetrit, duke ruajtur në këtë mënyrë privatesinë e studentit dhe rritur të drejtën për informim. Për vitin e ardhshëm akademik, UBT po shikon mundësinë e bërjes dhe vënies në funksionim të një sistemi të brendshëm elektronik të kontrollit të dijeve (provimeve finale dhe testeve të ndërmjetme) në mënyrë që të reduktojë në maksimum abuzimin dhe subjektivitetin në vlerësimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Brenda departamentit që ofron programin e studimit ka një procedurë të instaluar, e cila në fakt përdoret për të gjitha programet dhe është standarte. Kështu, komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për mësimin dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Çdo komision provimi përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë.</p> <p>Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, ose kur përgjegjësi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë. Në rast pamundësie zëvendësimi, me propozim të dekanit dhe miratim të Rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve nga përfundimi i tij</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Sigurisht që institucioni ka institucionalizuar, kontrolluar, monitoruar dhe bërë publike edhe testimin e vlerësimit të njohurive, dijeve.</p> <p>Për këtë që në nisje përdoren fletore tip, të cilat janë dizenuar në mënyrë të tillë, ku faqa e parë ka element të sigurisë. Aty bëhet sekretimi dhe ruajtja e anonimatis të studentëve.</p> <p>Edhe sistemi infrastrukturor mbështetës është i monitoruar me sistem qëndror kamerash, si edhe me personel shërbimi që ka si detyrë kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe provimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Ka një rregullorë që institucionalizon vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit dhe variantet e ndryshme të reagimit të studentit si dhe rradhen e veprimeve të kryera.</p> <p>Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Institucionalizimi i këtij procesi ka përfshirë me kujdes të gjithë elementet: mbarevajtjen e procesit mësimor, monitorimin dhe kontrollin e provimit, etj.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse</p>	

dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.				
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve, kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit, kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni, përmes rregulloreve përkatëse është kujdesur që procesi i testimeve të nxenurit, të kontrollit të dijeve dhe aftësive përkatëse profesionale të bazohet mbi meritokracinë, të jetë një proces i kujdesshem, gjithpërfshirës, dhe bazuar dhe strukturuar mbi bazën e rregulloreve përkatëse. Kështu, testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit dhe provimi final janë format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve, sipas Nenit 65 të Rregullores së FEA. Po kështu, institucioni kujdeset që të informojë në kohë reale studentet për këto procese, që në fillim të viti akademik.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Nderkohe që në planet mesimore dhe syllabuset përkatëse janë praqitur të strukturuar dhe shpjeguara të gjitha detajet e vlerësimit, kohët përkatëse, menyrat e zhvillimit të testimeve etj. Gjithashtu, institucioni i reflekton jo vetëm në web-in e universitetit por edhe në mjediset e brendshme fizike brenda universitetit, të gjitha njoftimet. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studenti është në qendër të procesit edhe në këto rast, duke e informuar, vlerësuar për çdo hap të vlerësimit që ka lidhje me provimet dhe rezultatet përkatëse.			
	Po në këto mjediset e brendshme fizike afshohen edhe edhe njoftimet për vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Këto njoftime bëhen me dije edhe në rregulloren e universitetit, të programit të studimit sikurse edhe në faqen përkatëse të internetit apo në adresat individuale të studenteve. Në këto mënyra garantohej jo vetëm privatesia e informacionit, por garantohej dhenia e informacionit dhe saktësia e tij nga shume burime.			
	Procedura e ankimit nga ana e studentit është e dokumentuar, zbatohet me përpikëri dhe menaxhohet nga përgjegjësi i departamentit deri në rastet kur shkon në dekanat.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**Standardi III.7**

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Njohuritë dhe aftësitë profesionale që fiton studenti përmes këtij programi studimi janë të plota, të bazuara në një literaturë të plotë, koherente si në gjuhën shqipe ashtu edhe atë të huaj, të ofruar nga një staf cilësor me eksperiencë, dhe nga një departament me një histori suksesi në të shkuarën dhe përkushtim gjithëpërfshirës aktual dhe të orientuar drejt sfidave të reja. Kjo bazohet jo vetëm në dokumentacionin e venë në dispozicion, por edhe nga diskutimet gjate takimeve të zhvilluara në institucion me të gjitha grupet e interesit.</p> <p>Kurrikula e studimeve Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi është strukturuar në përputhje me VKM Nr. 41, Dt. 24/01/2018 dhe me konkretisht: 1. Lendet baze "Pergatitja metodologjike dhe kultura e pergjithshme" konsistojne ne 5 Module-30 kredite dhe zene 16.7% te totalit te krediteve. 2. Lende karakterizuese "Pergatitja per disiplinen shkencore"-18 Module-93 kredite dhe zene 51.7 te totalit te krediteve. 3. Lende nderdisiplinore integruese-5 Module-22 kredite dhe zene 12,2 te totalit. 4. Lende plotesuese-3 Module-26 kredite-14.4% te totalit. 5. Detyrime permbledhese-"Teza e Diplomes"-9 kredite-5% e totalit te krediteve te programit.</p> <p>Lëndët që bëjnë pjesë në kurrikulën e programit të studimit Bachelor Menaxhim Agrobiznesi përfshijnë lëndët, që japin formimin e përgjithshëm bazë të lëndëve të kurrikulës (si p.sh hyrja në informatikë, mikroekonomi, makroekonomi, statistikë,) dhe gradualisht në vitet pasardhëse thellohen njohuritë në fushën e Agrobiznesit me njohuri aplikimi në biznese. Kjo kurrikul garanton gjithashtu zhvillimin e aftësive të veçanta përveç atyre specifike për profilin, duke ofruar module sikurse janë ato në fushën: e teknologjisë së informacionit - Informatika dhe Njohuri për Informacionin; humane e sociale – Sociologji, Bazat e së Drejtës dhe Histori e Mendimit Ekonomik; e komunikimit dhe ndërveprimit – Komunikim Biznesi dhe Gjuhë e Huaj.</p> <p>Kjo kurrikul garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre.</p> <p>Në përfundim, të çdo moduli pedagogu i bënë me dije studentët për modelin dhe formatin e tezës së provimit, që do të përdoret duke e shoqëruar me një listë të pyetjeve, që korespondojnë me çështjet më të rëndësishme të trajtuara në modul. Gjithashtu, pedagogët e modulit i informojnë studentët për lidhjen e modulit përkatës me shumë module të tjera dhe nga ana tjetër i tregojnë se, ku mund të zbatohen shumë tema të zhvilluara të këtij moduli në praktikë.</p>




<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>(Aneksi 14: Dosja e programit të studimit)</p> <p>Ne te gjithë zhvillimin e mesimit per te gjithë semestrin dhe periudhen kohore kur zhvillohet nje lende/modul i caktuar, behet me dije si nga drejtuesit e departamentit, grupi i punes, studentet, apo edhe stafi i pedagogeve se terhiqet, vleresohet dhe reflektohet mendimi dhe opinionin e studenteve ne lidhje me reflektime te ndryshme per permiresime, ndryshime, risi apo inovacione ne lende, objektiva apo ne teresine e syllabusit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në Planin e Aktiviteteve të UBT_s një nga pikat është edhe zhvillimi i Leksione të Hapura nga personalitete të ftuara të fushës (Programi i Masave të Mirëfillim Vitit Akademik 2018-2019, Seksioni 2-Mësimdhënia, gërma b, fq.6. 2018-2019. miratuar më datë 10.09.2018).</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Format e mësimdhënies në programin e studimit Bachelor Menaxhim Agrobiznesi, përveç leksioneve janë dhe seminarët, të cilat aplikojnë çdo njohuri të marrë në leksione duke i zbatuar ato me asistimet në bizneset e agroturizmit apo bizneset e turizmit rural. Por, duke konsideruar, gjithashtu se Teknologjia e Informacionit dhe komunikimit është tashmë esenciale në formimin e menaxherëve, rëndësi e madhe u është dhënë edhe përdorimit të software, që ndodhen të instaluar në laboratorët e programit të studimit. Këto software shkarkohen në fillim të vitit akademik dhe instalohen në kompjuterat e laboratorëve përkatës p.sh Dev C++, SQL server, Ubuntu, Visual Studio, që përdoren përkatësisht për lëndët, Hyrje në Informatikë, Database dhe Menaxhimi, Sistemet e Shfrytëzimit, ASP.net dhe C#.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instruktin grupin e studentëve në realizimin e detyrës së caktuar (raste studimi / situatë reale tregu apo simulim i zgjidhjes së një problemi biznesi). Projektet dhe detyrat e kursit përfshihen dhe në vlerësimin e vazhduar të studentit, kështu që kjo përveçse i ndihmon studentët për të rritur frymën e bashkëpunimit në grup dhe për të marrë njohuri më të thella lidhur me lëndë të caktuara, i ndihmon edhe për vlerësimin përfundimtarë më të plotë të lëndës përkatëse, ku përveç provimit përfundimtarë futet dhe vlerësimi i vazhduar.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Në këtë proces, personeli akademik mbështet idetë novative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat dhe momentet që kanë nevojë për më tepër informacion dhe studim të mëtejshëm. Këto probleme pastaj bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema masteri, por edhe tema doktrature për kërkuesit e rinj në të ardhmen.</p>
	<p>Nje nder strategjite afatmesme te institucionit, ne funksion te ritjes se aftesive krijuese te studentit por edhe testimi te identifikimit te te gjithë aftesive te tij, eshte qe ne afatin e gjate synohet qe shperndarja e pikeve brenda nje moduli te behet 50 me 50, gjykohet qe studenti ti shperndaje sa me shume piket gjate vitit dhe te mos i kete vetem ne provim. Kjo ka ardhur nder vite, eshte</p>

<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>nje vendimarrje e kujdeshme qe ka vite qe propozohet nga stafet, dhe studentet me qellim qe te asimilohet sa me shume lenda gjate vitit. Ky ndryshim gradual eshte perceptuar pozitiv nga studentet, dhe kjo eshte treguar nga analizat e pyetesoreve qe behen ne fund te vitit, analizat e pyetesoreve e kane treguar kete. Eshte konstatuar se studentet kane ndjeshmeri dhe kerkojne nje rezultat sa me te larte gjate vitit e cila do t'i coje ata ne nje rezultat sa me te larte ne fund, por mbi te gjitha do te sherbej si instrument te testojte aftesite e tyre profesionale por edhe te zhvilloje e nxise edhe ato krijuese.</p> <p>Ne kuader te nderkombetarizimit te te gjitha universitetit, por edhe te programeve te vecanta, vecanerisht te ketij programi qe perben nder programet me te kahershme dhe te sukseshme nder dekada te universitetit, mobiliteti i studenteve, dhe nderthurja e bashkepunimi i formave te mesimdhënies dhe mesimnxënies edhe me universitetet nderkombetare bashkepunuese perben nje argument delikat, ne vemendje, ne fokus dhe mjaft te rendesishem ne te gjitha filozofine e mesimit.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Departamenti qe ofron kete program studimi jo vetem qe ka institucionalizuar te gjitha procesin e diplomimit te studenteve te ketij programi duke i dhene peshen dhe rendesine e vet, por manaxhon, organizon, mbikqyr te gjitha procesin duke kordinuar dhe optimizuar te gjitha burimet e brendshem dhe te jashtme per nje diplomim cilesor te studenteve.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Lidhur me provimin final dhe mbrojtjen e diplomës departamenti harton një procedurë të posaçme ku përfshihen disa hapa. Kështu departamenti u bën të njohur programet e provimit të formimit studentëve të vitit të tretë brenda një periudhe një mujore nga fillimi i vitit akademik. Këtu përfshihet si mbështetëse Sekretaria Mësimore e cila informon studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. Gjithashtu brenda mujait të parë, bën një listë të studentëve që planifikohen të mbrojnë diplomën me një kërkim të tyre, bazuar në mudnësitë e departamentit për udhëheqje dhe rezultatet e studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Mund të përfshihen në këto udhëheqje edhe specialist të kualifikuar nga institucione të tjera kërkimore, në rastet kur kërkesat e studentëve për tema diplome janë më të mëdha sesa mundësitë që ofron departamenti. Eshte per t'u thkesuar se departamenti asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p>Fakti që integrohen udhëheqjet e pedagogëve të brendshëm me ato të jashtëm përbën edhe një mënyrë për të integruar stafin e brendshëm me eksperiencën e atij të jashtëm, ose për më shumë për të patur një mundësi që studentët të realizojnë një kërkim sado të vogël në biznese aktuale shqiptare duke pasuruar bibliotekën e departamentit por edhe duke vijëzuar mbështetjen që departamenti i bën biznesit vendas në çështje të agrobiznesit, por jo vetëm.</p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Mbi bazën e dokumentacionit, rregulloreve dhe diskutimeve përgjate vizites në institucion rezultoi se në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Modeli i diplomës "Bachelor" në programet e Studimit të DDA, miratohet nga Senati Akademik.</p> <p>(Aneksi 15a: Model Diplome Bachelor MA)</p> <p>(Aneksi 15b: Supplement diplome Bachelor MA)</p> <p>Gjithashtu është dokumentuar edhe fakti që dokumentacioni për studentët ruhet për një periudhë të pacaktuar në hard copy (regjistrat e mëdhenj të studentëve) si dhe në databazën dixhitale që tashmë disponon UBT - Sistemi ESSE3. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>
--	-------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------

standardeve të fushës III	përbushet	pjesërisht	kryesisht	t plotësisht
				✓

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, DDA analizon nevojat dhe kërkesat për personelin akademik të programit të studimit duke përpiluar një dokument ku planifikohet ngarkesa mësimore e vitit në fjalë. Në përfundim të këtij procesi, departamenti parashikon se cilat janë nevojat për personel të ftuar, të cilët do të përbushin detyrat dhe përfitojnë të drejta kundrejt një kontrate. Për menaxhimin e marrdhënies së punës me këta individë, UBT ka miratuar edhe rregulloret përkatëse në lidhje me menaxhimin dhe rekrutimin e personelit (Aneksi 11- Rregullore e drejtorisë së Menaxhimit të MBNJ & Aneksi 61 – Rregullore e rekrutimit UBT).</p> <p>Bazuar në nevojat e përcaktuara nga DDD, procesi i rekrutimit të personelit të ftuar koordinohet me Drejtorinë e Menaxhimit të Personelit dhe Pagave. (Aneksi 61 - Rregullore e rekrutimit UBT - Neni 3, Pika 4).</p> <p>Për secilin anëtar të personelit akademik dhe ndihmës akademik që është i përfshirë në këtë program studimi, disponohet dosja me të gjitha dokumentet përkatëse.</p> <p>Nga vizita e realizuar në zyrën e BNJ, nga dosjet e personelit akademik të shqyrtuara (2 dosje - 1 PAE dhe 1 PAK), rezultoi se të dhënat në lidhje me titujt e fituar në kohë dhe karrierën përditësohen duke plotësuar informacionin. Specialisti i Zyrës së Burimeve Njerëzore, përgatit informacion e detajuar për evidencat e punonjësve (Aneksi 11- Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave- Neni 4, pika 7 dhe Neni 7, pika 10). Ky informacion i vendoset në dispozicion institucioneve përkatëse si brenda dhe jashtë vendit. Kuptohet që ky informacioni i përditësuar ruhet në arkivën e Institucionit (Aneksi 11- Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave- Neni 4, pika 7; Neni 7, pika 1,2,3 & 4; Neni 9).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Drejtoria e menaxhimit të Personelit dhe Pagave ndjek procedurat e posaçme për rekrutimet e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e Rregullores së kësaj drejtorie. Në bashkëpunim me departamentin, kjo drejtori kujdeset për plotësimin e nevojave për personel akademik të brendshëm dhe të ftuar në këtë program studimi.</p> <p>Edhe nga vizita e realizuar në zyrën e BNJ dolën në pah detyrat që kryen në lidhje me këtë proces. Kjo procedure konsiston në: koordinimin e punës me njësinë bazë për programin Bachelor në MA, ku njësia bazë paraqet kërkesën për personel të ftuar bazuar</p>

	<p>në nevojat e evidentuara në fillim të vitit akademik si dhe kriteret e veçanta; më pas hartohet oferta e punës duke përfshirë këtu kriteret e pranimit, të përgjithshme dhe të veçanta; më tej vazhdohet me shpalljen e njoftimit për vend pune vakant në web si dhe në buletin e APP-së, për një afat kohor 20 ditë; më pas krijohen komisionet për vlerësimin e dosjeve, zhvillohet konkursi dhe pas tij jepet informacioni përfundimtar dhe shpallet vendimi. (Aneksi 11- Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave- Neni 6)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Siç përmendet edhe më sipër, Drejtoria e Menaxhimit të Personelit dhe Pagave, në bashkëpunim me DDA realizon procedurë të qarta për mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit të personelit akademik. UBT, mbështetur në rregulloren e rekrutimit (Aneksi 61), përcakton të gjitha hapat e procedurës që parashikon rregullorja (Aneksi 61: Rregullore e rekrutimit UBT, Neni 3 & Neni 4), të cilat respektohen në mënyre rigorozë; si dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit (Aneksi 61 - Rregullore e rekrutimit UBT, fq.8-9 “Kriteret e rekrutimit”) të cilat, siç u përmend edhe më sipër, bëhen publike si në APP edhe në faqen zyrtare të UBT. Në anekset e kësaj rregulloreje mund të shihen qartësisht formatet e pikëzimit të këtyre kriterëve (Aneksi 61 - Rregullore e rekrutimit UBT, fq.8-9 “Kriteret e rekrutimit” & Aneksi 21 - Praktikë punësimi staf akademik).</p> <p>E njëjta procedurë u shpjegua edhe gjatë vizitës së kryer në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e rekrutimit të UBT (Aneksi 61) gjejmë të pasqyruara kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e personelit akademik. Në këtë proces rekrutimi, Departamenti dhe Zyra përgjegjëse e rekrutimit të personelit, kujdesen që të respektojnë nenet e rregullores në fjalë.</p> <p>Në Rregullore, në shtojcën e saj gjejmë të pasqyruara kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. Këto kriteret përfshijnë notën mesatare të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, profilin e studimit, shkollim dhe kualifikim të mëtejshëm, përvojën e punës në mësimdhënie, kualifikime brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj. (Aneksi 61 - Rregullore e rekrutimit UBT, fq.8-13 “Kriteret e rekrutimit” & Aneksi 21 - Praktikë punësimi staf akademik).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit. Kjo si në aspektin e kushteve por edhe të mundësive për të marrë informacionin e nevojshëm.</p> <p>Nga vizita e realizuar në ambjentet e Institucionit, konstatuam se DDA e ka prioritet sigurimin e mjediseve për realizimin e detyrave dhe dhënien e mundësive të barabarta personelit akademik të saj. Çdo anëtar i personelit akademik ka një zyrë të pozicionuar në një nga dy godinat e FEA, ku mund të punojë më në mënyrë të pavarur. Zyrrat janë të pajisura me mjete dhe pajisje të nevojshme (si kompjuter, fotokopje videoprojektor etj.) për zhvillimin e detyrave përkatëse të personelit akademik. Mjediset ku zhvillohet mësimi, si auditore dhe klasa, kanë pësuar përmirësime duke plotësuar kriteret e nevojshme për të zhvilluar procesin e mësimdhënies në mënyrë sa më cilësore. Gjithashtu, mundësimi i sistemit wireless në mjediset e Fakultetit ndihmon në përmirësimin e këtij procesi.</p> <p>Funksioni i sekretarisë së departamentit luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kontaktit ndërmjet kësaj zyre dhe personelit apo studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Në strategjinë e UBT ndër të tjera, prioritet është edhe kërkimi shkencor. Kërkimi shihet si pjesë integrale e rolit akademik dhe një faktor kyç në promovim. Institucioni e ka vendosur theksin në identifikimin e fushave të qendrueshme të kërkimit si dhe në bashkërendimin e përfshirjen e elementeve të planifikimit të veprimtarisë shkencore në nivel departamenti (Aneksi 3 – Plani Strategjik i UBT).</p> <p>Institucioni, gjithashtu dhe DDA, mbështet aktivitetin kërkimor dhe shkencor ku nëpërmjet të cilit nxit personelin akademik për zhvillim profesional të vazhdueshëm (Aneksi 2- Statuti i UBT- Neni 59, pika 5a). Tematika e kërkimit në UBT zhvillohet në përputhje me prioritetet e kërkimit dhe programet e ofruara (Aneksi 2- Statuti i UBT- Neni 59, pika 6).</p> <p>Organizimi i grupeve mësimore dhe kërkimore në DDA parashikon një ndarje më të orientuar të punës kërkimore dhe shkencore në drejtim të fushave dhe projekteve prioritare. Detyrat dhe funksionet e këtyre grupeve kërkimore në drejtim të kërkimit shkencor janë të përcaktuara qartë dhe përfshijnë përmbushjen, hartimin dhe implementimin e planeve vjetore të kërkimit shkencor, organizimin e bashkëpunimeve me grupe të tjera kërkimore e shkencore brenda ose jashtë Institucionit apo vendit, bashkëpunimeve me sipërmarrjet private, publikimin e rezultateve të punës kërkimore shkencore dhe nxitja e botimeve shkencore brenda dhe jashtë vendit, etj. (Aneksi 6b- Rregullore e DDA- Neni 7, Pika b).</p> <p>Personeli akademik i DDA ka treguar arritje të kënaqshme në fushën e kërkimit. Ky fakt mbështetet në numrin e kënaqshëm të artikujve shkencor të botuar në revista të huaja të njohura si edhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare organizuar brenda dhe</p>

	<p>jashtë vendit (Aneksi 43a - Publish&Perish_Staf akademik DDA 2018; Aneksi 43b- Raporti i Analizës së Punës Kërkimore UBT 2017 & Aneksi 43c - Analiza e punes shkencore DDA 2018). Kualifikimi i personelit akademik në fushën e kërkimit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies (Aneksi 3 – Plani Strategjik i UBT).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Personeli akademik i këtij programi studimi është i kualifikuar dhe i aftë në përdorimin e teknologjive të reja dhe metodave inovative në funksion të mësimdhënies sa më cilësore. Institucioni krijon mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin (si, videoprojektorët, disponibiliteti i shërbimit të internetit etj.) dhe vendosjen në dispozicion të materialeve udhëzuese në përdorimin e metodave inovative, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm komunikimin e shpejtë dhe efektiv me studentët. Metodatat inovative që përdoren dhe zhvillohen për rritjen dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies listohen si më poshtë (Aneksi 39 - Udhëzues për zhvillimin e metodave inovative):</p> <ul style="list-style-type: none"> • E-Learning është një mënyrë elektronike e të mësuarit, që nënkupton dhënien e njohurive, mësimdhënies ose studimit, duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike si kompjuter, pajisje mobile etj; • Google site është një aplikacion online që ndihmon në krijimin e një projekti në web ose të një faqe web-i. Pedagogët në UBT kanë krijuar me anë të këtij aplikacioni websitet e tyre personale ku studentët mund të aksesojnë materialet e lëndëve që zhvillohen nga këta pedagogë. https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/site menager/home • MOODLE (Virtual Learning Environment) - një aplikacion LMS (Learning Management System) i cili mundëson menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor, nëpërmjet krijimit të faqeve web dinamike për studentët nga ana e pedagogëve. • TEEAL (The Essential Electronic Agricultural Library) është një bibliotekë online ku stafi akademik i UBT mund të aksesojë publikime të ndryshme. • Moduli online “Njohuri për informacionin” është një pakete e përkthyer me libra online të Universitetit të Cranfield (Mbretëria e Bashkuar), e cila orienton studentin se si të gjejë informacionin e duhur për të shkruar një detyrë apo punë shkencore. Ky modul është rezultat i Projektit TEMPUS. • Sistemi ESSE3 është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta unversitare deri në mbrojtjen e diplomës. <p>Personeli akademik i departamentit të Drejtimit të Agrobiznesit ka</p>

	<p>qënë pjesë e mjaft mobiliteteve Erasmus+ me karakter trajnues për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies. Në objektivat dhe rezultatet e këtyre mobiliteteve janë qartësisht të motivuara qëllimet e vizitave dhe pritshmëritë e tyre. Në kuadër të këtyre projekteve të bashkëpunimit, personeli akademik i DDA ka qënë pjesë e disa trajnime të rëndësishme në këtë kontekst, përmendim këtu: “Grant Writing” dhe “Prioritization Settings” (organizuar nga projekti AHEED), trajnimi i realizuar nga projekti DOCSMEC në lidhje me e-learning si dhe trajnimi për përdorimin e metodës “Conjoint Choice Analyses” (projekti AHEED - UBT me Universitetin e Hawaii) si një metodologjie kërkimi. Si rezultat i përdorimit të metodologjisë së kërkimit janë realizuar shumë artikuj shkencor dhe punime doktorature. (Aneksi 66- Lista e projekteve të UBT 2017-2018 & Aneksi 43c - Analiza e punes shkencore DDA 2018).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit kujdeset që të respektojë planet, objektivat dhe rezultatet e paracaktuara të programit të studimit. Planet mësimore, syllabusi, orari i mësimit dhe dokumenta të tjera që personeli akademik depoziton në departament (si regjistri i pedagogut, rezultatet e vlerësimit të studentëve gjatë semestrit, etj.) dëshmojnë për korrektësi dhe respektim të këtyre elementeve nga personeli akademik duke krijuar në këtë mënyrë një vazhdimësi komunikimi me studentët. Ky fakt mbështetet dhe dëshmohet nga pyetësorët që studentët plotësojnë përpara sezonit të provimeve (2 herë në vit), në vlerësimin e përfundimit të personelit akademik, rezultatet e të cilit janë pjesë e analizën vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Nga ana tjetër, vihet re angazhimi i personelit akademik të programit në përmirësimin e vazhdueshëm të materialeve mësimore. Për këtë vjen në ndihmë edhe përdorimi i bibliotekës online “TEEFAL” duke mundësuar aksesin dhe përdorimin e artikujve të viteve të fundit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve

Procesi mësimor për programin e studimeve Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi zhvillohet pranë ambjenteve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore, Godina A dhe Godina B.
Godina A është e organizuar në 2 kate dhe ka në përbërje të saj 7

mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh, si dhe 4 laboratorë (të pajisura me 25 kompjutera secila sallë) për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të programit. Ndërsa godina B është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj 8 salla leksionesh dhe 23 salla seminaresh, si dhe 2 laboratorë (krijuar dhe vendosur në funksionim në shtator 2017) për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të programit. Në kompjuterat e këtyre laboratorëve janë instaluar të gjitha programet (software) e nevojshme për realizimin me sukses të punës së pavarur nga studenti. Këto salla janë produkt i projekteve të ndryshme ndërkombëtare (të koordinuara nga anëtarët e stafit të FEA-s) dhe investim i universitetit (dy sallat me fonde të Universitetit). Lëndët e këtij programi studimi që kërkojnë aplikim në këto laboratore për të aplikuar aftësitë teknologjike të menaxhimit të informacionit apo të analizës së të dhënave janë: “Statistikë biznesi”, “Informatikë”, “Njohuri mbi informacionin”, etj.			
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimit teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Ambientet ku zhvillohet mësimi i këtij programi studimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme në përputhje me normativën e përcaktuar në VKM. nr. 418 date 10.05.2017, sipas të cilit kërkohen 2.5 m ² për një student. Duke ju referuar sipërfaqes totale rezulton se FEA zotëron kapacitete mbajtëse për një numër prej 1544 studentë (3860:2.5).			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita e realizuar në ambjentet e Fakultetit konstatoam se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për të zhvilluar një proces sa më cilësor të mësimdhënies. Në këto mjedise gjejmë mjete mësimore të duhura që lejojnë një zhvillim normal të procesit mësimit. Gjithashtu, mundësimi i sistemit wireless në mjediset e Fakultetit ndihmon në përmirësimin e këtij procesi.			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Klasat ku zhvillohen orët e seminareve janë të pajisura me video-projektorë dhe mjete të tjera audiovizuale duke mundësuar në këtë mënyrë një realizimin sa më cilësor të seminareve.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Gjithashtu, siç përmendet edhe në Standardin IV.2.1, zyrat e personelit akademik janë të pajisura me mjete dhe pajisje të nevojshme (si kompjuter, fotokopje videoprojektor etj.) për zhvillimin e detyrave përkatëse të personelit akademik .			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	(Aneksi 42 - Infrastruktura Lista e Mjediseve ne funksion te Mesimit te UBT & Lista e projekteve FEA)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës ka dy biblioteka: (1) Biblioteka “Mentor Përmeti”, e cila vendoset në dispozicion të gjithë institucionit dhe (2) Biblioteka në funksion të FEA.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi mund të shfrytëzojnë mjediset e të dy bibliotekave si në aksesin e literaturës ashtu dhe në përgatitjen mësimore.</p> <p>Gjithashtu, studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekën online, ku ky shërbim ofrohet pa pagesë. Informacioni online ofrohet nga burime elektronike me abonim ose falas, nga projekte të ndryshme si Research4life me 5 programe: Hinari, Agora, Oare, Ardi, Goali. Biblioteka e UBT-së, pjesë e së cilës është edhe biblioteka e FEA-s, disponon platformën Springshare (http://ubt.edu.al/sq/biblioteka-e-universitetit-bujqesor-te-tiranes/platforma-springshare-lnss-western-balkans-albania/ https://lnss-albania.libguides.com/?b=g&d=a) që mundëson rritjen e interaktivitetit të shërbimeve të bibliotekës me studentët.</p> <p>Gjithashtu, studentët mund të përdorin katalogun online që ofron biblioteka (http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss).</p> <p>Të gjithë Informacionin në lidhje me shërbimet që ofron biblioteka studentët e aksesojnë edhe online në faqen përkatëse (http://ubt.edu.al/sq/sherbimet-ne-biblioteke/).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve</p>	<p>Biblioteka e Universitetit Bujqësor, si rezultat i pjesëmarrjes në projekte që kanë patur në fokus veprimtarinë e saj, ka zhvilluar strategjinë e saj dhe Politikën e Pasurimit të fondit të Bibliotekës.</p> <p>Në Bibliotekën e FEAs, studentët e këtij programi studimi gjejnë tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve që ndjekin dhe literaturën ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazën e planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. Në këtë bibliotekë gjenden: 500 tituj në gjuhën shqipe, 2.200 tituj në gjuhë të huaj si dhe 1.700 materiale-periodikë. Fondi i bibliotekës pasurohet në mënyrë të vazhdueshme (në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj) duke synuar të reflektojë ndryshimet cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përditësimin e fondit merren në konsideratë vazhdimisht edhe sugjerimet e studentëve në mënyrë që të sigurohet literaturë sa më e përshtatshme.</p> <p>Përveç materialeve fizike të cilat ofrohen në librarinë e UBT apo dhe në Bibliotekën e FEAs, institucioni zotëron edhe librarinë elektronike TEEAL (mundësuar nga projekti AHEED që UBT ka patur me Universitetin e Hawaii), me akses në disa prej revistave më të mira. Përditësimi i kësaj biblioteke në vazhdimësi bëhet nga</p>

<p>në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>IAL.</p> <p>Nga vizita e realizuar në ambientet e Bibliotekës së FEAs u vu re se biblioteka ofron hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët. Salla e studimit ka një kapacitet 50 vende dhe është e pajisur me kompjutera nga ku studentët mund të aksesojnë librarinë elektronike dhe të kryejnë punë kërkimore individualisht apo në grup. Kapaciteti i stafit të bibliotekës është i tillë që përballon nevojat e studentëve për shërbim, apo edhe shfrytëzim të mjediseve për punë në grup apo prezantime. Numri i punonjësve të bibliotekës është 8. Stafit të bibliotekës zotëron njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit dhe gjuhëve të huaja kryesisht anglisht, si dhe zotëron aftësi për të ofruar shërbime përkatëse. Biblioteka frekuentohet çdo muaj nga rreth 300 studentë. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimin, i cili është plotësisht i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të studentëve të programit bachelor në MA.</p> <p>(Aneksi 33 - Plani Strategjik i Bibliotekës: Aneksi 45 - Biblioteka & Biblioteka online TEEAL)</p>								
	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 929 758 1019">Nuk përbushet</th> <th data-bbox="758 929 981 1019">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="981 929 1204 1019">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1204 929 1388 1019">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1019 758 1064"></td> <td data-bbox="758 1019 981 1064"></td> <td data-bbox="981 1019 1204 1064"></td> <td data-bbox="1204 1019 1388 1064">✓</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				✓
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			✓						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët, nga momenti i regjistrimit deri në çertifikimin përfundimtar apo pajisja me diplomë sipas ciklit përkatës.</p> <p>Ky sistem përfshin: (1) Informacionin që regjistrohet dhe mbahet në hard-copy; dhe (2) Informacionin që regjistrohet në formë elektronike.</p> <p>Zyra e cila kujdeset në menaxhimin e një procesi të tillë është Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) e cila kryen veprimtarinë e mëposhtme (Aneksi 9 – Rregullore e ZSS - Kreu V, pika 1,2&3):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i studentëve dhe mbajtja e bazës së të dhënave dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike; • Plotësimi i të gjithë dokumenteve individuale çertifikues mbi rezultatet e pjeshme ose të plota të studimeve; • Mbajtja e dokumentacionit mbi procesin mësimor dhe ndjekja e ecurisë së procesit mësimor. Mbahet informacion lidhur me studimet (planet mësimore, strukturat e vitit

	<p>akademik etj.) për të gjitha drejtimet e diplomimit në të tre ciklet e studimeve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në Universitet (Aneksi 9 – Rregullore e ZSS - Kreu VI.I.1).</p> <p>Kjo zyrë menaxhon edhe dokumentacionin themelor për studentët në përputhje me ligjin në fuqi. Nga vizita e realizuar në ambjentet e ZSS patëm mundësi të vëzhgonim nga afër këtë dokumentacion:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistri themeltar pasqyron rregjistrimin e studentit duke u identifikuar me numër unik matrikullimi, i cili i shërben studentit deri në momentin e marrjes së diplomës. Në lidhje me programin bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018, rezultojnë të ketë vetëm dy studentë pa numër matrikullimi, ndërsa për vitin 2018-2019 rezultojnë 14 studentë pa numër matrikullimi për problematika të ndryshme. Institucioni është në pritje të përgjigjes nga QSHA për rastet në fjalë. • Regjistri i pedagogut, në të cilin pasqyrohen mungesat dhe vlerësimet e secilit student (Aneksi 6b- Rregullores e Brendshme e DDA-s- Neni 56, Pika 1&2). • Regjistri ku mbahet lëshimi i diplomave për studentët sipas programit përkatës. <p>Këto regjistra ruhen në arkivën e Institucionit për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së tij. (Aneksi 2- Statuti i UBT- Neni 67 dhe 68; Aneksi 6b - Rregullore e DDA- Neni 95)</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Informacioni mbi personelin e Institucionit menaxhohet dhe ruhet nga njësitë dhe zyrat përkatëse, të tilla si: (1) Departamenti i DDA, (2) FEA, (3) UBT, (4) Zyra e Personelit dhe Pagave, dhe (5) Zyra e Financës; si në formë elektronike edhe në hard-copy.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacioni që ruhet për stafin akademik, ndihmës-akademik dhe të angazhuar, dokumentohet përmes Cv-së, planeve mësimore, syllabuseve, ngarkesës akademike, ngarkesës për kontributin institucional dhe ngarkesës intelektuale. Këto dokumente ruhen në departament dhe bëhen pjesë integrale e analizës mësimore dhe shkencore të departamentit. • Analiza mësimore dhe shkencore duke qënë se përcillet në Fakultet dhe Rektorat, bëhet pjesë e të dhënave të përgjithshme të institucionit. • Dokumentacioni për pedagogët e ftuar të programit ruhet në departament, fakultet, në zyrën e personelit dhe pagave si dhe në zyrën e financës. • Dokumentacioni i përditësuar i personelit të përfshirë në këtë program studimi mbahet në dosje në zyrën përgjegjëse

	<p>për personelin si dhe në zyrat e financës në për pagesat që kryen sipas kategorive përkatëse. Ky dokumentacion i bëhet transparent edhe vetë punonjësve. (Aneksi 11 - Rregullore e Drejtorise se MBNJ dhe pagave - Neni 4).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e personelit akademik të këtij programi studimi, pasqyrohet në portalin e UBT-së në websitet e pedagogëve për të mundësuar marrjen e informacionit nga të interesuarit në distancë dhe për të analizuar marrëdhënien pedagog-student (Aneks 69 - Pamje nga web i pedagogut).
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit siguron akses në informacione dhe dokumenta si për personelin edhe për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi merr informacion mbi analizën e veprimtarisë mësimore dhe shkencore nëpërmjet diskutimit të tyre në mbledhjet e organizuara në nivel departamenti.</p> <p>Informacionin në lidhje me aktivitetin e personelit të programit bëhet publik në websitet personale të personelit, web-in e UBT, si dhe paraqitet në stenda.</p> <p>Shpërndarja e informacionit që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor dokumentohet në stenda dhe web-in e Universitetit me seksion të veçantë për fakultetin, departamentin apo edhe programin e studimit. Ky informacion lidhet me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, kurrikulën e programit, prioritet e kërkimit dhe fushat e ekspertizës, mundësitë e punësimit, kompetencat e stafit dhe studentëve etj.</p> <p>(Aneksi 31: Struktura e Web-it UBT)</p> <p>Informacion me karakter didaktik gjendet edhe në portalin e UBT-së në websitet e pedagogëve, për të mundësuar marrjen e informacion nga të interesuarit në distancë (https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemenager/).</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit ka integruar sistemin ESSE3 për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta unversitare dhe deri në mbrojtjen e diplomës. Studenti mund të monitorojë studimet e tij përmes një kodi unik identifikimi, që e shoqëron atë në gjithë eksperiencën e tij në Universitet. Përmes këtij sistemi studenti merr në kohë reale informacion në lidhje me të dhënat e regjistrimeve, lëndët, për të drejtën për të hyrë ose jo në provim, prenotimin e provimit, grafikun e provimeve online, vlerësimin e bërë nga pedagogu gjatë semestrit, vlerësimin në provim dhe notën përfundimtare notat, etj.</p> <p>Në lidhje me hapjen e grafikut për provime në këtë sistem, për sezonet e rregullta ky proces bëhet automatikisht nga sekretaret përkatëse të programit të studimit. Në sezonet e vjeshtës ku proces bëhet nëpërmjet prenotimit nga vet studentit në këtë sistem.</p>

	<p>(Aneksi 46 - Manual regjistrimi studentet Esse3) (Aneksi 39 – Udhëzues për zhvillimin e metodave inovative)</p> <p>Informacioni me karakter didaktik gjendet në portalin e UBT-së, në websitet personale të pedagogëve duke mundësuar në këtë mënyrë vendosjen e një komunikimi sa më të mirë dhe marrjen e informacionit në distancë nga studentët (https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home). Në këto portale studentët mund të aksesojnë syllabusin e lëndëve që frekuentojnë, leksionet e këtyre lëndëve, informacionin mbi detyrat që do të kryejnë gjatë frekuentimit të kurseve specifike dhe vlerësimin përkatës, si dhe materiale e informacione të tjera në funksion të realizimit të lëndës në fjalë. Informacioni mbi karakteristikat e programit të studimit pasqyrohet në website e UBT-së, në faqen dedikuar DDA (http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/departamentidrejtim-agrobiznesi/).</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nga takimet e realizuara në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatoam se përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore, si dhe zyrat përkatëse monitorojnë informacion mbi veprimtarinë mësimore të personelit të këtij programi studimi. Ky informacion përfshin raportimin e orarit mësimor, ngarkesën mësimore, komunikimit adekuat dhe respektimin e kodit të etikës. Ky informacion si dhe kontributi i çdo antari të personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi vlerësohet dhe më pas përcillet tek zyrat përkatëse në FEA. Ndërhyrjet në sistem, parregullsitë apo mungesa e gjenerimit të informacionit nga ana e personelit akademik mund të monitorohen, vlerësohen dhe raportohen në kohë reale tek organet drejtuese, duke lejuar këto të fundit të marrin masat përkatëse për të përmirësuar situatën e konstatuar.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme, publikohen në website e UBT-së në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Në lidhje me faqen e internetit në gjuhë angleze, mund të themi se është ende në ndërtim e sipër për të reflektuar ndryshimet që janë bërë për websiten.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit harton një raport financiar, i cili bashkë me raportet e fakulteteve të tjerë është pjesë e raportit financiar të Institucionit. Ky raport përmban kostot e programit të studimit si dhe një plan për mbështetjen financiare të nevojshme, i cili bën të mundur mbarëvajtjen e programit të studimit në fjalë. Menaxhimi i burimeve financiare në këtë Institucion funksionon në përputhje me legjislacionit në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Përgjegjëse për hartimin e raportit financiar në UBT është Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Në këtë raport gjejmë të pasqyruara kostot për student për ciklin e parë të studimit Bachelor si dhe për ciklin e dytë të studimeve, MP dhe MSh. Nga shqyrtimi i këtij raporti rezulton se kostoja vjetore për student në programin e ciklit të parë Bachelor në MA ka pësuar një rritje të vogël për vitin aktual krahasuar me vitin e kaluar (per vitin akademik 2017-2018 rezulton 114,153 lekë, ndërsa për vitin 2018-2019 rezulton 116,367 lekë). Ky plan, përveç kostove për student, përfshin edhe kostot të tjera që lidhen me zëra që janë në funksion të realizimit të këtij programi studimi të tilla si: financimin e burimeve njerëzore që janë të angazhuar në këtë program studimi, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzime për pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara, kontrata të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit si dhe zëra të tjerë specifike.</p> <p>(Aneksi 27 - Kosto mesatare e nje studenti & Aneksi 50 - Raporti Financiar i Vitit 2017)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishtme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni auditohet çdo vit, në mënyrë të rregullt, nga grupi i ekspertëve të auditit të brendshëm të tij.</p> <p>Burimet potenciale të financimit janë tre:</p> <ul style="list-style-type: none"> • financim nga buxheti i shtetit • financim nga tarifat e studentëve si edhe • financim nga shërbimet që UBT ofron për aktorë të tretë. <p>Institucioni publikon pasqyrën financiare të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera. Gjithashtu, UBT harton dhe një raport ku analizohet veprimtaria financiare për tre vitet e fundit në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat. Nëpërmjet këtij dokumenti evidentohen nevojat e planifikuara për financim.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Një tjetër dokument që hartohet nga ky Institucion/ drejtoria përgjegjëse është relacioni në lidhje me projekt buxhetin. Ky dokument hartohet periodikisht dhe shërben për të kontrolluar mbarëvajtjen e programeve të studimit për të gjitha ciklet e studimit. Në këtë dokument pasqyrohen objektivat dhe investimet që nevojiten në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për të gjitha programet e studimit që ofrohen</p>

Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	në këtë Universitet. Gjithashtu identifikohen edhe burimet e mundshme në gjenerimin e të ardhurave. (Aneksi 28 - Te dhena nga raporti financiar 2016-2017-2018 & Relacion Projekt Buxheti 2017-2019)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në nenet përkatëse të rregullores së DDA (Aneksi 7- Rregullore e DDA - Kreu V: Neni 15-26) janë pasqyruar procedurat specifike që mbulojnë ciklin e parë të studimeve që nga momenti i pranimit të studentit në Universitet deri në përmbushjen e programit të studimit në fjalë. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Agrobiznesi”, ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi si dhe kompetenca profesionale dhe analitike (Aneksi 6b- Rregullores e Brendshme e DDA-s-Neni 15, pika 3 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA – Neni 7, Pika 2) në fushën e agrobiznesit, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë. Gjithashtu, ky program kujdeset të pajisë studentët me njohuri bazë, të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit (Aneksi 6b - Rregullores e Brendshme e DDA-s-Neni 15, pika 4 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA – Neni 7, Pika 2). Kriteret e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë të studimeve në DDA-së përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të DDA, FEA-s dhe UBT-së (Aneksi 6b-

	<p>Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 18, Pika 1&2; Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 9, Pika 1&2). Individët që kanë përfunduar me sukses gjimnazin e përgjithshëm apo atë profesional dhe që plotësojnë kriteret e caktuara nga DDA gëzojnë të drejtën që të pranohen dhe të ndjekin programin e studimit bachelor në MA (Aneksi 6b- Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 18, pika 3 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 9, Pika 3). Bazuar në nenet specifike të rregulloreve përkatëse, kohëzgjatja e studimeve e këtij programi bachelor rezulton të jetë 3 vite akademike (Aneksi 6b- Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 20, Pika 1 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 11, Pika 1).</p> <p>Numri total i krediteve që duhet të grumbullojë një student për finalizimin e këtij cikli studimi është 180 ECTS (Aneksi 6b- Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 20, Pika 4 & Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 11, Pika 4). Studentët mund të transferojnë studimet e mëparshme dhe kreditet e grumbulluara bazuar në kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të DDA (Aneksi 6b – Neni 70-72).</p> <p>Studentët e këtij programi studimi diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome në varësi të plotësimit të kriterëve përkatëse. Në përfundim të programit të ciklit të parë, lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e menaxhimit të agrobiznesit. (Aneksi 6b - Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 16, Pika 2&3).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja e DDA përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve, apo transferimit të tyre gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit bachelor në MA. Këto politika sigurojnë informim për kriteret, procedurat dhe afatet e aplikimit (duke përfshirë këtu edhe tarifatat përkatëse të programit), transferimit dhe përfundimit të studimeve.</p> <p>(Aneksi 6b - Rregullore e DDA, specifikisht Neni 18, 19, 20) (Aneksi 7 - Rregullore e Programit të Studimit, Neni 9, 10, 11)</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve, procedurat e përparimit të studentëve gjatë kursit të studimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të studimeve, njohjes së studimeve të mëparshme të plota apo të pjesëshme duke përfshirë edhe studimet e realizuara në kuadër të programeve Erasmus+, i gjejmë të pasqyruara në nenet përkatëse të rregulloreve përkatëse (Aneksi 6b - Rregullore e DDA - Neni 18 – 26, Kreu X & XI; Aneksi 7 - Rregullore e Programit të Studimit - Neni 9 -17, Kreu V&VI).</p> <p>Ky informacion është lehtësisht i kuptueshm dhe i aksesueshm për publikun e interesuar në website-in e Institucionit, në faqen përkatëse të DDA. (http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dheagrobiznesit/departamenti-drejtimit-agrobiznesi/).</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë të studime në DDA përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të DDA, FEA-s dhe UBT-së (Aneksi 6b-Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 18, Pika 1&2; Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 9,Pika 1&2). Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional si dhe kandidatët që disponojnë diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit (pasi realizohet ekuivalentimi i diplomës së fituar në vendin e huaj nga komisioni përkatës në MAS). Kriteret e pranimit i gjejmë të pasqyruara në rregulloren përkatëse të programit të studimit dhe përfshijnë: (1) Mesataren e shkollës së mesme; (2) Koeficientin e përcaktuar për shkollën nga e cila vjen studenti, në përputhje me fushat dhe programet e studimit të ofruara nga departamenti përkatës; (3) Nota mesatare e lëndës me zgjedhje për fushën e ekonomisë; si dhe (4) Kuota të paracaktuara. (Aneksi 7 - Rregullore e programit të studimeve Bachelor MA Neni 9,Pika 3&4)</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Shtetasit shqiptarë, shqiptarët jashtë kufijve shtetërorë si dhe shtetasit e huaj, kanë të drejtë të ndjekin studimet që ofrohen në DDA vetëm nëse përmbushin kriteret e përcaktuara nga MASR, statuti i UBT dhe rregulloret përkatëse në lidhje me studimet e ciklit të parë në DDA. (Aneksi 6b: Rregullore e DDA - Neni 18, Pika 1; Aneksi 7 - Rregullore e Programit të Studimit - Neni 9, Pika 1).</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit komunikon me publikun e interesuar për ndjekjen e programit bachelor në MA përmes disa mënyrave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni përditësohet në faqen web të Fakultetit dhe seksionit përkatës të Departamentit në lidhje me përmbajtjen dhe karakteristikat e këtij programi studimi për aplikantët e interesuar. 2. Një grup pedagogësh gjatë periudhës 2 javore Shkurt -Maj vizitojnë shkollat e mesme të vendit për të promovuar institucionin dhe programet e studimit përkatëse duke përdorur materiale promovuese të ndryshme si fletë-palosje, guida, afishe, roll up, etj. (Raport Performanca e QKA 2018,fq. 6 dhe 17; Aneksi 71 - Materiale promovuese). 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Informacioni i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në Rregulloren e DDA (Aneksi 6b- Neni 21) si dhe në atë të programit të studimeve (Aneksi 7- Neni 12) si më poshtë.</p> <p>I. Viti akademik mbyllet në përfundim të sezonit të vjeshtës. Nëse studenti i vitit të parë bachelor ka grumbulluar minimumi 25 kredite, atëherë ai/ajo kalon në vitin e dytë, ndërsa studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ka grumbulluar minimumi 80 kredite.</p> <p>II. Studenti i vitit të tretë me kohë të plotë që në përfundim të kohës normale të studimeve ka grumbulluar 180 kredite, ka të drejtë të paraqitet në provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.</p> <p>III. Studenti i vitit të parë dhe vitit të dytë që nuk plotëson kriteret për të kaluar në vitin pasardhës shpallet përsëritës dhe ka këto të drejta e detyrime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • I njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin ose vitet paraardhës/e kur programet e moduleve janë të pranueshme për vitin në vazhdim. • Të paraqitet në sezonet e rregullta të provimeve dhe sezonin e vjeshtës të vitit që është shpallur përsëritës, për modulet që është vlerësuar me notë negative ose “nuk u paraqit”. • Është i detyruar të frekuentojë modulet për të cilat ka si detyrim frekuentimin e vitit që është shpallur përsëritës dhe të paraqitet në sezonet e rregullta të provimeve dhe sezonin e vjeshtës të këtij viti. • Nuk është i detyruar të frekuentojë modulet e reja për shkak të ndryshimit të kurrikulës së programit të studimit në vitin që është shpallur përsëritës (vitet të parë ose të vitit të dytë). • Duhet të paguajë tarifën e shkollimit. <p>IV. Studenti i vitit të tretë me kohë të plotë që nuk plotëson kriteret për tu paraqitur në provimin e formimit pasi ka module të vlerësuara me notë negative ose “nuk u paraqit”, ka këto të drejta dhe detyrime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shlyej detyrimet e prapambetura në sezonin plotësues (muaji janar), sezonin e rregullt të dimrit

	<p>dhe sezonin para diplomimit (3 provime) të vitit pasardhës dhe të paraqitet në provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome në sezonin e diplomimit (java e katërt e muajit mars).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse nuk arrin t'i shlyej detyrimet në afatet e përcaktuara mund t'i shlyej ato në sezonin plotësues (muaji prill), sezonin e rregullt të verës dhe sezonin para diplomimit (3 provime) të po atij viti dhe të paraqitet në provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome në sezonin e diplomimit (java e katërt e muajit korrik). • Duhet të paguaj kreditet për modulet e pashlyera. <p>V. Studenti i vitit të tretë me kohë të plotë që nuk plotëson kriteret për tu paraqitur në provimin e formimit pasi ka module me notë negative ose “nuk u paraqit”, si dhe të paktën një modul me detyrim frekuentimin, shpallet përsëritës dhe ka këto të drejta dhe detyrime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • I njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin ose vitet paraardhës/e kur programet e moduleve janë të pranueshme për vitin në vazhdim. • Është i detyruar të frekuentojë modulën/et për të cilat ka si detyrim frekuentimin. • Është i detyruar të frekuentojë modulën/et e reja të vitit që është shpallur përsëritës (viti i tretë), për shkak të ndryshimit të kurikulës së programit të studimit (por jo për vitet e mëparshme). • Të paraqitet në sezonet plotësuese të provimeve (java e dytë e muajit janar dhe java e fundit e muajit prill), sezonet e rregullta (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës), sezonin e vjeshtës të vitit që është shpallur përsëritës (viti i tretë) dhe sezonin para diplomimit të muajit korrik (3 provime) për modulet që është vlerësuar me notë negative ose nuk u paraqit. • Duhet të paguajë tarifën e studimeve.
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme paraqitet qartë në Rregulloren e DDA (Aneksi 6b) dhe në atë të programit të studimit (Aneksi 7) si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për të gjithë studentët që kërkojnë të transferojnë studimet, DDA bën të mundur ekuivalentimin e një pjese të programeve sipas përcaktimeve në Statutin e UBT (Aneksi 6b-Neni 72,pika 1; Aneksi 7- Neni 44, pika 1). 2. Transferimi bëhet në vite të ndërmjetme, ndërsa kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve janë 30. Fakulteti mund t'i njohë studentit kreditet e fituara ose një

	<p>pjesë të tyre në përputhje me procedurën e njohjes dhe ekuivalentimit të moduleve (Aneksi 6b - Neni 70, pika 2; Aneksi 7- Neni 42, pika 2.)</p> <p>3. Periudha dhe procedurat për transferimin e studimeve realizohen në fillim të vitit akademik në përputhje me aktet nënligjore të MAS (Aneksi 6b - Neni 70, pika 3 Aneksi 7- Neni 42, pika 3).</p> <p>4. Studenti që është i interesuar të transferojë studimet në DDA paraqet një kërkesë pranë ZSS të UBT-së dhe dokumentacionin përkatës të nevojshëm. ZSS kryen verifikimet mbi legjitimitetin e institucionit të arsimit të lartë nga vjen studenti, nivelin e programit të studimit që ka ndjekur studenti si dhe origjinalitetin e dokumentave të paraqitur. Më pas, zyra përcjell në fakultetet përkatëse kërkesat e grumbulluara dhe dokumentacionin e verifikuar (Aneksi 6b - Neni 71, Pika 1 & 2; Aneksi 7- Neni 43, pika 1 & 2).</p> <p>5. Pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, me urdhër të Dekanit të Fakultetit, ngrihen dhe funksionojnë komisione ad hoc të Njohjes dhe Ekuivalentimit të Studimeve. Komisionet përbëhen nga tre antarë: Zv. Dekani për mësimin dhe kurikulat, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i grupit mësimor, në varësi të programit të studimit dhe programit të modulit që kërkohet të ekuivalentohet. Zv. Dekani për mësimin dhe kurikulat është kryetar komisioni. Vendimi përfundimtar i ekuivalentimit (njohjes) të programeve të studimit firmoset prej tij dhe Dekanit të Fakultetit (Aneksi 6b- Neni 72, pika 2; Aneksi 7- Neni 44, pika 2).</p> <p>6. Një modul ekuivalentohet kur ka emërtim të njëjtë/të ngjashëm, apo që në përmbajtjen e tyre, trajtojnë tema mësimore të njëjta dhe ka një përputhje të përmbajtjes së saj dhe të ngarkesës në auditor, në masën mbi 80 % me modulën që zhvillohet në programin e studimeve të DDA-s (Aneksi 6b- Neni 72, pika 3; Aneksi 7- Neni 44, pika 3).</p> <p>7. Komisioni bën ekuivalentimin e moduleve që ka dhënë studenti me modulën respektivë të programit të studimit, duke patur parasysh kreditet e modulit, programin e modulit, siç përshkruhet më sipër, si dhe notën e marrë (Aneksi 6b- Neni 72, pika 4; Aneksi 7- Neni 44, pika 4).</p> <p>8. Në funksion të numrit të krediteve të njohura, dekani i fakultetit përcakton vitin ku do të regjistrohet studenti në përputhje me nenet e kësaj rregulloreje (Aneksi 6b- Neni 72, pika 5; Aneksi 7- Neni 44, pika 5).</p> <p>Më pas ky proces bëhet transparent përmes faqes se webit duke specifikuar detaje që janë në funksion të transparencës së rankimit të studentëve apo njohjes ose jo të moduleve të caktuara.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit në këtë</p>

<p>procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>mënyrë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nëpërmjet Rregullores së DDA (Aneksi 6b - Nenet 57-68) dhe Rregullores së programit të studimit (Aneksi 7 – Neni 29-40) departamenti informon qartësisht studentët mbi procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu: (1) sistemin e vlerësimit, (2) format e vlerësimit, (3) format e kontrollit të dijeve, (4) kushtet për hyrjen në provim, (5) sezonet e provimeve, (6) organizimin e tyre e (7) komisionet e provimit, (8) zhvillimin e provimit, (9) shpalljen e rezultateve të provimit, (10) ankimimi dhe (11) përmirësimi i notës. 2. Format e kontrollit të dijeve edhe pse gjenden në rregulloret e FEA, DDA dhe në atë të programit të studimit, i bëhet me dije studentit në javën e parë të fillimit të mësimin nga pedagogu/pedagogët përgjegjës i/të lëndës përkatëse. 3. Studenti informohet edhe në distancë përmes websiteve personale të pedagogeve në lidhje me elementët e mësimin dhe vlerësimit të tij, nëpërmjet syllabusit apo planit kalendar që plotësohet në fillim të semestrit.
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e përgatitjes së një punimi diplome për nivelin Bachelor. Kriteret janë publike në çdo kohë, por intensifikohet komunikimi në mes të semestrit të pestë (semestri i parë i vitit të tretë). 2. Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti Drejtim Agrobiznesi. Në përfundim të semestrit të tretë, studentit plotëson një formular tip, ku specifikohet emri i studentit, fusha e studimit të kërkuar, propozimi për profesorin udhëheqës pasi është marrë edhe aprovimi i tij. Ky dokument dorëzohet në department, ku ky i fundit organizon një mbledhje për miratimin e temave dhe propozimeve të studentëve. 3. Departamenti harton listën e studentëve dhe udhëheqësin shkencor të cilat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit të DDA-s. 4. Departamenti publikon informacion në lidhje me mënyrën e përpunimit të tezës me të gjithë studentët e vitit të tretë bachelor. <p>(Aneksi 6a5- Rregullores se FEA-s- Neni 28; Aneksi 6b- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 24 & Aneksi 7 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 15)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura</p>	<p>Departamenti i DDA realizon një proces komunikimi transparent dhe periodik në lidhje me këtë program studimi nëpërmjet</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Një udhëzuesi në formën e një dokumenti elektronik . 2. Organizimi i takimeve me maturanët e shkollave të mesme

për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	të vendit për të informuar mbi programet e studimit përkatëse në UBT/FEA/DDA duke përdorur materiale promovuese të ndryshme (si stende, fletë-palosje, guida, afishe, roll up, etj.). (Aneksi 51 - Politika e Marketingut te programit te studimit)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	DDA informon studentët në mënyrë të hollësishme në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor në MA nëpërmjet neneve përkatëse në Rregulloren e DDA (Aneksi 6b- Neni 10, 11, 13, 16 & 20) dhe Rregulloren e programit të studimit (Aneksi 7- Neni 4, 5, 8& 11). Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve në websitin e Fakultetit në seksionin e departamentit (http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/). Informacioni në web në lidhje me organizimin dhe programet që ofron departamenti krijon mundësi për të marrë informacionin e duhur në lidhje me organizimin e plotë të studimeve të këtij programi. Në fillim të çdo viti akademik, bëhet i mundur informimi në lidhje me strukturën e vitit akademik në të cilën detajohet kohëzgjatja e vitit akademik, ndarja e tij në semestra si dhe periudha e provimeve.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Ky informacion vjen tek student në disa forma: 1. Në hard-copy me anë të guidave, rregulloreve të posaçme, fletëpalosjeve, procedurave, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve të programeve përkatëse; 2. Në formë elektronike në websit-n e universitetit, në seksionin përkatës të DDA, të i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët si në mjediset e FEA dhe jashtë saj. Këtu, për programin e studimit bachelor, mund të gjendet rregullorja e programit, kurrikula e plotë me informacionin e nevojshëm për lëndët, ndarjet e tyre në semestra dhe kreditet. Nga ana tjetër, personeli akademik i departamentit shfrytëzon hapësirën personale në portalin e UBT-së (https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home) për

	<p>të komunikuar në mënyrë sa më efçente me studentët në lidhje me informacionin për leksionet e moduleve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit si dhe e materialeve të tjera. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si dhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. Ata gjithashtu marrin në këtë hapësirë edhe informacion në lidhje me vlerësimin gjatë vitit (Aneks 69 - Pamje nga web i pedagogut).</p> <p>3. Informacioni i shpallur në stenda në mjediset e përcaktuara të FEA-s dhe DDA-së, ku përfshihet kurrikula e plotë me informacionin e nevojshëm për lendët, ndarjet e tyre në semestra, kreditet, orari i mësimi, njoftime të ndryshme, pjesë të rëndësishme të rregullores, rezultatet e kontrolleve, etj.</p> <p>Vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Këshillat e fakulteteve dhe Dekanati në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatet e analizave të bëra, rezultatet e anketimit etj, u bëhen me dije studentëve në forma të ndryshme si (a) takime të drejtpërdrejta me studentët, (b) shpallje në mjediset e caktuara të universitetit, (c) njoftimeve në "website" (http://ubt.edu.al/sq/njoftimet/), etj. (Aneksi 6a – Rregullore e FEAs, Neni 102)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Për t'i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktika profesionale, intership apo dhe mundësi punësimi, Qendra e Karrierës dhe Alumni, përgjatë panairëve të karrierës që ka organizuar në UBT, ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF). (Aneksi 32 - Institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale) Nga biseda e realizuar me Z. Domi, Koordinator i QKA, u informuam se më datë 15 Maj 2019 Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), organizoi për të gjashtn vit radhazi Panairin e Karrierës pranë mjediseve të kampusit universitar. Ky panair shënon një event të rëndësishëm për UBT, sepse shërben si urë lidhëse ndërmjet sipërmarrjeve, institucioneve publike, organizatave të ndryshme pjesëmarrëse dhe studentëve për të krijuar mundësi punësimi, praktikë profesionale apo intership. Këtë vit morën pjesë 46 sipërmarrje dhe organizata të profileve të ndryshme, të cilat me anë të stendave përkatëse, ofruan mundësi punësimi dhe praktika profesionale për rreth 536 studentë.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor nëpërmjet paraqitjes së orarit të studimeve në stenda dhe website e Univesrsitetit (http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/orari-i-mesimit-fea-sem-i-2018-2019/). Gjithashtu, ata informohen mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij procesi. Këtë informacion dhe shërbime të tjera në lidhje me</p>

	procesin mësimor, studentët e sigurojnë edhe nga zyra që është përgjegjëse për studimet dhe studentët (ZSS).			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Siç është shpjeguar në standardin IV.5.1&4, Institucioni disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në çertifikimin përfundimtar, pra pajisja me diplomën sipas ciklit përkatës. Ky sistem menaxhimi ka integruar sistemin ESSE3 për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta universitare deri në mbrojtjen e diplomës. Informacioni në lidhje me procesin mësimor bëhet lehtësisht i aksesueshëm përmes këtij (Aneksi 46 - Manual regjistrimi). Sistemi ESSE3 i mundëson studentit të marrë informacion të nevojshëm edhe në distancë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Në analizën mësimore që DDA përgatit çdo vit, gjejmë të pasqyruara statistikat vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në programet përkatëse, që kanë ndërprerë studimet, të diplomuar në programin e studimeve bachelor si dhe informacion mbi ecurinë e studentëve në këtë program studimi. Ky informacion regjistrohet dhe ruhet në departament së bashku me shumë të dhëna të tjera në lidhje me studentët. Të dhënat statistikore e përmndura më sipër mund të gjenerohen në çdo kohë për çdo vit akademik nga sistemi ESSE3. (Aneksi 38 - Analiza e punës mesimore DDA 2018, fq 10-12). Departamenti është në gjendje në çdo kohë të analizojë të dhënat e studentëve nëpërmjet regjistrimit "hardcopy" që mban sekretaria mesimore, si dhe të analizojë të dhënat e gjeneruara nga sistemi ESSE3.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	(Aneksi 36a: Nota mesatare e pranimeve 2016-2017) (Aneksi 36b: Nota mesatare e pranimeve 2017-2018) (Aneksi 36c: nota mesatare e pranimeve 2018-2019) (Aneksi 37a: Studente të regjistruar që nga 2014 -2019) (Aneksi 37b: Studente të ardhur me transferim 2014-2019) (Aneksi 47: Studentet e diplomuar 2013-2018) (Aneksi 48: Statistika për studentet e regjistruar 2014-2019) (Aneksi 75: Mesataret e studenteve në përfundim të studimeve 2014-2018)
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të	Nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit, Institucioni

<p>studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>ruan të dhënat personale të studentëve. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme të universitetit (Aneksi 6a – Rregullore e FEAs, Neni 101). I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm të informacionit në formë hardcopy dhe elektronike. Ky informacion është konfidencial dhe mund të aksesohet vetëm përmes një kërkesë me shkrim apo zotërimit të një account-i nga studenti. Ky i fundit, përmes numrit të matrikullimit, ka akses vetëm për të vëzhguar ecurinë e tij në sistem dhe të marrë të dhëna për këtë. Gjithashtu studenti disponon edhe librezën e studentit me notat për çdo lëndë të zhvilluar (Aneksi 41 - Librezë e studentit).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Çdo vit DDA harton një raport ku analizon dhe vlerëson veprimtarinë mësimore të departamentit në tërësi dhe situatën e programeve të studimit. Në të pasqyrohen masat që duhet të ndërmerren për vitin e ardhshëm akademik në përputhje me problematikat e evidentuara. Në hartimin dhe plotësimin e tij përfshihen edhe opinionet e personelit të departamentit. Pas miratimit, ky dokument kalon në dekanat duke u bërë në këtë mënyrë pjesë e raportit mësimor të FEA. Raporti i FEA i kalohet më pas zyrës përgjegjëse, e cila, pasi mbledh informacionin nga fakultetet përkatëse, e përpunon atë dhe prodhon produktin që është raporti përfundimtar përmbledhës i analizës mësimore të institucionit. Në fund të raportit, nxirren detyrat dhe afatet kohore të përbushjes së tyre në lidhje me pika të dobëta që mund të evidentohen, të cilat kërkojnë përmirësim për vitin pasardhës. (Aneksi 38 - Analiza e punës mesimore DDA 2018) (Aneksi 49- Raporti i UBT 2017-2018)</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Institucioni parashikon në fillim të procesit të organizimit të zgjedhjeve në universitet, të përfshijë studentët në mënyrë thelbësore në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Studentët kanë përfaqësinë e tyre në Senatën akademik, Komisionin e cilësisë dhe kurrikulave si dhe në Komisionin e etikës me një mandat për një periudhë kohore 2 vjeçare (Aneksi 2- Statuti UBT, Neni 64).</p>

	<p>Gjatë kohës së realizimit të vizitës nga ekspertët e jashtën në IAL, mësuam se FEA kishte përfunduar procesin zgjedhor për përzgjedhjen e studentëve që do të përfshihen në këto komisione për një periudhë 2 vjeçare. Gjatë këtij procesi studentët kanë patur mbështetjen e personelit dhe infrastrukturës së fakultetit për të organizuar mbledhjet e hapura apo shpalosur angazhimin e tyre në përfaqësimin e interesave të studentëve në këto komisione.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Për një periudhë 2 vjeçare janë organizuar 4 mbledhje (3 mbledhje të komisionit të etikës dhe 1 mbledhje e komisionit të cilësisë dhe kurrikulave). Mbledhjet e komisioneve janë realizuar me një proces transparent duke i njoftuar përfaqësuesit e studentëve përmes kontakteve që kanë depozituar në fakultet (si psh. adresa e emailit apo numri i telefonit).</p> <p>(Aneksi 72: Vendim KIZ per perfshirjen e studenteve) (Aneksi 30: Vendim komisioni i cilesise)</p> <p>Studentët gjithashtu organizohen në Këshillat studentore, ku shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për problematika të ndryshme duke përfshirë këtu edhe çështje të planeve dhe programeve të studimeve apo të procesit mësimor.. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi (Doc. no.3- Statuti i UBT – Neni 65).</p> <p>Nga takimi i realizuar me studentët mësuam se ata janë në dijeni të këtyre strukturave dhe të funksionimit të tyre, si dhe i mbështesin ato. Megjithatë, nga takimi i realizuar me përfaqësuesit e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, mësuam se më pak aktiv ka qënë komisioni i cilësisë dhe i kurrikulave (1 takim i realizuar) në këto 2 vite. Gjithashtu mësuam se shfrytëzohet më shumë opinioni i studentëve që merret nga anketat e realizuara se nga përfaqësuesit e tyre në komisionet përkatëse duke qënë se nuk kanë qënë shumë aktiv.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar duke marrë në konsideratë aftësinë e studentëve për të përvetësuar në mënyrë sa më të përshtatshme njohuritë dhe duke përzgjedhur një kurrikul bashkëkohore. Në vlerësimin e ngarkesës akademike të studentit janë mbajtur në konsideratë si marrja e informacionit teorik edhe e atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Raporti i vlerësimit të studentit varion nga 20- 40% gjatë vitit në 60-80 % provimi përfundimtar. Kryeson raporti 40% : 60% sidomos për modulet e vitit të II-të dhe të III-të. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e plotë të studentëve gjatë gjithë kursit, por gjithashtu i parapërgatit ata për sezonin e provimeve ku njafton vetëm një përsëritje e asaj çfarë kanë mësuar gjatë semestrit. Ky fakt na u</p>

	<p>pohua edhe nga studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Procedura e transferimit të studimeve dhe njohjes së krediteve është e thjeshtë dhe e lehtë për tu realizuar. Studenti që është i interesuar të transferojë studimet në DDA paraqet një kërkesë pranë ZSS të UBT-së dhe dokumentacionin përkatës të nevojshëm. ZSS kryen verifikimet mbi legjitimitetin e institucionit të arsimit të lartë nga vjen studenti, nivelin e programit të studimit që ka ndjekur studenti, si dhe origjinalitetin e dokumentave të paraqitura. Më pas, kjo zyrë përcjell në fakultetet përkatëse kërkesat e grumbulluara dhe dokumentacionin e verifikuar. (Aneksi 6b - Neni 71, Pika 1 & 2; Aneksi 7- Neni 43, pika 1 & 2). Komisionet ad hoc përgjegjëse për njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve (Aneksi 6b- Neni 72, pika 2; Aneksi 7- Neni 44, pika 2), mbi bazën e krediteve të njohura, merret vendimin, i cili përcakton vitin ku do të regjistrohet studenti (Aneksi 6b- Neni 72, pika 5; Aneksi 7- Neni 44, pika 5).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Strukturat drejtuese të Universitetit gjatë tre viteve të fundit kanë ndërmarrë një iniciativë llogaridhënie para asamblesë akademike të institucionit për çështje që kanë të bëjnë me të gjithë veprimtarinë e UBT ku një vend të rëndësishëm zë edhe llogaridhënia dhe diskutimi për cilësinë e programeve të studimit. Gjatë këtij procesi përfshihen edhe studentët sepse ftohen të marrin pjesë në këtë diskutim. Proçesi përfshin vijimësinë e proçesit mësimor si edhe problematikat e vërejtura gjatë viteve paraardhëse akademike, masat e marra gjatë viti të fundit akademik dhe impakti i tyre. Më tej vazhdohet me planin e ndërhyrjeve për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>Një kontribut tjetër në këtë kontekst janë rezultatet e marra nga anketimi i realizuar me studentët. Anketat e realizuara në (a) hard-copy ku merret një opinion më specifik në lidhje me modulin dhe pedagogun përkatës dhe (b) online, ku studentëve i kërkohet informacion më i përgjithshëm mbi procesin mësimor dhe çështje të tjera. Siç është shpjeguar edhe në kategoritë e mësipërme ky proces ndodh 2 herë në vit, përpara sezonit të provimeve, për të evituar ndikimin apo deformimin e vlerësimit. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësori janë pjesë e analizën vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <p>Një kontribut i rëndësishëm do të ishte dhe mendimi i Alumnit, të diplomuarve në këtë program studimi, të cilët tashmë janë pjesë e tregut të punës dhe njohin më nga afër problematikat dhe kërkesat e tregut në lidhje me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme të studentëve potencial i ardhshëm për punësim.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e</p>	<p>Nëpërmjet Rregullores së DDA (Aneksi 6b - Nenet 57-68) dhe Rregullores së programit të studimit (Aneksi 7 – Neni 29-40) departamenti informon qartësisht studentët mbi procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve në lëndë të ndryshme të programit të</p>

kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	studimit, duke përfshirë këtu: (1) sistemin e vlerësimit, (2) format e vlerësimit, (3) format e kontrollit të dijeve, (4) kushtet për hyrjen në provim, (5) sezonet e provimeve, (6) organizimin e tyre (7) komisionet e provimit, (8) zhvillimin e provimit, (9) shpalljen e rezultateve të provimit, (10) ankimimin dhe (11) përmirësimin e notës. Studentët, në seksionet përkatëse të anketave (në hard-copy dhe online) që realizohen nga Institucioni mund të japin mendimin e tyre në lidhje me kryerjen e procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, duke përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit në të. Gjithashtu në takimin e realizuar me studentët, mësuam se pedagogët janë të hapur dhe bashkëpunues për të diskutuar me studentin në rast se do të ngriheshin pretendime për rishikimin e vlerësimit. Studentët rezultojnë të kënaqur në lidhje me këtë aspekt dhe nuk kishin hasur situatë të pakëndshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Departamenti ka krijuar procedura dhe njësi të posaçme për informimin dhe shërbimin e studentëve, të cilat paraqiten më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Sekretaria e departamentit ku studenti informohet mbi aktivitete të procesit mësimor dhe jo vetëm, gjithashtu ndihmohet kur përballet me problematika të ndryshme që mund të lindin gjatë procesit mësimor. 2. Sekretaria mësimore ku studenti merr informacion për ecurinë e tij në programin e studimit që ndjek, si dhe asistohet për shërbime të ndryshme studentore. 3. Zyra e këshillimit të karrierës ku studentët marrin informacion për praktikat profesionale, intership apo dhe mundësi punësimi. Në Rregulloren e brendshme të DDA (Aneksi 6b- Kreu XIV), gjejmë të pasqyruara procedurat në lidhje me informimin dhe trasparencën që shoqëron këtë proces.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e	Institucioni ka ngritur një sistem të posaçëm mbi informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve. Elementet e këtij sistemi janë përmendur edhe më sipër në seksionet përkatëse: <ol style="list-style-type: none"> 1. Sekretaria e departamentit është një njësi e vendosur pranë departamentit për asistimin e studentëve për problematikën që ata hasin në përditëshmërinë e tyre dhe krijon mundësi

studimit.	<p>për t'i zgjidhur ato.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Sistemi ESSE3 që përbën një sistem sekretarie online mjaft të domosdoshëm për t'u informuar në lidhje me ecurinë e studentit. 3. Portalet e pedagogëve (Aneksi 69 - Pamje nga web i pedagogut) përmes së cilëve studentët krijojnë një komunikim të vazhdueshëm për procesin mësimor, pasi në të mund të gjejnë informacione për leksionet e moduleve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit si dhe e materialeve të tjera. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. Ata gjithashtu marrin në këtë hapësirë edhe informacion në lidhje me vlerësimin gjatë vitit.
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në UBT është ngritur dhe funksionon Zyra qendrore e Karrierës dhe Alumni, e cila koordinon punën me 5 zyrat e karrierës për secilin fakultet. Pranë FEA, prej mëse 5 vjetësh është ngritur dhe funksionon zyra e Këshillimi të Karrierës për këtë fakultet, e cila i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të studentëve të këtij fakulteti. Për t'i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktika profesionale, intership apo dhe mundësi punësimi, Qendra e Karrierës, përgjatë panairëve të karrierës që ka organizuar në UBT, ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF). (Aneksi 32 - Institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga biseda e realizuar me Koordinatorin e QKA, u informuam se më datë 15 Maj 2019 Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), organizoi për të gjashtn vit radhazi Panairin e Karrierës pranë mjediseve të kampusit universitar. Ky panair shënon një event të rëndësishëm për UBT, sepse shërben si urë lidhëse ndërmjet sipërmarrjeve, institucioneve publike, organizatave të ndryshme pjesëmarrëse dhe studentëve për të krijuar mundësi punësimi, praktikë profesionale apo intership. Këtë vit, morën pjesë 46 sipërmarrje dhe organizata të profileve të ndryshme të cilat me anë të standave përkatëse, ofruan mundësi punësimi dhe praktika profesionale për rreth 536 studentë. Një tjetër funksion që realizon zyra qendrore në bashkëpunim me zyrat e këshillimit të karrierës për fakultet përkatëse është gjurmimi i studentëve të diplomuar ndër vite. Nga të gjithë studentët e gjurmuar të FEA, të diplomuar gjatë vitit 2017-2018, rezulton se 28,7% janë të diplomuar të programit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi. Kompetencat, njohuritë dhe aftësitë e fituara pas mbarimit të këtij programi studimi i kanë dhënë mundësi studentëve të punësohen në sektorin e Agrobiznesit, në profilin për të cilin janë diplomuar, apo edhe në sektorë të tjerë</p>

	<p>të ekonomisë, edhe pse në shifra ky raport është i ulët (respektivisht 15.2% dhe 21.2%) si rezultat i kthimit të përgjigjes nga pak studentë të diplomuar. [Doc- Gjurmimi (mbajtja e të dhënave) viti akademik 2017-2018].</p> <p>Studentët e diplomuar shprehen se profilet e punës që ofron tregu përputhen me njohuritë dhe aftësitë që ofrojnë programet e studimeve në UBT, duke konfirmuar që diploma e UBT është e vlefshme për tregun e punës (Doc. no.8 – Raport Performanca e QKA, fq. 19).</p> <p>Nga Raporti i performances së QKA rezulton se Bordi i Alumnit si strukture formale është ngritur, por ende nuk ka realizuar aktivitet sipas parashikimeve të planit të punës apo edhe përshkrimeve në rregulloren e QKA (fq. 19). Një kontribut i rëndësishëm për programin e studimit do të ishte mendimi i këtij bordi duke qënë se ata tashmë janë pjesë e tregut të punës dhe njohin më nga afër problematikat dhe kërkesat e tregut në lidhje me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme të studentëve si potencial i ardhshëm për punësim.</p> <p>Megjithatë duke parë rezultatet e mësipërme dhe nga bisedimi i realizuar me përfaqësuesit e kësaj zyre kërkohet një koordinim dhe bashkëpunim më i mirë me departamentin, personelin akademik dhe këto zyra në ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë që mbart kjo zyrë në ndërtimin e karrierës së studentit.</p> <p>Një mundësi e mirë për të patur një impakt të konsiderueshëm në gjurmin e studentëve të diplomuar mund të krijohet nëpërmjet Projektit Gradua, i cili do të lejojë mbledhjen e të dhënave lidhur me performancën e tyre; lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) dhe do të krijojë lehtësi në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe bizneseve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika,	Sipas manualit të cilësisë, misioni, vizioni (aneks në raport), UBT

struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

e mbështet punën e vet në ndershmërinë, kreativitetin, lirinë akademike, bashkëpunimin dhe shkëmbimin për kërkimet në shkencë, dhe edukim. Universiteti Bujqësor i Tiranës ka përgjegjësinë që ti ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve akademike, hulumtuese dhe shërbimesh; të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e ofruara dhe të sigurojë që janë plotësuar standardet e cilësisë. Për të arritur sigurimin e cilësisë, UBT ka zhvilluar një politikë të sigurimit të cilësisë dhe ka ngritur një sistemin të menaxhimit të cilësisë. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në UBT-së është konceptuar si

- përgjegjësi e menaxhimit – angazhimi i strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë;
- sigurimi i burimeve për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë;
- mësimdhënia, mësimi, hulumtimi dhe shërbimet – përmes zhvillimit dhe shpërndarjes së programeve cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë;
- analiza dhe përmirësimi – përmes përcaktimit të parimeve, standardeve, procedurave dhe metodave për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. /

Për këtë arsye Universiteti zhvillon një sistem eficient në lidhje me:

- Monitorimin, menaxhimin dhe politikën e vendim marrjes.
- Sigurimin e autonomisë së punës së pedagogëve dhe pozicionin jo diskriminues të studentëve.
- Internacionalizimin e edukimit të arsimit të lartë.
- Monitorimin e ecurisë së të diplomuarve dhe programet e postdiplomimit.
- Stabilizimin e lidhjeve dhe bashkëpunimin me ekonomine dhe shoqërinë në shkallë të gjere.
- Monitorimin e infrastruktures se kerkuar per zhvillimin sa më cilësor të arsimit te larte.

Universiteti në mënyrë të vazhdueshme gjithashtu përmirëson cilësinë e shërbimeve të veta dhe ka për qëllim të realizojë një performancë solide financiare. Kjo arrihet përmes:

- Organizimit të proceseve të mësimdhënies, të menaxhimit dhe mbështetjes.
- Parashikimit të resurseve
- Matjes së efikasitetit të proceseve

Nga vizita ne institucion, nga takimet me stafet, njesite dhe qendrat brenda universitetit dhe raportet tashme te ngritura e bera funksionale midis tyre dhe departamenteve, nga gjykimi mbi bazen e dokumentacionit konkludohet se:

UBT e konsideron dhe ka ndertuar nje sistem te tille qe sigurimin e cilesise e konsideron te vazhduar, te kujdesshem dhe te monitoruar nga te gjitha hallkat/njesite/qendrat pergjegjese.

Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

UBT ka ngritur prej disa vitesh një sistem të brendshëm të testimit, kontrollit, monitorimit të cilësisë. Ka ndertuar një procedure efektive të maredhenieve midis departamenteve, fakulteteve dhe njësive/qendrave dhe rektoratit/senatit.

Përmes këtij sistemi ka ndikuar në një vendimarrje të kujdesshme të senatit, të bazuar mbi një informacion të mbledhur nga poshtë (studentet/stafi), të përmbledhur e diskutuar në analizat e departamenteve, të pergjithesuar më tej përmes analizave të fakulteteve për të vijuar në një analizë të vetme vjetore, periodike të institucionit. E bere kjo procedure në mënyrë të përvitshme në fund të çdo viti akademik, ka sjelle një përmirësim dhe impakt direkt në mesimdhënie duke rritur ndjeshëm standartin e mesimdhënieve por edhe rritur perceptimin dhe ndergjegjësimin e stafëve dhe studenteve për nevojën e përmirësimit të vazhduar.

Shtylla kryesore është kërkimi, universiteti ka arritur disa mbështetje online që ndihmojnë dhe mbështetin pedagogët dhe studentët për kërkimin, gjetjen e informacionit dhe të burimeve që mbështesin kërkimin dhe përmirësojnë cilësinë.

Universiteti Bujqësor i Tiranës harton politika dhe procedura konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi. UBT ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore.

UBT përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit realizon sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë, i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues.

UBT dhe FEA organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i FEA_s aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre, i cili është përgjegjës për këtë proces.

Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik. Dekanati i FEA_s organizon procesin e tërheqjes së opinionëve të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha modulet.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve

të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Njesia baze që ka të drejten dhe profesionalizmin e permiresimit, ndryshimit, rregullimit apo propozimit të kurrikulave të reja është departamenti. E vendosur midis tregut të punës, literaturave bashkekohore, studenteve, biznesit, nevojës për permiresim/ndryshim dhe permiresime të vazhduara, stafi i departamentit nën drejtimin dhe i mbështetur nga drejtuesi i tij, është gjithnjë në kërkim të menyrave të permiresimit, rregullimeve të kurrikula, pershtatje të tyre, permiresimit të syllabuseve të vecanta, riorganizimit të pikeve brenda cdo syllabusi, riorganizim dhe ndarje midis lendeve që formojnë e standartizojnë aftësitë e vecanta nga ato profesionale, etj; e gjitha kjo me qëllim studentin, dijet dhe njohuritë e tij si dhe përthitjen e tyre të plote nga tregu kombëtar dhe nderkombëtar. P.sh., nevoja e krijimit të këtij program studimi ka ardhur në kuadrin e një projekti, por e porpozuar nga vetë stafi kompetent dhe njohës i mirë i fushës së studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Nga ana tjetër, institucioni ndërton një skemë/procedure të tilla të kontrollit dhe menaxhimit të të gjithë ndryshimit të përvitshëm, dhe e standartizon atë përmes kanaleve përmes së cilave vijon i gjithë procesi. Duke kaluar përmes viteve, e gjitha kjo kthehet në një procedure të nevojshme e cila përvetëson procesin por edhe rrit cilësinë.</p>
	<p>Keshtu:</p>
	<p>Zyra mesimore dhe e kurrikulave e ndertuar dhe krijuar prej 2016 me funksionet e veta mbështet këtë mision, dhe jo vetëm, pas daljes së produktit (kurikulave të reja apo permiresuara) nga departamentet kontrollon brendësinë e tyre në formë persë i përket sistemit të krediteve, shpërndarjes në semetra, etj, si dhe përditeson sistemet dhe studentet me cdo ndryshim. Metodologjia e përdorur dhe instrumentat për ta standartizuar këtë proces janë si më poshtë:</p>
	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i kurrikulave është procedure normale. Rektori cdo vit në fillim të vitit njofton fakultetet dhe departamentet për fillimin e përditesimit të kurrikulave duke i dhënë mundësi departamenteve cdo fillim të vitit të shprehin për ndryshime e rregullime. Kurrikulat miratohen cdo vit nga departamentet, vëlohen dhe firmosen, dhe para se të kalojnë në rektorat kalojnë në zyrën e kurrikulave, e cila okupohet që nga verifikimi i krediteve (psh, totali në 180 kredite, etj). Kurrikulat, procesi mesimor dhe permiresimi i tyre janë përgjegjësi jo vetëm e përgjegjësive të departamenteve por edhe e zëv rektorit për mesimin dhe zyrat përkatëse, duke bërë e mundur që kurrikulat kalojnë në disa holla me qëllim mirëmenaxhimit, testimin dhe kontrollin e tyre të vazhduar;

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

- Analiza mesimore (meret zyra e kurrikulave qe manaxhohet nga zv rektori i mesimit). Zyra kurrikulave per efekte te **backgroundit** ne informatike dhe funksioneve qe kryen manaxhon edhe faqen por edhe me hedhjen dhe perditessimin e informacionit, urdheresat, vendimet e senatit te cilat afishohen ne web dhe perditohen. ne kete menyre sigurohen se i gjithë procesi i vendimarrjes eshte jo vetem transparent por vecanerisht i bazuar ne nje process te standartizuar, te kaluar permes te gjithë etapave dhe te kujdeshem.
- Anketimi. Per here te pare per kete vit u be anketimi online i cili u manaxhua nga zyra e kurrikulave
- Nese ka ndryshime ne kurrikul, zyra e kurrikules ben hedhjen ne system me qellim qe studentet te jete te perditësuar me lendet dhe kreditet qe do te jape ne provim sipas kurrikulave te reja dhe t eperditësua.
- Analiza shkencore merret, zyra e zv rektorit te kerkimit.

Zyra mesimore dhe e kurrikulave merret me manaxhimit e procesit te rishikimit vjetor dhe periodik te kurrikulave, manaxhon hedhjen e vendimarrjes ne sistem, anketimet, etj. Rezulton nga kjo zyre se mesimdhënia ka ardhur ne permiresim, ka pasur shume pak raste negative kur keshilli etikes ka marre masa drastike ne baze te anketimeve. Duke e deklaruar rezultatin dhe duke mos e fshehur rezultatin ne nje fare menyre eshte mbeshtetje per pedagoget qe punojne po ashtu per ata qe kane patur probleme. Keto anketime jo vetem ndahen midis pedagoqeve por publikohen edhe online, ne kete menyre edhe studentet ndjehen mire ne lidhje me ate qe kane deklaruar vete.

Kjo zyre manaxhon edhe informacionin, ne fakt cdo department vendos nje person pergjegjes qe eshte pergjegjes per informacionin brenda departamenti dhe per percjelljen e tij tek njesite e tjera, dhe kjo zyre kordinon hedhjen e informacionit te ndryshuar ne system.

Performanca akademike eshte proces i qenderzuar nga institucioni dhe sfidues jo vetem per qendren por per te gjithë stafin dhe njesite perkatese. Nje moment tjetër i bashkangjitur performances eshte edhe divulgimi: Performanca e pedagoqeve lidhet vecanerisht me testimin dhe vleresimin e aftesise qe ka pedagogu qe dijet e veta t'i beje publike dhe ne sherbime te shoqerise, pra te thirret ne komisione jashte UBT apo te jape kontributin e vet ne shoqeri. Ne kete menyre institucioni ka marre ne konsiderate, dhe jep kontributin e vet ne shoqeri permes permiresimit te cilesise, kontrollim dhe manaxhimit te mesimdhënies dhe permiresimit te kurrikulave. Ne kete menyre stafi dhe studentet do te mund te japin kontributin e tyre direkt.

Funksionojne keshillat e studenteve, komisionet jane zgjedhur ne

2016. Studentet janë pjesë e komisioneve, disa prej tyre edhe nuk kanë funksionuar plotësisht. Në fund janë zgjedhur komisionet e fakultetit dhe ato të Senatit, në të cilat përfaqësohen edhe nga studentët.

Procesi i cilesive është proces i vazhduar, dhe në fund të vitit akademik kur dalin raportet nxjerrin dhe prodhojnë masat për të përmirësuar cilësinë.

Zyra e karrierës dhe studentëve merret me zhvillimin e karrierës së studentëve të të gjithë fakultetit të ekonomisë, që në vitin 2013, ka ekzistuar në formë me të zgjeruar dhe jo kaq specifike dhe të fokusuar në objektiva të qarta sa është sot, por para pak viteve është fokusuar në standartizimin dhe në karrierën e studentëve. Janë arritur mjaft sfida që e kanë bërë këtë qendër mjaft të rëndësishme, kritike dhe me peshe për hallka kyçe e specifike, sikurse janë studentët, biznesi, etj. Zyrat e karrierës së fakulteteve të UBT e mbështesin dhe ndihmojnë zyrën qendrore të karrierës. Janë 5 zyra karriere në të gjithë fakultetet dhe kordinohen përmes qendrës së karrierës.

Në fund, edhe informimi i studentëve nëpër shkollat e mesme tek maturantët përben një sfidë të vendosur nga kjo zyrë por në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të cilesive të studentëve. Kjo bëhet me qëllim tërheqjen e studentëve të një niveli dhe cilesie më të mirë. Pastaj, sapo vijnë studentët, në fillim të vitit akademik ata njihen me cka mund të mbështeten, dhe në fund me praktike/interhip/punësim. Kjo bëhet për panairit me qëllim që të dihet sa është mundësia për punësim që para.

Një funksion tjetër, i cili nuk mbetet brenda qendrave individuale të karrierës apo zyrës së përgjithshme të UBT për karrierën, por i shërben objektivave dhe strategjive të institucionit, lidhet me faktin se çdo student përpara se të marrë diplomën, plotëson një formular që quhet gjurmimi i karrierës. Për çdo program studimi, çdo student e ka detyrim të plotësojë të dhënat e tij dhe momentin e fundit të të gjithë procesit, është që: 1 vit pas përfundimit të studimeve, për çdo student ka mbi 1 vit që është larguar nga UBT, intervistohen studentët se sa u ka vlejtur diploma, praktika profesionale në gjetjen e punës, a janë të punësuar, a janë të punësuar brenda profilit, si dhe çfarë sugjerojnë studentët për të përmirësuar më tej. Kështu, bazuar edhe në takimin me zyrën e këshillimit të karrierës, rezultoi se rreth 300 studentëve kanë plotësuar format të kësaj informacioni në vitin 2017, përpara dy viteve. Me tëj raportin që përgatit zyra e karrierës e cila në rektorat u shpërndahet si database departamenteve, dhe shërben për të përmirësuar etapën e vecantë të procesit në të ardhmen.

Të gjitha funksionet që kryen zyra e karrierës i shërbejnë qartë dhe mirë një objektivi: përmirësimit të cilesive, zgjerimit të pranisë së bizneseve, qendrimit dhe mbështetjes përpara, gjatë dhe pas diplomimit të tyre, etj.

	<p>Funksioni, roli dhe pesha e zyrës së sigurimit të cilësive është pjesë e metodologjive të universitetit për të standartizuar cilësinë, për t'ua bërë pjesë të filozofisë së përditshme, me qëllimin e krijimit të një kulture cilësore të mesimdhënisë, komunikimit, etj., duke synuar me lehtë dhe mbështetur me mirë procesin e nderkombetarizimit të UBT si dhe përafruar qasjen me të madhe dhe cilësore me biznesin vendas dhe atë të huaj.</p> <p>Procesi dhe funksionet e kësaj zyre paraqiten sipas etapave të zhvillimit të procesit mesimor. Fillon me një metodologji që në fillim që përcaktojnë se cilat janë detyrat që duhet të bëhen në një vit akademik, kur dhe kush duhet t'i realizojë.</p> <p>Hartimi i pyetesoreve përben një moment kritik dhe të rëndësishëm dhe mjaft të vlerësuar nga i gjithë institucioni, prandaj hartimi dhe përpilimi i tij kalon në të gjitha hallkat përpara se të miratohet për hedhjen në rektorat e senat.</p> <p>Në këtë vit akademik janë lançuar 2 pyetesore:</p> <p>Është bërë edhe një pyetesor hard copy në fund të semestrit i cili është përpunuar nga zyra, është specifik për çdo lëndë. Për çdo pedagog është bërë raport si pjesë e analizës mesimore të universitetit. Pyetesori online, por që nuk është plotësuar në masë të ndjeshme nga studentet, dhe është bërë në kohën e protestive të studnetëve të dhjetorit të 2018, për të kuptuar se çfarë kërkojnë studentet për të përmirësuar.</p> <p>Ky raport bëhet për çdo vit dhe më tej për të gjithë universitetin. Mbi bazën e tij nxirren pikat e dobëta dhe u shpërndahen departamenteve; mbi bazën e rezultateve më tej ndërtohet edhe plani i masave për vitin tjetër. Mbi këtë filozofi bazohet edhe ndertimi i planit strategjik për të gjithë universitetin, i cili prodhon në çdo fillim viti akademik një plan masash.</p> <p>Për procesin mesimor organizohen kontrolle jo vetëm të provimeve por edhe të mesimit, janë të organizuara paraprakisht dhe bëhen me komisione. Rrisin stimulimet e pedagogëve për të punuar më shumë, mbështesin studentet. Megjithatë, dy shtyllat kryesore ku bazohet e gjithë veprimtaria e institucionit janë mesimi dhe kërkimi, por edhe divulgimi është synim dhe sfiidë.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni i cili përfshin jo vetëm kurrikulat e rishikuara por edhe analizat mesimore, përveçse zhvillohet në mënyrë graduale dhe të kontrolluar nga njesitë/qendrat përkatëse (startojnë nga departamenti), kalon nga poshtë lart, pra drejt senatit dhe rektoratit i cili mbi këtë bazë merr vendimet, i bën të ditura përmes sistemit por edhe në auditoret e brendshme të universitetit, dhe finalizon procesin me një plan masash (në fund të vitit akademik). Finalizimi i këtij procesi me këtë plan masash krijon tendencën e natyrshme të përmirësimit të cilësive, mesimdhënisë, të gjithë sistemit të shërbimit në funksion dhe për studentet, etj.</p>

<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Zyra kurrikulave për efekte të backgroundit në informatikë dhe funksioneve që kryen manaxhon edhe faqen por edhe me hedhjen dhe perditesimin e informacionit, urdheresat, vendimet e senatit të cilat afishohen në web dhe perditohen. Në këtë mënyrë sigurohen se i gjithë procesi i vendimarrjes është jo vetëm transparent por vecanerisht i bazuar në një proces të standartizuar, të kaluar përmes të gjithë etapave dhe të kujdeshem.</p> <p>Ky plan masash përben një output të cilësuar mjaft eficient nga të gjithë aktoret dhe palet e interesuar vecanerisht sepse është ngritur mbi një sistem transparent, cilesor dhe të kontrolluar mirë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Procesi i sigurimit të cilësisë së brendshme realizohet duke përdorur një metodë nga poshtë-lart. Universiteti përcakton filozofinë, politikën dhe procedurat në rang UBT të cilat më pas aplikohen në rang departamenti. Sigurimi i brendshëm i cilësisë bëhet në tre mënyra kryesisht: a) nëpërmjet pyetësoreve të drejtuar studentëve (sqaruar në kriterin më sipër) të cilat plotësohen çdo semester; b) nëpërmjet asistimeve të pedagogëve të rinj nga pedagogë me eksperiencë dhe c) nëpërmjet vlerësimit të performancës së çdo pedagogu mbi baza viti akademik. Analiza e këtyre elementeve bëhet në rang departamenti dhe konkludohet në 2 dokumenta baze - analiza e punës mesimore dhe analiza e punës shkencore. Këto dokumenta që i bëhen të njohura dhe diskutohen në departament i përcillen më pas dekanatit dhe më pas integrohen në raportet e analizës në rang Fakulteti dhe në rang Universiteti.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës me qëllimin që t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve akademike, hulumtuese dhe shërbimesh; të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e ofruar duke siguruar se janë plotësuar standardet e cilësisë. Për të arritur sigurimin e cilësisë, UBT ka zhvilluar një politikë të sigurimit të cilësisë dhe ka ngritur një sistemin të menaxhimit të cilësisë dhe për këtë, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të</p>

	<p>cilësisë.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i programit është proces që kryhet periodikisht, kalon në shumë etapa dhe hallka dhe tashme është institucionalizuar përmes metodologjive të përdorura. Këto informacione që rezultojnë si output i procesit dhe që prek dhe përfshijn të gjitha hallkat e tij, institucioni e reflekton përmes procesit të përmirësimit periodik të cilësisë, duke e kthyer këtë proces në një standart dhe instrument vlerësimi. Në fund të vitit, dhe në shërbim të sigurimit të cilësisë, UBT harton raportimin vjetor, të përgjithshëm, të detajuar, gjithëpërfshirës për të gjithë analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. (Aneksi 38: Analiza e punës mësimore DDA 2018)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>I cilesuar si një ndër shtyllat më të rëndësishme jo vetëm për arsimin e lartë në përgjithësi, por të konsideruara të tilla edhe nga UBT, për të qenë në shërbim dhe përmirësim të vazhduar të tij, institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p> <p>Për të siguruar këtë, institucioni ndërthur dhe kordinon disa metoda vlerësimi, metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Këto metoda përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi me nota/pikë (materializuar në procesverbal); • Teste të rëndësishme dhe konsideruese janë edhe testimet paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë (materializuar në procesverbal përfundimtar); • Përdoren edhe vlerësime të tilla si p.sh., vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kurse për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet (matërializuar në procesverbal përfundimtar); • Nderkohe që nuk anashkalohen dhe vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Të gjitha këto elemente të metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit faktohen në një seri dokumentesh duke filluar me regjistrin e pedagogut (hard copy dhe elektronik) i cili jep vlerësimet e studentëve deri para hyrjes në provimin final.</p> <p>Është konsideruar mjaft i rëndësishëm vlerësimi dhe testimi i kryer nga QKA. Është konsideruar dhe përmendet i tillë jo vetëm nga zyrtarët përgjegjës, por edhe stafit dhe pedagogët. Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit që ofrohen, UBT në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumni, ka organizuar pyetësorë të vazhdueshëm që kanë si qëllim gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet. Gjithashtu një tjetër pikë e rëndësishme e këtij sondazhi është dhe aspekti i përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave të studimeve në përputhje me vendet e punës që ish studentët kanë aktualisht.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	(Aneksi 17b: Performanca e QKA)			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës nëpërmjet Rregullores së Studimeve të UBT parashikon dhe garanton politika dhe procedura të vlerësimit të cilësisë.</p> <p>UBT gjithashtu përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC_s të programeve të studimit. Në këtë proces janë të përfshirë studentet padyshim, pedagoget dhe strukturat e sigurimit të cilësisë në UBT. Programet e studimit në aspektin kurrikular por edhe jo vetëm kanë pësuar ndryshime evolutive të vazhdueshme (Aneksi 94 Manuali i NJBSC, Vlerësimi sipas Standardeve).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një proces që prek mjaft hallka dhe struktura, duke ndare detyrat dhe përgjegjësitë. Kjo siguron perkushtimin e të gjithë aktoreve në sigurimin e cilësisë, mbarevajtjen e saj nga të gjithë anetaret dhe rritjen e ndershmërisë ndaj kesaj ceshtjeje nga të gjithë aktoret. Keshtu, edhe detyrat e meposhtme janë pjesë e kesaj sipermarrijeje: Një sërë detyrash brenda këtij plani masash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarrjeve në orë leksionesh të hapura apo ftesa ndaj lektorëve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë etj. Raportet e vlerësimit, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. (Aneks 9 Rregullorja-e-Studimeve_UBT_Final 2017, miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik, më datë 28.03.2017, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë Kreu XIII, Neni 90, Fq 56).</p>

<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës në fillim të çdo viti akademik miraton një Program Masash (Aneks 63 Programi i Masave të Mirëfillim Vitit Akademik 2018-2019, miratuar më datë 10.09.2018) të cilat kanë të adresuara dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara nga proceset vetëvlerësimit dhe marrjes së rezultatit të tij një vit më parë nga fakulteti dhe më tej Universiteti, e ku ka përcaktuar drejtimet e punës të më poshtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja vazhdimisht e stafit akademik në veprimtaritë që lidhen me analizën e sistemit ekzistues dhe thithjen e eksperiencës kombëtare dhe ndërkombëtare përmes workshopeve; • Organizimi i takimeve ku pjesëmarrësit të diskutojnë standardet, sigurimin e cilësisë, procedurat e vlerësimit dhe interpretimin e rezultateve të vlerësimit; • Politikat e pranimit në universitet të analizohen në lidhje me nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë, kapacitetin e institucionit, pagesat për shkollim, si dhe marrjen në konsideratë të orientimit strategjik të përgjithshëm; • Informimi i vazhdueshëm rreth rregullave të vlerësimit, ku të gjithë personat e përfshirë në vlerësim të informohen në kohën e duhur; • Vlerësimi i cilësisë së institucionit, kurrikulës, procesit mësimor, pedagogëve, studentëve, të kontrollohet në mënyre periodike dhe më pas duke marrë masat e nevojshme për përmirësim. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës ka parashikuar politika dhe strategji për organizimin dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në dokumentet më të rëndësishëm të tij të cilët janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe gjithë të interesuarit.</p> <p>Universiteti Bujqësor i Tiranës përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</p> <p>I gjithë informacioni që ka të bëjë me metodologjinë e vlerësimit dhe instrumentet matëse për ecurinë e programeve të studimit</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>përfshihet në vlerësimin e ZSCVI. Rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike, duke ja komunikuar stafit. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të ZSCVI nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Publikimi i çfarëdo rezultati që lidhet direkt me individë të caktuar bëhet brenda respektimit të lirisë akademike dhe ruajtjes së privatësisë. Raportet individuale i bëhen të njohura çdo stafi akademik dhe ndihmës në adresën e tyre elektronike.</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas dispozitave të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Ndërmjetësuesit, përmes Koordinatorit të Sigurimit të Cilësisë hartojnë dhe japin raporte për aktivitetet dhe iniciativat e reja që lidhen me sigurimin e cilësisë për të gjitha njësitë e UBT. Funksionimi i Komisioneve është i rregulluar nga Statuti, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Komisionet koordinojnë, përpilojnë dhe raportojnë aktivitete dhe iniciativa të reja lidhur me sigurimin e cilësisë në të gjitha njësitë e UBT nëpërmjet Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Koordinatorit Institucional. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Institucionit është përgjegjës para Senatit për punën e tij. Ai diskuton dhe vendos për çështje të fushës së menaxhimit të cilësisë dhe promovon, kooperon dhe monitoron aktivitetet e sigurimit të cilësisë në universitet dhe anëtarët e tij. Për më tepër ai monitoron vetëvlerësimin impaktin dhe procedurat e vlerësimit të universitetit. Komisioni përgatit propozime për aktivitete për cilësinë, duke përfshirë prioritetet që duhet të kryhen në universitet në vitin pasardhës që vijnë si rezultat i impaktit që kanë dhënë masat e marra gjatë vitit paraardhës akademik. Propozimet e tij ja prezanton Senatit akademik.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Strukturat drejtuese të UBT gjatë tre viteve të fundit kanë ndërmarrë një iniciativë llogaridhënie para gjithë asamblesë akademike të institucionit për çështje që kanë të bëjnë me të gjithë veprimtarinë e UBT-së ku një vend të rëndësishëm zë edhe llogaridhënia dhe diskutimi për cilësinë e programeve të studimit. Gjatë këtij procesi përfshihen edhe studentët sepse ftohen të marrin pjesë në këtë diskutim. Proçesi përfshin vijimësinë e proçesit mësimor si edhe problematikat e vërejtura gjatë viteve paraardhëse akademike, masat e marra gjatë viti të fundit akademik dhe impakti i tyre. Më tej vazhdohet me planin e ndërhyrjeve për vitin e ardhshëm akademik (Aneksi 74: Njoftim i takimit me asamblenë)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Menaxhim Agrobiznesi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Disponibiliteti i një infrastrukture mjaft funksionale.
2. Diplomë unike në fushën e Menaxhimit të Agrobiznesit në të gjithë vendin.
3. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë ka qenë dhe vazhdon të jetë në fokusin e punës së departamentit dhe programit mësimor.
4. Strukturë organizative efektive.
5. Staf akademik mjaft i kualifikuar.
6. Kërkesë disafish më e lartë nga ana e maturantëve për tu regjistruar në këtë program studimi.
7. Hartimi dhe përdorimi i një dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik në nivelin institucional dhe programor, dëshmon për një veprimtari të institucionalizuar dhe të standardizuar.
8. Sistemi ESSE3 (web-based) mbi bazën e të cilit studentët arrijnë të informohen mbi statusin e tyre akademik në çdo kohë, në çdo vend dhe nga çdo pajisje smart që ka akses në internet.
9. Njohje me programin e lëndës dhe më fushën e ekspertizës së pedagogëve nëpërmjet faqeve të personalizuar të secilit prej tyre, si dhe nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm të pedagogëve dhe studentëve në auditor, gjatë seancave praktike dhe konsultimeve.
10. Një pjesëmarrje aktive e stafit pedagogjik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, projekte që kanë ndihmuar në zgjerimin e kontakteve me kolegë jashtë vendit si dhe kanë krijuar mundësinë edhe për studime bashkëkohore shkencore.
11. Fusha kërkimore-shkencore e secilit nga anëtarët e këtij stafi është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku ata japin mësim.
12. Pjesëmarrje aktive e personelit akademik në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit.
13. Eksperiencë mjaft e mirë e personelit akademik në botimin e artikujve në revista të njohura.
14. Aktivitete mjaft intensive në kuadër të projekteve ERASMUS+ (KA1 credit exchange mobility dhe KA2 Capacity building), si për studentët ashtu edhe për stafin akademik.
15. Nxitje institucionale për matjen dhe promovimin e përmirësimit të performancës së stafit akademik.


16. Mirëfunksionimi i zyrës së Studimeve dhe Studentëve (ZSS), e cila standartizon dhe siguron çdo informacion dhe shërbim për studentët dhe procesin e mbarëvajtjes së vitit akademik.
17. Mbulimi i më shumë se 90% të ngarkesës mësimore nga ana e stafit të brendshëm të departamentit.

Pika të dobëta:

1. Disa nga syllabuset nuk paraqesin literaturë të përditësuar.
2. Pamjaftueshmëri në koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet departamentit, personelit akademik dhe zyrës së këshillimit të karrierës për ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë që mbart kjo zyrë në ndërtimin e karrierës së tyre.
3. Bashkëpunimi me aktorët e biznesit nuk është plotësisht i mjaftueshëm për sistemimin e të gjithë studentëve nga ana e institucionit në kuadër të kryerjes së praktikave profesionale.
4. Strukturë e dobët për gjurmimin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi.

Rekomandime:

1. Përdorimi i një stili të caktuar të paraqitjes së literaturës në syllabus do të lejonte evidentimin e disa elementeve të rëndësishëm, të vlefshëm për të identifikuar literaturën e përditësuar.
2. Kërkohet një koordinim dhe bashkëpunim më i mirë me departamentin, personelin akademik dhe zyrën e këshillimit të karrierës në ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë që mbart kjo zyrë në ndërtimin e karrierës së tyre.
3. Implementimi i Projektit Gradua do të jetë një mundësi e mire për Institucionin në gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe në krijimin e një bashkëpunimi më të mirë me bizneset për realizimin e praktikave profesionale apo intershipet për studentët.




Assessment Conclusions for the Study Program of the First Cycle “Agribusiness Management” of the HEI “Agricultural University of Tirana”

Strengths and affirmations:

1. Availability of relevant and functional infrastructure.
2. Unique diploma in the area of agribusiness management at national level.
3. Permanent quality improvement as a focal point of department staff efforts.
4. Effective organisational structure.
5. Very qualified academic staff.
6. Increased enrollment demand to this study program.
7. Design and use of both legal and pedagogical documentation at institutional and program level proves for an institutionalized and standardized activity.
8. Availability of a web-based system - ESSE3 enables students equipped with internet accessible smart devices, to check online their academic status anytime and from anywhere.
9. Interactive communication between academic staff and students regarding curricula and the expertise field of respective professors either virtually - through personalized websites of academic staff, or face to face - during lectures, seminars, practical and counseling sessions.
10. Active involvement of academic staff with national and international projects that have provided for the expansion of links and contacts with foreign counterparts and opportunities for joint scientific research.
11. Full compliance of academic staff's field of expertise and research with study program, nature and specifics of the modules that they teach.
12. Active involvement and participation of the academic staff in scientific conferences both in-country and abroad.
13. Prominent performance of the academic staff in relation with publication of articles in outstanding journals.
14. Intensive and active participation of academic staff and students in ERASMUS+ projects (KA1 credit exchange mobility and KA2 Capacity building).
15. Institutional encouragement of assessment, improvement and promotion of academic staff performance.
16. Efficient activity of the Office for Study and Students (OSS), whose activity is aimed at providing every kind of standardized information and services for students and assisting the institution for the smooth running of the academic year.
17. Coverage of more than 90% of the teaching load by the department's internal staff.



Weaknesses:


1. Lack of updated literature in certain syllabus.
2. Inadequacies in coordination and cooperation between the Department and Career Counseling Office in connection with raising students' awareness with regard to the importance of the respective office in building students' future career.
3. Inefficiencies in cooperation between the Department and businesses in relation with placement of all students for their internships.
4. Low performance of the Career Counseling Office, which should be empowered in order to better track the carrier of the graduated students.

Recommendations:

1. Use of literature templates into curricula would reveal some relevant elements of great value for the identification of the updated literature.
2. Promotion of a better coordination and cooperation between the Department and Career Counseling Office concerning raising of students' awareness with regard to the relevance of respective office in building students' future career.
3. Implementation of running ERASMUS + project "Gradua" should be considered as a great opportunity for the graduated students' career track and better cooperation with businesses concerning students' internships.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
VLERËSIMI TËRËSOR				✓



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

